ISSN 1857-6443

Administrata

Reformat që nuk filluan kurrë !

Fq.6

Kush ishin njerëzit e maskuar që u prezantuan si policë?!

Fq.5

"Tallja me Krishtin", do të vazhdojë të shfaqet

Fq.7

www.koha.mk

Koha

Jeta përgjatë murit ndan dy botë

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3481 · e mërkurë - e enjte, 10-11 tetor 2018 · 8°c | 22°c · 15 DEN

FORUM

O s'ma nin bre!

Në Maqedoni, u testuan edhe revolucionet e zhurmshme sociale e të armatosurat, por edhe ato pasivet në vazhdimësi... asnjëra nuk mer formë të mjaftueshme për të shndërruar këtë shoqëri në funksionale... Dhe , kur sot vras mëndjen thellë, në pesimizëm e pyes veten , si më tej, përgjigja është e vakët: u mbyt organika e kësaj shoqërie tanimë, prandaj hegjemonitë populiste djegin atë ...shkrumas!

Fq.10

GLOBI

Trumpi, presidenti me rekordin më të madh të skandaleve

Fq.15

RAJON

NATO mbështet dialogun Prishtinë-Beograd

Fq.14

NË PRITJE TË DEBATIT , MUNGOJNË 80 VOTAT E NEVOJSHME

TË SIGURTA VETËM ZGJEDHJET

Të mërkurën ndryshimet kushtuese priten të jenë në rend dite në Komisionin për çështje kushtetuese. Pjesëmarrja eventuale e deputetëve nga grupi parlamentar i VMRO-së në këtë Komision dhe më pas në seance plenare, është sinjal se mund të kalojnë ndryshimet kushtuese. Nëse rast se deputetët e opozitës nuk duken askund, jepet shenjë se zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme

Fq.3

Pse diskriminohen nxënësit e shkollave private?

Shkup, 9 tetor - Nxënësit e shkollave e mesme private janë padrejtësisht të diskriminuar, pavarësisht se në Maqedoni të gjithë njerëzit janë të barabartë me ligj, pa dallim race, kombi, feje...duke përfshirë këtu edhe kategorinë sociale. Diskriminimi është i ndaluar. Për dallim nga shkollat publike, këtyre nxënësve iu mohohet e drejta për të marrë tekste shkollore falas dhe shërbime të tjera si, transport publik falas sepse kategorizohen si "fëmijë të pasurve". Mirëpo për këtë kanë reaguar prindërit të cilët kanë theksuar se ky është diskriminim social ndaj fëmijëve të tyre sepse shkolla e mesme është detyrim ligjor (obligative), ata janë tatimpagues të rregullt, ndërsa ky shërbim kryhet ndaj nxënësve dhe jo ndaj shkollave. Prandaj prindërit dhe Avokati i Popullit do të kërkojnë ndryshim apo plotësim...

Fq.7

EDITORIAL

SHOQËRIA E MANGUPËVE TË BARABARTË!

Emin AZEMI

Mosbindja e një pjese të popullatës maqedonase për të votuar Marrëveshjen e Prespës, është lexuar edhe si pafuqi e Zaevit për të imponuar kursin e tij europian në politikbërje. Në anën tjetër flitet shumë për kontaktet e dendura që kanë struktura të caktuara të shoqërisë shqiptare me piramidën udhëheqëse të LSDM-së, madje edhe me vet Zaevin. Madje, siç thonë njohësit e mirë të dallavereve shqiptaro-maqedone, mjafton ti shkruash një sms. Zaevit (edhe në orët e vona të natës), dhe saora, pa humbur shumë kohë, të vjen përgjigja e tij, e shkruar me përzemërsinë dhe përulësinë e njeriut të përkushtuar e të përvëluar për zgjidhjen e halleve e problemeve të ndryshme.

Zaevi, ç'është e vërteta, po tregohet i pafuqishëm t'i bind bashkëkombësit e tij ta votojnë një marrëveshje që do ti siguronte shtetit ardhmëri euroatlantike, por në anën tjetër, siç po flitet, nuk e ka shumë problem të kontaktojë me turli shqiptari hallexhi, ndonjëri prej tyre edhe me precedente penale, vetëm e vetëm që në këtë shtet të ndërtohet një shoqëri e mangupëve të barabartë, që do ta dinin saktësisht adresën se ku ndodhet fshehtësia e ngritjes në karrierë pa qenë nevoja të kesh ndonjë parapërgatitje profesionale. Ata, zakonisht gjejnë arsye të akuzojnë kot ndonjë parti shqiptare se po i penguaka në ngritjen e tyre në karrierë, pa çka se me karrierë ata nënkuptojnë tredhjen e mizave dhe krasitjen e hithrave. Si kakërdhia në bagla, edhe ata nguliten diku në ndonjë vend pune (ku marrin rrogë pa e ditur se ku ndodhet puna) dhe gjatë gjithë kohës shajnë liderët dhe partitë shqiptare se si asgjë s'po bëjnë për çështjen shqiptare.

Nëse partitë shqiptare nuk arritën ti përfshijnë të gjitha kategoritë e shoqërisë në punët e ndryshme të shtetit, tani po del Zaevi një korrigjues i njëanshëm duke na bind se edhe banditët shqiptarë kanë vlerë, sidomos kur ata vendosen në pozita jeniçerësh, sepse vetëm jeniçerllëku historikisht është treguar të jetë pyka më efikase në duart e padronëve hileqarë.

Tash kah të shkojmë? Ose kush kënd duhet ta bind që të shpëtohet ky vend i vogël nga devijimet gjeopolitike? Shqiptarët nuk kanë nevojë të kalojnë në taborin e Zaevit për t'u dukur më lojal karshi shtetit që nuk po arrin ende t'ua sigurojë statusin e gjuhës së barabartë. Ose të duken më pak të përvuajtur prapa xhamave të avulluar të autobusit që do ti degdis në rrugët e kurbetit. Në anën tjetër, nuk kanë nevojë edhe të bëhen jeniçerë të betejave të huaja politike, për faktin se ATA ende nuk i kanë mbaruar betejat e tyre në përsosjen e cilësisë në politikbërje, në arsim, kulturë, biznes etj.

Të bësh ajvar ditën e referendumit dhe të pretendosh se shija e fasules duhet të dominojë guston tonë kolektive, i bie që një mëhallë e madhe maqedonasish ende jetojnë në filmat bardh e zi ku partizanët kacafyteshin me gjermanët, jo për të fituar betejën e radhës, por për tu dukur se ylli i kuq tash më kishte vlerë, kundrejt simboleve të zëvendësuara çetnike.

Shqiptarë (jo ata që i shkruajnë sms-a Zaevit) nuk mund të jenë peng i katundarisë maqedonase dhe sensibiliteve ajvarizuese të tyre. Mbase është koha që shqiptarët një ditë të organizojnë një referendum të TYRE me pyetjen e vetme: "Doni të jetoni në vendin e ajvarit të pabrenduar dhe të përcëlluar nga flaka e mosdurimit etnik, apo doni ti shkolloni fëmijët në shtetin e vlerave europiane?"

Maqedonia nuk duhet ti ngjajë një kopshti ku njerëzit shartohen sipas lojaliteteve false, ndërkohë që tendencat retrograde të shoqërisë kanë prejardhje të pastër maqedonase. Kauza për të mundur këto tendenca duhet të jetë prioriteti i Zoran Zaevit, e jo vrapi irracional për të përvetësuar shqiptarë të hutuar që u ngjajnë çardakëve pa parmak.



BORXHI I KROACISË NDAJ SHQIPTARËVE

"Kroacia dhe presidentja e saj Kolinda Grabar-Kitarović duhet të përzihen edhe fort në mbylljen e dialogut Serbi-Kosovë. Kroacia dhe e para e saj duhet pa asnjë ekuivok të përkrahin Kosovën dhe shqiptarët.

Kroatët i dinë mirë marrëdhëniet serbo-shqiptare dhe të sllavëve të jugut me ne sidomos prej vitit 1918, prej kur shpeshherë edhe direkt kanë marrë pjesë me njësi speciale në shtypjen e shqiptarëve deri në prishjen e Jugosllavisë së fundit.

Duke qenë edhe vetë viktimë e agresionit të Miloševićit dhe Serbisë, Kroacia duhet të rikujtojë borxhin që na e ka si rezultat i gjakut të dhjetëra luftëtarëve shqiptarëve në ushtrinë kroate të vrarë e qindra tjerëve që luftuan deri në fund në betejat e saj mbrojtëse kundër Serbisë. Asnjë kroat i vetëm nuk ka rënë në luftën e Kosovës për çlirim 1998-99. Kroacia nuk ka çka i trembet forcimit të kombit shqiptar në Ballkan duke parë këtë forcim si faktor që mund e eklipson kombin kroat. Përkundrazi, Kroacia dhe Presidentja kroate duhet të ndihen mirë dhe të obliguara të jenë me Kosovën dhe shqiptarët-- për shkak të borxhit dhe për shkak se forcimi i kombit shqiptar është në interes të balansit ballkanik me të cilin fiton edhe kombi kroat", ka shkruar një status në Facebook, veprimtari nga SHBA, Uk Lushi.

MJERISHT!

"Kanë mbetur vetëm edhe 12 vjet për ta shpëtuar botën. Nëse nuk ndërmerret diçka serioze, nxehja globale që po kanosë planetën e tokës, tokës do t'i shkaktojë zjarre masive, vërshime të mëdha dhe termete të papara deri më tani.

Ky është konstatimi i shkenctarëve të cilin e lexojmë në raportin mbi 700 faqe që i është dorëzuar Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Edhe në të kaluarën kam shkruar se, për fat të keq, njeriu i sotshëm ka dalë jashtë kollosekëve të njerëzishmërisë. Është duke e "ç'njerëzuar" vetveten dhe çdo gjë që e rrethon. Është duke e hedhur veten matanë njerëzores. Njeriu duhet t'i kthehet natyrës së tij që e ka krijuar Zoti. Njeriu i sotshëm nuk është njeriu për të cilin flet Kur'ani dhe librat tjerë të shenjtë. Bota ka nevojë për njerëz, jo për robotë. Robotët dhe aventurat tjera po e qesin njeriun jashtë loje.

Dyshoj nëse njeriu sot ka vlerë së paku sa ajo që e bartë në xhep, që i thonë letër-paçavër krahasuar me vlerën e njeriut si njeri. Vlera e asaj letre-paçavër duhet të çmohet vetëm nëse nuk e prekë, nuk e mohon e nuk e zëvendëson atë 50%-in tjetër të qenies "njeri". Anën shpirtërore të tij. Atë që njeriun e bënë njeri. Që e dallon nga ujku, nga hijena, nga miu e nga skrraja.

Duhet të ndodhë diçka e madhe që ta zgjojë njeriun nga gjumi e ta kthejë në njeri. Mirë kishte thënë mistiku islam i njohur botërisht, Bastami, se; njerëzit jetojnë së fjeturi, e kur të vdesin, zgjohen nga gjumi. Mjerisht...!", ka shkruar një status në Facebook, teologu Mustafë Bajrami.

MEDIACitate

NA THONË "SHIKONI KAH E ARDHMJA", NDËRSA MENDOJNË "NJIHENI KOSOVËN"

Ministri serb i Jashtëm, Ivica Daçiq, ka thënë se ka shumë "doktorë politikë" që e këshillojnë Serbinë që të orientohet kah e ardhmja, ndërsa me këtë ata në të vërtetë mendojnë vetëm "njohjen e Kosovës", ndërsa ka pyetur ata se përse nuk e këshillojnë Kosovën "që të orientohet kah e ardhmja" dhe të njohë autonominë e Kosovës në Serbi.

"Çka nënkupton kthimi kah e ardhmja", pyeti Daçiqi, i cili mori pjesë në panelin "Sfidat e Sigurisë në Ballkan" në Timishoara në Rumani, ku ai dhe ministri i jashtëm rumun, Teodor Meleshcanu shkëmbyen përvoja dhe reflektime mbi sfidat aktuale dhe shkaqet e tyre në rajon, shkruan Koha.net. "Atë formulim e shfrytëzojnë doktorët politikë kur bëhet fjalë për Kosovën, 'orientohuni nga e ardhmja, lëreni Kosovën'. Atëherë, pse s'thoni në Prishtinë 'orientohuni kah e ardhmja, bëhuni autonomi në Serbi'. E rrihni dikë, e më pas i thoni 'orientohuni kah e ardhmja'. Nuk është kjo kaq e thjeshtë. Janë parulla, nuk është jetë", tha Daçiqi. Ky reagim i Daçiqit erdhi në fund të panelit, ndërsa nga publiku i thanë se 90 për qind e prezantimit të tij ishte i shkëlqyeshëm, por fliste për të kaluarën, ndërsa "e ardhmja është çelës dhe në interes të shtetit tuaj".

"Bëhuni konkretë, dhe më thoni çfarë dëshironi? A dëshironi që Serbia të njohë Kosovën", pyeti Daçiqi.

"Këtu po flasim për probleme konkrete, që janë në zhvillim e sipër, që po ndodhin. Nuk po flasim për Mesjetën. Mund t'u thoni spanjollëve dhe katallanëve që të shohin kah e ardhmja. Mund t'i thoni edhe Moldavisë dhe moldavëve, që të shohin kah e ardhmja", tha më tej ai. "Ne jemi në proces të zgjidhjes së kësaj çështjeje dhe kjo s'ka përfunduar, ndërsa ju bëhuni konkret dhe thoni çfarë mendoni në të vërtetë", përfundoi Daçiqi.

(KOHA Ditore, 9 tetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

SI KANË QENË LIQENET E LURËS?

Liqenet e Lurës janë liqene akullnajore në shpatin lindor të Kurorës së Lurës në lartësinë 1500-1600 metra. Nga 12 liqene, 8 kanë patur ujë vazhdimisht, ndërsa të tjerët periodikisht. Kanë sipërfaqe të përgjithshme rreth 100 ha. Më të njohurit kanë qenë Liqeni i Madh me sipërfaqe 32 ha, me gjerësi maksimale 300 m dhe me gjatësi 425 m; Liqeni i Pishave me sipërfaqe 13 ha; Liqeni i Zi, me sipërfaqe 8 ha; Liqeni i Luleve me sipërfaqe 4 ha etj.

Ushqehen me ujë nga reshjet e borës e të shiut. Kanë regjim tipik alpin, me lëkundje të vogla të nivelit gjatë vitit. Nivelet më të larta vrojtohen në pranverë, pas shkrirjes së borës, ndërsa më të ulëtat në dimër, kur liqenet ngrijnë dhe mbulohen me borë. Ngjyra e blertë e mbyllur e ujërave dhe pyjet e pishës që i rrethojnë krijonin dikur kur mirëmbaheshin një mjedis piktoresk dhe një vend pushimi mjaft tërheqës.

NË PRITJE TË DEBATIT PARLAMENTAR, MUNGOJNË 80 VOTAT E NEVOJSHME

TË SIGURTA VETËM ZGJEDHJET

Të mërkurën ndryshimet kushtuese priten të jenë në rend dite në Komisionin për çështje kushtetuese. Pjesëmarrja eventuale e deputetëve nga grupi parlamentar i VMRO-së në këtë Komision dhe më pas në seance plenare, është sinjal se mund të kalojnë ndryshimet kushtuese. Nëse rast se deputetët e opozitës nuk duken askund, jepet shenjë se zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 9 tetor - Kryeministri Zoran Zaev të martën ka qenë optimist se ndryshimet kushtuese do të përkrahen në Kuvend nga ana e deputetëve të opozitës me një pjesë të të cilëve, ai tha se ka biseduar edhe personalisht. Sipas Zaevit, debati i hapur dhe gjithëpërfshirës që do të fillojë shumë shpejtë në Kuvend dhe do të vë në pah elementin progresiv.

"Nëse më pyesni mua, unë mund të besoj se i kam, mund të besoj se nuk i kam. Por në fund, këtë duhet ta vërtetojmë, të dëshmohet. Unë besoj se kjo gjithnjë e më shumë do të shprehet. Deri tash kemi arsye që të besojmë se i kemi, dhe hymë. Por kjo do të shihet më shumë në debatin në komisione", deklaroi Zaevi. Siç tha ai, nga bisedime të drejtpërdrejta që ka zhvilluar me deputetë të opozitës, është motivuar që ri përcjell ndryshimet kushtetues në Kuvend.

"Unë personalisht kam folur, por edhe deputetët kanë folur. Kemi parë që ka një tryezë progresive, ku mund të debatohet. Ky ka qenë një motiv i mjaftueshëm që të hapim procedurat. Unë duhet t'i largoj të gjitha spekulimet që kanë rënë mbi kokat e deputetëve, për gjendje të pakëndshme, apo diçka të ngjashme", tha Zaev. Kryeministri i vendit këmbëngul se në Kuvend duhet të gjendet zgjidhje duke qenë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të reja.

"Opsioni real është Parlamenti. Maqedonisë nuk i duhet që të shpenzohen dy-tre muaj dhe të gjithë e dinë nëse shkojmë në zgjedhje kush do të fitojë dhe çfarë shumicë do të ketë, se do të jetë dy e treta. Por dy-tre muaj shkuan. Nuk duhet asnjë ditë t'i shpenzojmë shtetit. Afatet janë të qarta, Rregullorja është e qartë, ndërsa për afate të tjera nëse mos e dhëntë Zoti duhet të bisedojmë do të ketë kohë për të biseduar. Besoj se opinioni është lodhur nga zgjedhjet, e jo vetëm ekonomia të cilës nuk i duhen zgjedhje", tha Zaev, i cili dje mori pjesë në debatin të titulluar "Ura ose mure? Maqedonia dhe Ballkani Perëndimor në Evropë" të organizuar në kuadër të Forumit për shoqëri civile.

Nga ana tjetër,në Kuvend - kryetari i Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Aleksandër Kiracosvki gjatë një konference për shtyp vuri theksin tek përmbajtja e ndryshimeve kushtetuese të cilat sipas tij e ruajnë qartë identitetin dhe gjuhën maqedonase dhe e përforcojnë kufirin shtetëror. "Në përputhje me prioritetet kryesore strategjike të Maqedonisë, anëtarësimin në BE dhe në NATO, Qeveria dorëzoi propozim deri te Kuvendi për qasje në ndryshimet e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë, si një nga hapat e fundit nga Marrëveshja e Prespës. Draft ndryshimet kushtetuese janë shpallur publikisht dhe në dispozicion për gjithë opinionin. Çdo qytetar, çdo deputet mund t'i shikojë dhe të bindet për të vërtetën. Me draft ndryshimet përgatitet e gjithë ajo që u fol gjatë periudhës së kaluar. Identiteti, gjuha dhe veçoritë e Maqedonisë janë të garantuara dhe të mbrojtura përgjithmonë. Bien në ujë të gjitha lajmet e rrejshme dhe konstruksionet e imagjinuara gjoja kërcënuese të gjuhës maqedonase, identitetit maqedonas dhe historisë maqedonase", tha Aleksandër Kiracovski. Ai bëri apel deri tek të gjithë deputetët përfshirë dhe ata të VMRO-së që të përkrahin ndryshimet e propozuara.

ZGJIDHJA MË E MIRË, DORËHEQJA E ZAEVIT

Po në Kuvend, deputetë të VMRO-së thonë për gazetën KOHA se opozita është unike dhe nuk do të ketë pazare politike me Zoran Zevin. "Nëse vërtetë doni të dini se cila është zgjidhja, po ju themi që është dorëheqja e menjëhershme e Zoran Zaevit, më pas të formohet qeveri teknike dhe të shkohet në zgjedhje. Ja kjo duhet të ndodh. Kjo i duhet Maqedonisë pas dështimit të referendumit", thotë deputeti i VMRO-së, Dimitar Stefanaxhija, duke shtuar se askush nuk guxon të shpresojë se 10 deputetë të VMRO-së do shkojnë në seancë për të votuar duke mohuar kështu pjesëmarrjen e VMRO-së në debatin parlamentar. Lidhur me informata në media se deputetë të opozitës kanë marrë kërcënime për të mos përkrahur ndryshimet kushtuese, Dimitar Stefanaxhija e mohon kategorikisht një gjë të tillë. Ndërkaq VMRO përmes një kumtese për media mbajti qëndrimin se vendimi i Zoran Zaevit që t'i iniciojë ndryshimet kushtetuese për fshirjen e Republikës së Maqedonisë është shkelje e popullit të vet, nënçmim i tij dhe mohim.

"Zaevi me siguri është tmerrësisht i kushtëzuar për krimet që i ka bërë, pasi hoqi dorë nga populli dhe shkon në kundërshtim me zgjedhjen e qytetarëve. LSDM-ja vazhdon me shkeljen e ligjeve dhe Kushtetutën. Qeveria e Zaevit në mënyrë të turpshme vendosi të mos e respektojë vullnetin e qytetarëve, të cilët i thanë jo marrëveshjes kapituluese nga Prespa. Mbi 1,2 milionë qytetarë qartë i thanë jo ndryshimit të emrit, identitetit, gjuhës dhe historisë së Maqedonisë, i thanë jo politikave të qeverisë së LSDM-së dhe Zaevit", thuhet në kumtesë. Mospranimi, thuhet më tej në kumtesë, "i propozimit për formimin e prokurorisë së pavarur dëshmon se ky pushtet është promotor i krimit, padrejtësisë dhe është në koalicion me nëntokën kriminele në Maqedoni". "Zaevi është njeri i frikësuar. Frikohet pasi din se nuk e ka përkrahjen e qytetarëve për politikat e tij. Ai frikësohet nga zgjedhjet korrekte dhe demokratike, ku populli do ta dërgojë në pension politik dhe do t'i japë fund karrierës së tij dështuese politike, ndërsa Maqedonia do të fitojë", thuhet në kumtesën e Qendrës për komunikime e VMRO-DPMNE-së.

DY PALË ZGJEDHJE NËSE S'KA REZULTAT NË KUVEND

Nga ana tjetër, deputeti shqiptar Fadil Zendeli nga Lëvizja BESA thotë se deri më tani ka vetëm spekulime se janë siguruar dy të tretat ndërkaq sipas tij, duket mision i pamundur që të votohen ndryshimet kushtetuese në Parlament. "Nëse shkohet në zgjedhje me gjasë mund ti kemi bashke me zgjedhjet presidenciale bashkë, duke ndjekur praktikat në vendet tjera që para kohë të mbahen ato por Presidenti ir i të marr detyrën në afatin rregullit kur i mbaron mandati presidentit aktual. Kjo pasi logjikisht nuk mund të kemi zgjedhje çdo tre muaj është e pamundur", thotë për gazetën KOHA Fadil Zendeli.

Sipas rrjedhës së ngjarjeve debati mund të zgjasë disa javë dhe në fund nëse nuk ka zgjidhje palët të pajtohen të shkojnë vërtetë në zgjedhje të parakohshme. Ndryshe në momentin kur propozimi për ndryshimet kushtuese do të kalojë në seancë plenare, edhe atë pas dhjetë ditëve sa do të zgjasë debati në komisionin për çështje kushtetuese, tek atëherë mund të kemi sinjale pozitive nëse deputetë nga grupi parlamentar i VMRO-së do të marrin pjesë në seancë. Nëse ndodh kjo votimi me gjasë pritet të jetë i fshehtë për të mos u etiketuar hapur deputetë nga VMRO që do të votojnë pro ndryshimit të kushtetutës. Në të kundërtën, nëse asnjëri nga deputetët e grupit parlamentar të VMRO-së nuk do të merr pjesë në seance do të shihet qartë se zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme. Sa i përket propozimit për ndryshimet kushtetuese, ato përmbajnë shtesën në emrin aktual të Republikës së Maqedonisë me atë: Republika e Maqedonisë Veriore. Në të gjithë Kushtetutën e shkruar të Republikës së Maqedonisë para fjalës Maqedoni do të shtohet parashtesa 'e Veriut'. Në përputhshmëri me marrëveshjen me Greqinë, preambula do të pësojë disa ndryshime. Parashihet gjithashtu garanci për kufijtë e territorial të Republikës së Maqedonisë. Në nenin 3 të Kushtetutës së Maqedonisë është rregulluar se territori i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm dhe patjetërsueshëm. Kujdes për qytetarët e Maqedonas në diasporë dhe më gjerë. Nën Nenin 49 të Kushtetutës është shkruar se Republika e Maqedonisë kujdeset për gjendjen e të drejtat për komunitetin maqedonas në vendet fqinje dhe mërgimtarët. Ndihmon në zhvillimin e tyre kulturor dhe avancon lidhjen me ta.

MERKEL LETËR ZAEVIT: MARRËVESHJA, MUNDËSI HISTORIKE PËR MAQEDONINË



Marrëveshja e Prespës ofron mundësi historike për Maqedoninë dhe për përforcimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, theksoi kancelarja gjermane Angela Merkel në letrën dërguar kryeministrit të Maqedonisë Zoran Zaev. "Më 30 shtator një shumicë e madhe e qytetarëve, mbi 90 për qind e atyre që morën pjesë në referendum votuan "pro" marrëveshjes me Greqinë. Marrëveshja ofron mundësi historike dhe përforcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Kjo gjithashtu e largon pengesën kryesore për afrimin e vendit drejt BE-së dhe NATO-s. Tani është e rëndësishme që të ndërmerren hapa shumë të rëndësishëm për implementimin e marrëveshjes për emrin me miratimin e amendamenteve të domosdoshme kushtetuese. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me ju që ta realizojmë këtë qëllim", citon Merkel në letrën dërguar Zaevit, të publikuar në ueb faqen e Qeverisë gjermane.

Presim deputetët në Kuvend të vendosin, siç tha Kambovski, jo sipas diktimit dhe me urdhër të shefave të tyre partiakë, por në bazë të ndërgjegjes, njohurive, parashikimeve të tyre, duke marrë parasysh në këtë rast interesat e shoqërisë në tërësi dhe gjeneratat e ardhshme

KAMBOVSKI PËR MARRËVESHJEN E PRESPËS

NDRYSHIMET NUK JANË NË KUNDËRSHTIM ME KUSHTETUTËN

Koha — Evis HALILI

Shkup, 9 tetor - Ndryshimet kushtetuese që i propozon Qeveria përmbajnë zgjidhje të cilat korrespondojnë me Marrëveshjen e nënshkruar me Greqinë dhe me përmbajtjen e saj, përshtaten me parimet themelore kushtetuese dhe nuk janë në kundërshtim me to, vlerëson akademiku Vllado Kambovski. Pret që deputetët në Kuvend të vendosin, siç tha, jo me urdhër të shefave të tyre partiakë, por në bazë të ndërgjegjes, njohurive dhe parashikimeve të tyre dhe për shkak të interesave të shtetit.

"Kjo nënkupton sundim të së drejtës, shtet demokratik, shtet ligjor, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Këtë posaçërisht e theksoj sepse edhe në Marrëveshjen me Greqinë atë moment - se asnjë prej zgjidhjeve të përfshira në vetë Marrëveshjen ndërsa pastaj edhe në amendamentet kushtetuese do të paraqesin realizimin e saj, nuk mund të jetë në kundërshtim me parimet themelore dhe standardet për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sipas kësaj, edhe zgjidhjet që përfshihen këtu, janë plotësisht në pajtim me standardet universale për të drejtat dhe liritë e njeriut. Kështu që, rreth çështjeve për identitetit kombëtar, gjuhën, veçantinë etj, këto sipas meje, tashmë janë tejkaluar në vetë Marrëveshjen me Republikën e Greqisë", theksoi Kambovski për mediat sot në ASHAM ku u shënua 51 vjetori nga themelimi i Akademisë. Presim deputetët në Kuvend të vendosin, siç tha Kambovski, jo sipas diktimit dhe me urdhër të shefave të tyre partiakë, por në bazë të ndërgjegjes, njohurive, parashikimeve të tyre, duke marrë parasysh në këtë rast interesat e shoqërisë në tërësi dhe gjeneratat e ardhshme.

"Lejoj disa punë që deri tani kanë qarkulluar në opinion, si druajtje nga ajo çfarë do të sjellin - edhe Marrëveshja edhe ndryshimet kushtetuese, se janë falë mosnjohurive. Unë u rekomandoj të gjithëve të cilët kanë nevojë për disa sqarime shtesë nga ana e shkencës, posaçërisht lidhur me Marrëveshjen - e cila është burim i këtyre ndryshimeve kushtetuese, lirisht të vijnë apo të shkoj të bisedojmë për kuptimin e këtyre zgjidhjeve dhe përputhjen e tyre edhe me të drejtën ndërkombëtare, edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe posaçërisht me interesat e Republikës së Maqedonisë dhe perspektivat e saj përmes integrimeve euroatlantike", shtoi Kambovski.

Lidhur me dispozitën që ka të bëjë me diasporën, akademiku tha se janë inkorporuar standarde universale - se çdo shtet është i obliguar në kufijtë e saj të kujdeset dhe t'i garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përfshirë edhe siç tha, edhe të drejtat e bashkësive kombëtare, pakicave, jo vetëm nacionale, por edhe grupe të tjera të pakicave. Ish-parimi i paternalizmit të një shteti ndaj tjetrit, siç tha Kambovski, ka mbetur nga koha kur mes shteteve nuk ka ekzistuar nivel i tillë i bashkëpunimit dhe kompaktibilitet, sot është zëvendësuar me këtë parim të bashkëpunimit dhe përgjegjësinë e vetë shtetit për gjithë këto çështje në suaza të legjislacionit të tij.

"Përfundimisht, të gjitha shtetet, edhe nga rajoni ynë, janë nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e pranojnë juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu që, kjo është një nga garancitë e cila siguron shteti lirë të ecë me një zgjidhje të tipit të asaj që është propozuar - se shteti nuk mund ta ndërmarrë rolin të kujdeset në atë masë që do t'i garantojë të drejtat e pakicave të grupeve të caktuara nga një shtet tjetër. Kjo paraqet përzierje në punët e brendshme të një shteti tjetër dhe shprehje e shkallës së mosbesimit - të themi, në rastin konkret, se Republika e Greqisë mund të gjejë format përkatës, mënyra si t'i garantojë të drejtat e pakicave për këdo. Në fund të fundit, Greqia është anëtare e BE-së dhe vlejnë normat dhe standardet e parapara në Kartën për të Drejtat Themelore të BE-së, e cila gjithashtu, është burim i së drejtës Evropiane", shtoi akademiku Kambovski.

Raporti për Maqedoninë miratohet në PE

Bruksel, 9 tetor - Me 47 vota për, nëntë kundër dhe një të përmbajtur, Komisioni për punë të jashtme i Parlamentit Evropian e miratoi raportin e raportuesit Ivo Vajgëll për Maqedoninë në të cilin mbështetet hapje e negociatave me BE-në në qershor të vitit 2019. Raporti duhet tani të miratohet në seancë plenare të Parlamentit Evropian gjatë nëntorit. Varësisht nga zhvillimi i gjendjes politike në Maqedoni deri atëherë është lënë mundësi e hapur që të dorëzohen amendamente plotësuese.
Vajgëll dorëzoi një amendament plotësues pas referendumit që u mbajt më 30 shtator në të cilin thuhet se nevojitet mbështetje plotësuese për ardhmërinë euroatlantike të vendit dhe ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës.
Euro-deputetët e inkurajojnë Qeverinë që t'i ndërmerr të gjithë hapat e nevojshme për respektimin e dispozitave nga marrëveshja me Greqinë, qëndron në amendament.
Refuzohen disa amendamente nga euro-deputetë grekë, midis të cilëve amendamente të deputetes greke nga SYRIZA, Sofija Sakorafa, e cila është kundër Marrëveshjes së Prespës.
Ajo mes tjerash dorëzoi amendament në të cilin kërkoi që të fshihet mbiemri "maqedonas" në gjithë raportin. Sakorafa gjithashtu kërkoi që të largohet nga teksti një fjali me të cilën përkujtohet se Maqedonia në fillimin e viteve 2000 ishte kampione në procesin euro-integrues në rajon. Por, gjithashtu u refuzua një amendament i një euro-deputeti nga grupi Të Gjelbrit me të cilin kërkohej të vendoset konstatim për projektet e planifikuara infrastrukturore në zonat e mbrojtura që do të kishin impakt të rëndësishëm. Amendamenti, gjithashtu, kërkonte respektim të rekomandimeve nga Konventa e Bernit dhe suspendim të projekteve problematike.

Të djathtët evropianë të zhgënjyer nga VMRO-DPMNE

Bruksel, 8 tetor - Pas heshtjes së gjatë pas referendumit për Marrëveshjen për emrin, u prononcua Partia Popullore Evropiane, ku anëtare është VMRO-DPMNE. Shefi i partisë, Zhozef Dol, mbrëmë në tuitter ka shkruar se është i zhgënjyer nga marrëdhënia e partisë së tyre si motër në procesin për emrin.
"Duhet të merret vendim i rëndësishëm për të ardhmen e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të të gjithë rajonit në BE dhe në NATO. Mbetem i zhgënjyer nga roli i deritanishëm i opozitës në proces, konstruktiviteti duhet të mbisundojë mbi bojkotin. Dialogu midis atyre në pushtet në IRJM dhe opozitës është i nevojshëm sepse kjo është pjesë e rëndësishme e demokracisë", ka shkruar Dol.
PPE një kohë të gjatë ka refuzuar të reagojë, burime në parti thonë se ka pasur tentim për dialog me VMRO-DPMNE-në.

ARMAKOLAS PËR KONTESTIN E EMRIT

Marrëveshja e Prespës, bazë për miqësinë midis Shkupit dhe Athinës

Shkup, 9 tetor - Marrëveshja e Prespës është baza për miqësi midis dy vendeve. Ajo është disi e papëlqyeshme në të dyja vendet, por është e rëndësishme jo vetëm për të dy vendet, por edhe për rajonin, thotë Janis Armakolas i ELIAMEP, një njohës i mirë i Ballkanit. Ai në debatin e sotëm me titull: "Ura apo mure? Maqedonia dhe Ballkani Perëndimor në Evropë", organizuar në kuadër të Forumit për Shoqëri Civile Shkup 2018, ku ai mori pjesë si panelist së bashku me kryeministrin Zoran Zaev, tha se pret që zbatimi i Marrëveshjes në Greqi të jetë "çështje e ndjeshme ", por se ai është optimist.

"Duhet të jemi të sinqertë dhe kjo është baza për miqësi në të ardhmen. Marrëveshja nuk është popullore në Greqi dhe do të jetë po aq e ndjeshme ashtu siç është këtu tani dhe në javët e ardhshme. Por unë personalisht kam mësuar të jem më optimist me këtë proces negociatash që po ndodh midis dy vendeve gjatë dy viteve të fundit, sepse gjërat po ndodhin", tha Armakolos.

Kontesti me emrin, thotë ai, na kujton situatën

e viteve të 90-ta, periudhën postkomuniste dhe pas konfliktit dhe zgjidhja e tij, do të jetë një sinjal jo vetëm për të dy vendet, por për të gjithë rajonin që "ne mund të largohemi përfundimisht nga kjo trashëgimi dhe të kalojmë në diçka që duhet të jetë një e ardhme më e ndritur ". "Është e rëndësishme të kthehet optimizmi dhe shpresa në rajon. Për këtë, ne kemi nevojë për lidership pozitiv dhe mbështetje nga BE-ja. Elementi më i rëndësishëm i integrimit është se ne ndajmë idenë se si ne duam të organizojmë shoqërinë tonë dhe ky është një faktor unifikues në rajon", theksoi ndër të tjera, eksperti i Ballkanit, Janis Armakolas.

SHPALOSEN DETAJE TË REJA PËR 27 PRILLIN

KUSH ISHIN NJERËZIT E MASKUAR QË U PREZANTUAN SI POLICË?!

Dëshmitari Vojminovski, nga Gostivari, tha se ka pasur kontakt të vazhdueshëm me pjesëtar të sigurimit të ish kryeministri Nikolla Gruevski, me çka shtoi se në njërën prej bisedave që e ka dëgjuar është folur për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e kryetari të shtetit, Gjorgje Ivanov

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 9 tetor - Kuvendin e Maqedonisë ditën e 27 prillit të vitit 2017 e kishin siguruar vetëm pesë grupe të Njësisë speciale për intervenim të shpejtë (NJISH), numri i të cilëve nuk ishte më i madh se 25 veta. Publikimi i këtyre detajeve dhe të dhënave tjera për ngjarjet e 27 prillit ka vazhduar në procesin gjyqësor që zhvillohet pranë Gjykatën Penale të Shkupit, me çka dëshmitarët e rijë shpalosën informacione të panjohura deri më tani për opinionin.

PËRBALLË TURMËS - POLICË TË HUTUAR

I tillë ishte edhe rrëfimi i Llokman Selimit, pjesëtar i NJISH-it, ndryshe pjesë e 25 anëtarëve të njësisë speciale që ditën e 27 prillit kishin qëndruar prapa godinës së Parlamentit. Gjatë deklaratës së tij kundër 33 të akuzuarve për veprën penale "terrorizëm", Selimi para kolegjit gjyqësor tha se ai dhe kolegët e tij prapa Kuvendit ishin vendosur rreth orës 17:30.

"Me të filluar trazirat ne u ndamë në pesë grupe nga pesë anëtar. Dy prej këtyre grupeve, ku merrja pjesë edhe unë u nisëm drejtë hyrjes kryesore. Por, turma e madhe ishte më e shpejtë se ne dhe të njëjtit na bllokuan për muret. Përmes goditjeve dhe sulmeve të ndryshme ata tentonin ti thyenin dyert, por kot. Kur papritmas dyert u hapën. Pas protestuesve që hynin në Kuvend u nisëm edhe ne. Menjëherë u vendosën më shkallët përballë hyrjes. Zhurma ishte e madhe dhe britmat po ashtu 'maskat, maskat po vijnë'. Ne ishim të habitur se çka po ndodhë. Kështu përnjëherë u shfaqën personat me fantomka. Ata u drejtuan drejtë nesh dhe filluan të bërtasin se janë kolegë tanë, dhe mos na prekni. Disa prej tyre e shpërthyen kordonin tonë dhe u kthyen duke bërtitur, duke i thirrur protestuesit të shkojnë në sallën numër 3, respektivisht duke potencuar se atje gjenden deputetët-tradhtarët", tha dëshmitari Llokman Selimi.

Grupi i vogël i njësisë speciale që e kishte siguruar Kuvendim pasi e kishin kuptuar vendndodhjen e deputetëve, ishin nisur për ti mbrojtur. Mirëpo, sulmet e njëpasnjëshme dhe turma e dhunshme kishin parandaluar evakuimin në kohë të deputetëve që kishin qëndruar pasditen e 27 prillit, në Sallën numër 3 të Kuvendit.

"Urdhri për ndërhyrje me masa të dhunshme u dha rreth orës 20:40. Eprori na tha që të përdorim shok-bomba, por asnjëri prej nesh nuk ishte i pajisur me këto mjete. Afër nesh qëndronin edhe disa pjesëtarë të njësisë speciale të "Tigrave", ku njëri prej tyre më ofroi dy shok bomba, të cilat i përdora. Më tu futur në sallën për konferenca në Kuvend, sulmi vazhdoi. Nga hedhja e gjësendeve të forta unë u godita në pjesën e djathtë të vetullës dhe kështu kolegët më larguan për dhënien e ndihmës së parë", theksoi Selimi.

SULMUESI I SELËS DËSHMON KUNDËR BASHKËPROTESTUESVE TË TIJ

I dënuar me 13 vite e 6 muaj burg, për tentim vrasjen ndaj Ziadin Selës, i akuzuari Nikolla Vojminovski, të martën në GJPSH, foli për rrjedhën e protestës dhe personat që e kishin kontaktuar për tu futur në Kuvend. Gjatë përgjigjes së pyetjeve të parashtruara nga Prokuroria, Villma Ruskoska, dëshmitari Vojminovski, njoftoi se ish Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Andonov, një person me emrin Lupço, ish pjesëtar i MPB-së dhe një kushëri i tij

kanë qenë shkaktarët kryesor sepse ai ka marrë pjesë në protestat për "Maqedoni të Përbashkët". Përveç komunikimit me këta pjesëtar të MPB-së, dëshmitari Vojminovski, nga Gostivari, tha se ka pasur kontakt të vazhdueshëm me pjesëtar të sigurimit të ish kryeministri Nikolla Gruevski, me çka shtoi se në njërën prej bisedave që e ka dëgjuar është folur për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e kryetari të shtetit, Gjorgje Ivanov, dhe më pas arrestimin e disa personave.

"Ditën e 27 prillit pasi një kohë isha prezent në protestë, vendosa të nisëm për në shtëpi, të marrë veturën që e kisha të parkuar matanë urës dhe të takohem me të dashurën time. Brenda kësaj kohe më telefonon deputeti Luben Arnaudov, të cilin e njohë më herët dhe ai mu drejtuar me fjalët. 'Ku jeni, çka bëni? Hajde hyni brenda'. Nuk ia vura veshin dhe vazhdova rrugën, me çka Darko më lajmëroi.'Ku je be vëlla, këta hyrën brenda'. Dhe kështu unë u ktheva drejtë Kuvendit. Me të hyrë brenda në sallën plenare, e takova deputetin Sasho Vasilevski i cili më udhëzoi te Arnaudovi, gjegjësisht ky i fundit ma tregoi drejtimin kah duhet të shkoj, për shkak se Kuvendi për mua ishte një objekt i panjohur deri atë ditë. Përveç deputetëve kishte edhe persona të maskuar që e trasonin rrugën drejtë sallave", theksoi Vojminovski.

Seanca e radhës për 27 prillin pritet të mbahet me 16 tetor, kur si dëshminë e tij prite ta jep dëshmitari i koduar C-1.

KRONIKË

Mori 2000 euro ryshfet, arrest shtëpiak për punonjësin e MEPSO-s

Prokurori publik kompetent nga Prokuroria Themelore Publike Shtip, duke vepruar për kallëzimin penal nga Ministria e Punëve të Brendshme, solli urdhër për zbatim të hetimit kundër një personi nga Shkupi, i punësuar në MEPSO. I dyshuari ngarkohet se ka kryer vepër penale - Marrje të ryshfetit me nenin 357 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 nga Kodi Penal, njoftoi Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë. Prokurori publik kompetent, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore, deri te Gjykatësi i procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore - Shtip dorëzoi propozim për caktim të masës - paraburgim. Gjykatësi i procedurës paraprake me Vendim të dyshuarit i caktoi masë - paraburgim shtëpiak. Ndaj Vendimit të këtillë, Prokuroria Themelore Publike sot deri te Këshilli i Gjykatës Themelore - Shtip dorëzoi ankesë. I dyshuari si ekspert ka kërkuar dhe marrë 2000 euro për vërtetim të ekspertizës veçmë të përgatitur ekonomiko-financiare. Më 6 tetor sipas marrëveshjes paraprake i dyshuari i ka marrë bankënotat e shënuara nga denoncuesi, me ç'rast pas intervenimit të personave të autorizuar zyrtarë janë gjetur tek i dyshuari dhe ai është privuar nga liria, qëndron në kumtesë.

Paditet ish-drejtori, blinte karburant me para të shkollës

Kallëzim penal është parashtruar kundër ish-drejtorit të një shkolle së mesme komunale në Gostivar, i cili në periudhën nga nëntori i vitit 2017 deri në mars të këtij viti e ka keqpërdorur detyrën zyrtare. Sipas buletinit të sotëm të policisë, 38-vjeçari I.D. si drejtor ka marrë një telefon celular, i cili ka qenë pronë e shkollës, ndërsa në disa raste, nga llogaria e shkollës, ka shfrytëzuar gjithsej 12.000 denarë për karburant, pa deponuar dokumentacion përkatës. Gjithashtu më 17 shkurt të këtij viti në kundërshtim të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve nga shkollat e mesme, ka mundësuar që të organizohet ekskursion njëditor në Kosovë.

Shkup, 6 të lënduar në 9 aksidente

Gjashtë persona janë lënduar më lehtë në nëntë aksidente gjatë 24 orëve të kaluara në Shkup. Prej tyre, në tre ka pasur persona të lënduar, ndërsa në tre është shkaktuar dëm material. Nga SPB informojnë se gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër më të madh të kundërvajtjeve. Dyzet e një shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa e lejuara, gjashtë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, një shofer nuk ka dhënë përparësi të kalimit të këmbësorëve në vendin e shënuar për këmbësorë, si dhe shtatë shoferë me motorë dhe motoçikleta nuk kanë përdorë kasketa mbrojtëse. Janë sanksionuar edhe 11 këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë kalimit për këmbësorë dhe tetë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe. Nga trafiku, gjithsej janë shkyçur 22 shoferë, prej të cilëve katër të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 15 kanë qenë pa patentë shoferi dhe dy shoferë fillestarë, si dhe 16 automjete të paregjistruara dhe një makinë për mbingarkesë. Janë hasur 104 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec", janë larguar 81 automjete. *(O.Xh)*

ADMINISTRATA ASSESI TË REFORMOHET

REFORMAT QË KURRË NUK FILLUAN!

Endja nga një sportel në tjetrin paraqet problemin më të madh konkret që mundon qytetarët, tregon analiza "Sfidat dhe problemet e qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të administratës publike" të përgatitur nga ana e Qendrës për strategji evropiane " Evrotink". Vetëm 20 për qind e qytetarëve janë të kënaqur me shërbimet e shpejta dhe cilësore që i fitojnë nga administrata publike

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 9 tetor - Reformat e shumëpërfolura në administratën shtetërore në Maqedoni për të cilat flitet me vite, por vështirë realizohen në praktikë nënkuptojnë, jo vetëm racionalizimin e numrit të të punësuarve, por edhe rritjen e efikasitetit të punës së saj.

Njëherësh, Komisioni Evropian në raportin e fundit vlerësoi se administrata publike në Maqedoni është e përgatitur në mënyrë të matur në raport me standardet evropiane. Reformat më serioze në administratë imponohen edhe nga analizat e ndryshme lidhur me pakënaqësitë e qytetarëve me shërbimet që i fitojnë nga administrata publike.

Vetëm 20 për qind e qytetarëve janë të kënaqur me shërbimet e shpejta dhe cilësore që i fitojnë nga administrata publike. Njëherazi, endja nga një sportel në tjetrin paraqet problemin më të madh konkret që mundon qytetarët, tregon analiza "Sfidat dhe problemet e qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të administratës publike" të përgatitur nga ana e qendrës për strategji evropiane " Evrotink".

Ekspertët thonë se në Maqedoni, në periudhën e kaluar, asnjë garniturë politike nuk ka treguar vullnet për reformim të vërtetë të administratës publike.

"Në 20 vitet e kaluara kemi dëgjuar mjaft për reforma, por në këtë drejtim kemi shkuar prapa dhe jo para, pasi për reforma të mirëfillta mungon vullneti politik. Në të ardhmen, së pari nevojitet të përgatitet analizë e kompetencave e të gjitha organeve që pranojnë të holla nga arka e shtetit. Nga 149 mijë të punësuar në sektorin publik, afër 50 mijë nuk janë nëpunës administrativ, andaj atyre nevojitet të kryhet testim që do të përcaktojë se sa mundet që çdo kush të mbetet në vendin e tij të punës. Në rast se nuk mundet, atëherë duhet të testohet për një pozitë më të ulët të punës", thotë profesori universitar Borçe Davitkovski. Sipas tij, në këtë mënyrë do të anulohen edhe anomalitë ku persona me fakultet të kryer të edukatës fizike apo stomatolog janë angazhuar për resurset njerëzore.

Pra, njerëzit e vërtetë duhet të vijnë në vendet e vërteta përmes lëvizjes nga një vend pune në një vend tjetër pune e që nënkupton diku edhe lëshime nga puna, diku edhe pranimin e njerëzve të rinj, por vetëm në rast se janë adekuat për atë vend pune, shton më tej Davitkovski.

Nga ana tjetër, një pjesë e përfaqësuesve të biznesit thotë se shteti mund të zvogëlojë numrin e të punësuarve në administratë, duke stimuluar njerëz të rinj në administratë që ju fle sipërmarrja në shpirt dhe që dëshirojnë të arrijnë diçka më shumë në jetë. "Nevojitet që në të ardhmen të ndihmohen 30 deri 40 mijë të punësuar në administratë që me pagat tre vjeçare prej afër 15 mijë euro, nëse përllogarisim pagën mesatare prej 400 euro, të kenë mundësi të fillojnë biznes të ri apo të gjejnë punë tjetër. Njëherazi, ish të punësuarit në administratë që do të orientohen në sipërmarrje, nevojitet të mbështeten me kredi me kamata shumë të buta", thotë konsulenti i biznesit, Goran Rafajllovski. Sipas tij, shteti duhet të jetë garant për kreditë për afaristët që do të hapin vende të reja të punës.

Në ndërkohë, Komisioni Evropian në raportin e fundit vlerëson se administrata publike në Maqedoni është e përgatitur në mënyrë të matur në raport me standardet evropiane. Brukseli vlerëson është arritur përparim me miratimin e Strategjisë për reforma në administratën publike dhe menaxhmentin financiar publik. Lavdërohen edhe hapat konkret që kanë rritur llogaridhënien gjatë miratimit të vendimeve.

"Kyçe është të ketë një vullnet të fuqishëm politik për profesionalizimin e administratës publike, që sidomos vlen për emërimet në pozitat më të larta udhëheqëse, respektimi i parimeve të transparencës në bazë të sistemit të meritës, si dhe respektimit të procedurave gjatë emërimeve. Gjithashtu, është e domosdoshme edhe trajnimi i mëtejshëm i administratës me qëllim të implementimit të suksesshëm të procedurave administrative", rekomandon më tej Komisioni Evropian. Kërkohet edhe rritja e kapaciteteve të Ministrisë së Shoqërisë informatike dhe Administratës me qëllim që me sukses të realizojë reformat në administratën publike.

AKADEMIK TAKI FITI PËR PARASHIKIMET E REJA EKONOMIKE

ULJA E RRITJES EKONOMIKE FALËS KRIZËS SË RE POLITIKE

Shkup, 9 tetor - Parashikimet për ulje të rritjes ekonomike (2.5 për qind sipas Bankës botërore dhe 1.6 për qind sipas FMN-së) janë të pritshme dhe i referohen kësaj krize minipolitike, konsideron kryetari i ASHAM-it, akademiku Taki Fiti. "Në situata të këtilla ndryshojnë pritjet e investuesve, përkatësisht të subjekteve ekonomike. Ky është fakt krucial për profilim definitiv të shkallës së rritjes ekonomike. Ligjshmëri e njohur moti ekonomike është se pritjet ndikojnë shumë. Sepse, nëse ndërmarrjet tona dhe investuesit e huaj presin kohë më të këqija, tensione politike, atëherë, thjeshtë, njerëzit nuk investojnë. Nëse vjen deri te zgjedhjet politike, e tërë energjia, mundi, puna do të kthehen drejt zgjedhjeve. Për fat të keq, kur keni zgjedhje politike, njerëzit pak mendojnë për ekonomi dhe biznes, përmbahen edhe investuesit vendorë, edhe ata të huaj", deklaroi kryetari i Akademisë së shkencave dhe arteve të Maqedonisë, e cila sot shënoi 51 vite të themelimit.

Ai konsideron se do të jetë më mirë nëse ndryshimet kushtetuese kalojnë në Kuvend dhe evitohen zgjedhjet, me çka, tha, do të evitohen edhe shpenzime dhe tensionime shtesë. "Dhe të kthehemi drejt proceseve euroatlantike që janë kruciale për Maqedoninë. Afrimi ynë drejt NATO-s do të kontribuojë për derdhje më të madhe të investimeve të drejtpërdrejta të huaja. BE-ja dhe NATO-ja dërgojnë stabilitet - nëse keni stabilitet, gjërat shkojnë shumë më mirë", theksoi Fiti.

Megjithatë, kryetari i ASHAM-it konsideron se edhe pa krizën e re politike, nuk do të mund të realizoheshin 3,2 për qind rritje të parashikuara nga Qeveria sepse, siç tha, mjaft është vonuar me investimet kapitale, projektet janë stopuar dhe mbesin, tha, pak muaj për t'u realizuar e planifikuara.

"Posaçërisht infrastruktura e madhe dhe rrugët kanë efekte të

shpejta, madje edhe në afat të shkurtë. Ato efekte në ekonominë e Maqedonisë, për shkak të varshmërisë së madhe importuese në ndërtimtari nuk janë aq të mëdha sa në vende të tjera më të zhvilluara. Por nëse vjen deri te zgjedhjet politike, duhet të jemi të kënaqur nëse arrijmë me 1,6", tha Fiti. *(Z.V)*

Cerifikata për kompanitë që janë korrekte për konsumatorët

Shkup, 9 tetor - Deri në fund të vitit 46 kompani vendore do të marrin certifikatë "korrekt me konsumatorët" si një lloj garancie se veprojnë ndershmërisht me blerësit apo shfrytëzuesit e shërbimeve të tyre, se ofrojnë prodhime përkatësisht me çmimin, i zgjedhon ankesat apo vërejtjet eventuale kontraktore, me marrëveshje, dhe gjithmonë janë të gatshëm të dalin në ndihmë. Certifikata (veçanërisht logoja me shenjën "korrekt me konsumatorin") do të vendoset në pikat e tyre të shitjes, në paketimet, prodhimet, faqe të internetit apo materialeve promovuese.

Siç sot ishte thënë në konferencë për shtyp, bëhet fjalë për 46 firma nga sektorë të ndryshëm: agjenci turistike, kompani ndërtimore, kopshte private, veprimtari të shitjes me pakicë dhe të shërbimit, prodhues të mallrave për konsum të gjerë,...Të gjitha këto hyjnë në të a.q. fazën e parë dhe certifikimi i tyre do të jetë falas, të mbuluar me mjete të Bashkimit Evropian. "Interesi për certifikimin nuk pritej të jetë aq i madh. madje janë paraqitur edhe zyra të avokatisë, shoqata të sigurimit dhe të financimit për certifikimin e tyre nevojiten kritere shtesë. Për këtë arsye ata do t'i heqim në fazën e parë", theksoi Aleksandar Nikollov nga Asociacioni për Nisma Zhvillimore "Zenit". Ai sqaroi se një ndonjë kompani të marrë certifikatë, nevojitet të përmbushë të paktën 50 për qind nga 25 kushtet e parapara të përcaktuara në gjashtë fusha mes tyre: siguri të konsumatorit, praktike korrekte të tregut, marrëdhënie me shfrytëzuesit dhe mbrojtje të të dhëna personale. Për momentin po përgatiten raporte verifikimi për firmat, ndërsa është formuar edhe Komision te i cili ata mund të drejtohen nëse nuk janë të kënaqur nga ajo që është shkruar për ta në raport. "Tani kërkesa është që kompanitë të përmbushin të paktën 50 për qind të kritereve, por qëllimi është që të arrijnë 100 për qind", potencoi Nikollov.

PRINDËRIT KËRKOJNË SQARIME NGA SHTETI

PSE DISKRIMINOHEN NXËNËSIT E SHKOLLAVE PRIVATE?

Ligji për Arsimin e mesëm parasheh shkollim të mesëm obligues për të gjithë nxënësit, ndërsa transporti publik është falas vetëm për shkollat publike. Për prindërit kjo është diskriminuese ndaj fëmijëve të tyre sepse të gjithë nxënësit duhet trajtuar njëlloj pa dallim feje, etnie, kushteve sociale dhe të tjera. Ndërsa zëvendësavokatja e Popullit e sheh si të padrejtë këtë ligj dhe do të kërkojë plotësimin ose ndryshimin e këtij ligji

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 9 tetor - Nxënësit e shkollave e mesme private janë padrejtësisht të diskriminuar, pavarësisht se në Maqedoni të gjithë njerëzit janë të barabartë me ligj, pa dallim race, kombi, feje...duke përfshirë këtu edhe kategorinë sociale. Diskriminimi është i ndaluar. Për dallim nga shkollat publike, këtyre nxënësve iu mohohet e drejta për të marrë tekste shkollore falas dhe shërbime të tjera si, transport publik falas sepse kategorizohen si "fëmijë të pasurve".

Mirëpo për këtë kanë reaguar prindërit të cilët kanë theksuar se ky është diskriminim social ndaj fëmijëve të tyre sepse shkolla e mesme është detyrim ligjor (obligative), ata janë tatimpagues të rregullt, ndërsa ky shërbim kryhet ndaj nxënësve dhe jo ndaj shkollave. Prandaj prindërit dhe Avokati i Popullit do të kërkojnë ndryshim apo plotësim të Ligjit për shkollat e mesme i cili parasheh transport falas vetëm për shkollat publike.

Për këto dhe shqetësime të tjera, për gazetën KOHA u prononcua prindi Ajet Rexhepi, fëmija i të cilit kishte arritur të fitojë bursën, e cila i mundësonte shkollim falas. Rexhepi kishte dorëzuar ankesë me shkrim deri në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, NTP-Shkup, Qytetin e Shkupit dhe Avokati i Popullit, ndërkaq të njëjtat institucione i kontaktoi edhe KOHA.

"Ligji për transport falas vetëm për shkollat publike është diskriminues dhe këtu nuk respektohet Kushtetuta sepse në qoftë se arsimi i mesëm është obligues për të gjithë, shteti nuk duhet të bëjë ndarje. Djali im arriti të fitoj shkollim falas, por pa marrë parasysh se mund të jem milioner apo punëtor i thjeshtë, shërbimet duhet të jenë të njëjta për çdo qytetarë pa bërë dallime", u shpreh Rexhepi.

Prindërit thonë se fëmijët e tyre nuk duhet kategorizuar në atë mënyrë se sa janë të pasur. Si shembull ata morën vajzës e ministrit Dimitrov, e cila arriti të fitojë bursë nga shtetit disa mijëra dollarë për shkollim jashtë vendit sepse ajo u trajtua njësoj me të tjerët.

Ndërkaq institucionet e kontaktuara po thuajse kishin të njëjtat përgjigje sikurse përgjigjet të cilat i kishte pranuar prindi Ajet Rexhepit, në kërkesën e tij. "Ne mbulojmë 23 shkolla të cilat janë nën kompetencat e Qytetit të Shkupit. Nuk japim subvencione që përfshijnë shkollat private dhe shtetërore dhe për këtë temë duhet të drejtoheni te MASH", deklaruan nga qytetet i Shkupit.

Por ndaj Rexhepit ata ishin përgjigjur se të drejt të transportit falas kanë vetëm nxënësit e shkollave publike (ku bëjnë pjesë edhe shkollat shtetërore) me status "nxënës të rregullt".

Nga MASH u shprehën se kjo është e përcaktuar në bazë ligjore sepse në Gazetën Zyrtare në sipas nenit 3, paragrafi i dytë, shkollim falas parashihet vetëm për shkollat e mesme publike.

Dhe për këtë arsye nga Inspektorati i Arsimit vlerësuan se kërkesa e prindit është e pa bazë.

Kërkesa për transport publik falas për nxënësit e shkollave publike ishte parashtruar edhe deri tek Avokati i Popullit. Për gazetën KOHA, zëvendësavokatja e Popullit, Vaska Bajramovska tha se lënda është ende në procedurë dhe se kanë kërkuar që të gjithë nxënësve t'iu mundësohet transport falas pa dallim se në cilën shkollë mësojnë.

"Duke u nisur nga Konventa për të drejtat e fëmijëve, gjithnjë duhet të kemi parasysh interesin e fëmijëve, në këtë kontekst vendimi i qytetit të Shkupit është trajtim i padrejtë dhe i pabarabartë ndaj nxënësve në shkollat private dhe sipas nesh kjo bëhet nga ana e NTP- Shkup i cili zbaton politikat me qytetin e Shkupit", tha Bajramovska. Sipas saj, bëhet fjalë për qytetarë të Shkupit të cilët rregullisht paguajnë tatime dhe fëmijët e tyre duhet ti përdorin shërbimet, pa dallim se ku mësojnë sepse arsimi i mesëm është obligues dhe shërbimet duhet ti përfshijnë të gjithë nxënësit.

GJYKATA VENDOS NË FAVOR TË BOJAXHI

"TALLJA ME KRISHTIN", DO TË VAZHDOJË TË SHFAQET

Prej më shumë se një muaji nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Filmit pritej që të vërtetojnë nëse është shkelur Rregullorja e filmit dhe vetë Ligji për filmin, pas deklaratave të Ademit dhe Tozijas se ky film do të kalojë edhe një herë në llupën e inspektorëve

Koha Evis HALILI

Shkup, 9 tetor - "Tallja me Krishtin", filmi i regjisorit Jani Bojaxhi, do të shfaqet pa asnjë lloj pengese në të gjitha kinematë në vend. Kështu ka vendosur Gjykata Themelore në Shkup në seancën e së mërkurës, pas kërkesës së Avokatit të Shtetit për të pezulluar përkohësisht shfaqjen e këtij filmi nëpër kinematë në vend, për shkak të gjuhës së urrejtjes. Ministria e Kulturës përmes Avokatit të Shtetit dhe shfaqjes së premierës më 5 tetor në festivalin Kinenova në Shkup, kërkoi që të mos lejohej për një muaj shfaqja e filmit. Në seancën e sotme që drejtohej nga gjykatësja Suzana Donçevska, nuk ishin të pranishëm as përfaqësues të Ministrisë së Kulturës dhe as nga Avokati i Shtetit, por vetëm avokati i shoqatës "Artsinema" që kërkoi anulimin e kërkesës së ministrisë. Shfaqja e filmit do të vijojë në Shtip (të martën në mbrëmje) në Shtëpinë e kulturës, ndërsa në fund të këtij muaji - edhe në Prilep. Mbështetje për filmin regjisori Bojaxhi ka marrë edhe nga presidenti Gjorgje Ivanov. Në profilin e tij në rrjetet sociale, Ivanovi ka publikuar një fotografi me regjisorin ku shkruan "Mbështetje për Bojaxhi".

Filmi "Tallja me Krishtin" shkaktoi skandal një muaj më parë në opinion pas transmetimit të trajlerit. Edhe pse episodet nga lufta e vitit 2001 janë komentuar nga regjisori si pjesë dytësore të skenarit, ato zënë vendin kryesor në trajlerin e filmit, shqiptarë që terrorizojnë, vrasin, përdhunojnë..., të veshur me uniformën e UÇK-së. Filmi merr spunto nga vrasja e të riut maqedonas Vanço Karanfillovit në Tetovë, i qëlluar teksa luante basketboll. Pas skandalit që provokoi në opinion Ministria e Kulturës së bashku me Agjencinë e Filmit u distancuan nga filmi. Prej më shumë se një muaji nga të dy institucionet pritej që të vërtetojnë në ndërkohë nëse është shkelur Rregullorja e filmit dhe vetë Ligji për filmin, pas deklaratave të ministrit Ademi dhe drejtorit të Agjencisë së Filmit, Gorjan Tozija se ky film do të kalojë edhe një herë në llupën e inspektorëve të Ministrisë së Kulturës.

"Komisionet dhe inspektorët do të kontrollojnë të gjitha detajet rreth vendimit për financimin e këtij filmi. Edhe pse kam parë vetëm trajlerin dhe kam lexuar dokumentacionin për këtë film, prapëseprapë mund të konstatoj se ky film është një provokim, një kapriko e regjisorit", pati deklaruar Tozija.

Projekti është mbështetur financiarisht nga Agjencia e Filmit, si një prej filmave më të paguara të vitit 2015 (rreth 300 mijë euro), me regji dhe skenar të Jani Bojaxhi dhe produksion të "Orion production". Xhirimet e filmit filluan në vitin 2017, në fshatin Pomenovë, në Komunën e Çashkës, si edhe në Greqi e Francë, vetë filmi u shfaq për herë të parë muajin e kaluar në Festivalin e Filmit në Montreal. Komandati i formacionit ushtarak në film, i veshur me uniformën e UÇK-së është aktori Robert Ristov, i cili në trajlerin internacional të filmit, shfaqet i shoqëruar me ushtarë të tjerë që me kondakun e pushkëve thyejnë xhamat e një autobusi dhe i drejtohen pasagjerëve me fjalët "Kafshë kaurë dilni jashtë". Terrori me ushtarët e UÇK-së shfaqet edhe në sekuenca të tjera ku ata marrin peng një grup njerëzish që i përdhunojnë dhe torturojnë. Edhe pse në faqen e "Orion Production", regjisori Jani Bojaxhi ndër të tjera thotë se bëhet fjalë për një film që i dedikohet dashurisë, njerëzve që po kërkojnë identitetin e tyre, një rrëfim për frikën e asaj që mund të zbulojnë nga ai kërkim.

Në bazë të nenit 22 paragrafi (8) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 127/16 dhe 35/18 nenit 22 paragrafi (1) alineja 1 të Ligjit për marrëdhënie pune Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013,25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 , 27/2016 dhe 120/18), nenit 12 të Inspektoratit shtetëror për vetëqeverisje lokale Gazeta Zyrtare nr. 158/2010, 187/2013, 43/2014, Inspektorati shtetëror për vetëqeverisje lokale publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të 4 (katër) personave në Inspektoratin shtetëror për vetëqeverisje lokale për kohë të caktuar

Inspektorati shtetëror për vetëqeverisje lokale publikon shpallje për punësim të 4 (katër) personave për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 për vendet e punës në vijim:

1. **Bashkëpunëtor i lartë – Inspektor i pavarur në Departamentin për mbikëqyrje inspektuese të komunave nga rajoni i Vardarit, juglindor, lindor dhe verilindor; INS0101V02001 – 1 realizues**;

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim:
-të ketë të mbaruar shkallën VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar Shkencat juridike ose Shkencat ekonomike;
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
-së paku 2 vjet përvojë pune në profesion;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, frënge, gjermane)

Orari i kohës së punës:
Orët e punës në javë: 40;
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundim të orarit të punës mes orës 15:30 dhe 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 23.232,00 denarë.

2. **Bashkëpunëtor i ri në Departamentin për mbështetje të drejtorit UPR0101V04000 – 1 realizues**

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim:
- të ketë të mbaruar shkallën VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar Shkencat juridike, Shkencat ekonomike ose shkencat politike;
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- me ose pa përvojë pune;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, frënge, gjermane)
Orari i kohës së punës:
Orët e punës në javë: 40;
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundim të orarit të punës mes orës 15:30 dhe 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 20.961,00 denarë.

3. **Bashkëpunëtor i ri për punë financiare materiale dhe furnizime publike UPR0101V04000 – 1 realizues**;

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim:
-të ketë të mbaruar shkallën VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar Shkencat ekonomike;
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- me ose pa përvojë pune;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, frënge, gjermane)

Orari i kohës së punës:
Orët e punës në javë: 40;
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundim të orarit të punës mes orës 15:30 dhe 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 20.961,00 denarë.

4. **Bashkëpunëtor i ri për lajmërim, çlajmërim dhe punë në terminal**
UPR 0101G04000 1 realizues;

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim:
- të ketë të mbaruar shkallën V A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 180 kredi sipas SETK; Gjimnaz/ose arsim të lartë;
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- me ose pa përvojë pune në profesion;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, frënge, gjermane)

Orari i kohës së punës:
Orët e punës në javë: 40;
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundim të orarit të punës mes orës 15:30 dhe 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 13.140,00 denarë.

Kushtet e përgjithshme për të gjitha vendet e punës:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Vendim të plotfuqishëm gjyqësor se nuk i është shqiptuar dënim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët e paraqitur për të gjitha vendet e punës, me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter edhe atë:
- Dëshmi të shtetësisë;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/Diplomë/Dëftesë për kryerje të shkallës së arsimit;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian;
- Dëshmi për përvojën e punës
- Biografi të shkurtë me kontakt të domosdoshëm të telefonit dhe adresë
- Letër motivimi

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar ditën e vet publikimit).
Kushtet e theksuara në shpallje, kandidati duhet t'i përmbushë në momentin e paraqitjes.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet drejtpërdrejtë në arkivin e Inspektoratit shtetëror për vetëqeverisje lokale rr. Kiril i Metodi nr. 54 ndërtesa e Nova Makedonisë kati 2 Shkup (me shenjë "për shpallje për punësim")
Telefoni për kontakt. 3253-941
Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

ЦЕНТР @ЛЕН РЕГИСТАР НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

SHKUP
Numër,04-1835/2
09.10.2018

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 167/2015- teksti i pastruar, 27/2016 dhe 120/2018) dhe neni 5, 6 dhe 7 nga Marrëveshja kolektive e Regjistrit qendror të RM numër 01-866/1 të datës 01.06.2018 dhe nenit 24 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 45/2007 dhe 208/2015), ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës numër 04-1835/1 të datës 09.10.2018, Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ka nevojë për të themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar me 9 (nëtë) realizues për vendet e punës në vijim me kushte të veçanta edhe atë:
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike apo Shkenca për letërsi me së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe së paku një vjet përvojë pune në profesion, për vendin e punës Bashkëpunëtor profesional për planifikim, zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike apo Shkenca organizative dhe menaxhment me së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe së paku një vjet përvojë pune në profesion, për vendin e punës Bashkëpunëtor profesional për furnizime publike dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Informatikë, Teknikë kompjuterike dhe informatikë ose Inxhinieri të telekomunikimit, me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe kurse të specializuara të mbaruara për bazë të të dhënave – MSSQL 2005/2008/2012/versionet aktuale, posaçërisht me dizajn dhe zhvillim të softuerit aplikativ, baza e të dhënave – MSSQL 2005/2008/2012/versionet aktuale të windows 2003/2008/2012, për hosting të softuerit aplikativ - IIS, SharePoint 2010/2013, Visual Studio 6.0/2005/2008/2010/2013/versionet aktuale, C++/C#, .NET, WCF dhe Java, virtualizim – HyperV, Private Cloud, Programues të bazës së të dhënave, në Departamentin për zhvillim të sistemeve informatike dhe pagesa themelore 40.625,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Informatikë, Elektroteknikë ose Teknikë kompjuterike dhe informatikë, me së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku dy vjet përvojë pune në profesion dhe përvojë në konfiguracione dhe menaxhim të softuerit sistemor dhe aplikativ, windows 2003/2008/2012, bazës së të dhënave – MSSQL 2005/2008/2012/versionet aktuale, për hosting të softuerit aplikativ –IIS, njohje të SharePoint 2010/2013, Visual Studio 6.0/2005/2008/2010/2013/versionet aktuale, C++/C#, .NET, WCF dhe Java, virtualizim – HyperV, Private Cloud, në vendin e punës Administrator për mbështetje të e-shërbimeve dhe konsumatorëve, në Departamentin për mbështetje dhe në sistemet regjistruese dhe afariste procesuese, e-shërbime dhe konsumatorë dhe pagesa themelore 39.402,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike ose Ekonomike, me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat dhe vërtetim për provim të dhënë për menaxhim administrativ të vendit të punës Person përgjegjës për punën e RRK Manastir dhe pagesë themelore 45.273,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike ose Ekonomike, me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat dhe vërtetim për provim të dhënë për menaxhim administrativ të vendit të punës Person përgjegjës për punën e RRK Shtip dhe pagesë themelore 45.273,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike ose Ekonomike, me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat dhe vërtetim për provim të dhënë për menaxhim administrativ të vendit të punës Person përgjegjës për punën e RRK Veles dhe pagesë themelore 45.273,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike ose Ekonomike, me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale, së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat dhe vërtetim për provim të dhënë për menaxhim administrativ të vendit të punës Person përgjegjës për punën e RRK Prilep dhe pagesë themelore 45.273,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike ose Politike, me së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të përgatitjes profesionale dhe me së paku një vit përvojë pune në profesion, në vendin e punës Bashkëpunëtor profesional në RK, në RK Gostovar dhe pagesë themelore 31.574,00 denarë;

Kandidati i cili do të paraqitet në Shpalljen publike, duhet ti plotësojë kushtet në vijim:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive të njohë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës, me orar javor të rregullt të punës prej 40 orëve (5 pesë ditë pune në javë)
- Orari ditor i punës zgjatë 8 orë dhe fillon prej orës 8,00 dhe përfundon në ora 16,00.

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentet në vijim (kopje):
- Lutje me biografi të shkurtër (CV);
- Certifikatë shtetësie;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (Certifikatë mjekësore);
- Dëshmi që me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë (Diplomë) për arsimin e mbaruar;
- Vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetim për njohje aktive të një prej tre gjuhëve botërore që përdoren më së shpeshti të Unionit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Dëshmi për përvojën e punës së nevojshme (dëshmohet me Vërtetim nga APRM apo Fond për SPIM) dhe institucionit në të cilën ka punuar kandidati.

Kandidatët e interesuar, lutjen së bashku me dëshmitë për plotësim të kushteve sipas kësaj shpallje mund ti dorëzojnë në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e publikimit të shpalljes, drejtpërdrejtë në arkivin e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë, bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1 ose përmes postës. Telefoni për kontakt 3 288 146, personi për kontakt Andrijana Anastasovska Kitanova.

Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë zgjedhjen do ta kryen në afat prej 45 (dyzetepesë) ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje, ndërsa nëse ka më shumë se 200 të paraqitur zgjedhja do të bëhet në pajtim me afatet e caktuara ligjore.

Lutjet e dorëzuara të pakompletuara dhe pas afatit nuk do të merren parasysh.

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë Shkup

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Vendim për transferimin e plotë të A – Lejes për harmonizim me planin operativ prej MZT " Learnica" AD Shkup
Në
Kast Invest DOO Shkup
rr. Pero Nakov nr. 120
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

Instalacioni Kast Invest DOO Shkup rr. Pero Nakov nr. 120, 1000 Shkup, dorëzoi kërkesë për transferimin e plotë të A – Lejes për harmonizim me planin operativ nr. 11-3841/2 nga 28.03.2014 v.
Instalacioni bjen nën aktivitetet nga Shtojca I
Pika 2.4
Fonderi për ferometale me kapacitet të prodhimit mbi 20 t/ditë.

Lloji i aktivitetit: Prodhimi i derdhjeve metalike nga giza e murme dhe metalet me ngjyrë.

Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor sjell:

Vendim për transferimin e plotë të A – Lejes për harmonizim me planin operativ prej MZT " Learnica" AD Shkup
Në
Kast Invest DOO Shkup
rr. Pero Nakov nr.120
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

Vendimi do të shpallet edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk

Rreth 70 për qind e lodrave në treg janë të pasigurta

Shkup, 9 tetor - Rreth 70 për qind e lodrave në tregun e Maqedonisë janë të pasigurta, shiten në ambient të hapur, në tregje, nuk kanë deklaratë adekuate, as edhe informatë për përbërjen kimike, fizike apo të sigurisë. Ky është vlerësimi i Asociacionit qytetar "Gazetarë për të drejtat e njeriut" e cila ka zbatuar hulumtim për gjendjen me lodrat në tregun e Maqedonisë, me qëllim të ngritët vetëdija për sigurinë e tyre dhe të bëhet krahasim me rezultatet e hulumtimit bërë në vitin 2013.

Në prezantimin e rezultateve nga hulumtimi, Natasha Dokovska nga "Gazetarë për të drejtat e njeriut" e cila është koordinatore e projektit ka thënë se në Maqedoni shiten më pak lodra të sigurta ose shiten më pak lodra të brenduara. "Ka 17 kompani ku qëllimi parësor është importi i lodrave të markuara, por vetëm katër prej tyre importojnë lodra ekologjikisht të sigurta të cilat prodhohen në botë, ose bëhet fjalë për 20 brende të pranuara. Të gjitha lodrat tjera në tregun e Maqedonisë janë të pa markuara", ka thënë Dokovska. Ka shtuar se në vitin 2013 në tregun e Maqedonisë kanë qenë prezente 50 brende, tani 20.

"Supozoj se duhet të edukohemi për atë se çka duhet të përmbajnë lodrat, të kemi kujdes se çka blejmë, ta ndjekim listën Rapeks e cila është mjet i BE-së ku në çdo javë publikohen gjitha produktet të cilat janë të ndaluara në tregun evropian. Testimi i lodrave në Shkup dhe Manastir ka treguar se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë pasur deklaratë adekuate, ndërsa më shumë se gjysma kanë pasur shenja që kanë treguar se janë toksike.

"Mbi 70 për qind e lodrave janë të pasigurta dhe përmbajnë pjesë të imëta, ndërsa zhurma tek të gjithë është pothuajse e palejuar ose mbi 85 decibel. Për sigurinë e lodrave është e angazhuar Inspektorati shtetëror dhe sanitar, ndërsa për importin dhe përcjellien e tyre Ministritë e Shëndetësisë, Mjedisit Jetësor dhe Ekonomisë", ka shtuar Dokovska. *(Q.A)*

NË PRAG TË SEZONIT TË DIMRIT, APEL PËR PASTRIMIN E OXHAQEVE

PATRONI OXHAQET, SHPËTONI NGA ZJARRET

"Zakonisht në këtë periudhë përdoret druri për ngrohje nga i cili formohet shtresë e trashë dhe e njëjta krijon temperaturë të lartë që shkakton zjarri. Gjatë kësaj kohe ka pasur shumë zjarre të këtilla, por në të njëjtat është intervenuar në kohë dhe nuk ka pasur rreziqe më të mëdha. Temperatura në oxhaqet e pa pastruara arrin derri 800 gradë dhe mund të imagjinoni se çfarë temperature është kjo...", thotë Uka Aliti

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 9 tetor - Komandanti i Njësisë territoriale kundër zjarrit në Tetovë, Uka Aliti, apelon deri tek qytetarët e rrethit të Tetovës që të pastrojnë oxhaqet në shtëpitë e tyre, pasi mospastrimi i tyre mund të shkaktojë shpërthim të zjarrit i cili mund të jetë edhe fatale. Nga kjo njësi theksojnë se zjarret përsëriten në banesat ku me herët ka pasur zjarre. "Pastrimi i oxhakut nuk duhet të bëhet sepse ne apelojmë apo kërkojmë, por duhet që të bëhet sepse vetë qytetarët do të jenë më të sigurt dhe nuk do të vie deri tek shpërthimi i zjarrit. Po ashtu, një dukuri tjetër është se këto zjarre shpërthejnë edhe në ndërtesa kolektive në Tetovë. Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi pasur mbi 30 raste të ndezjes së oxhaqeve dhe ajo që është më e keqja - shumica e zjarreve janë në ndërtesat ku kemi pasur zjarre edhe vite më parë. Kjo ndodhë për shkak se të gjithë banorët në të njëjtën ndërtesë nuk i shfrytëzojnë oxhaqet dhe kjo bën që të mos kenë interesim të gjithë për pastrimin e tyre. Në shumë ndërtesa kemi ngjitur edhe pamflete ku bëjmë apele për pastrimin e oxhaqeve në bashkëpunim me Komunën e Tetovës", thonë nga njësia e zjarrfikësve.

Kreu i Brigadës së zjarrfikësve, Uka Aliti, thekson se mospastrimi i tyre paraqet rrezik potencial për shpërthim të zjarreve.

"Zakonisht në këtë periudhë përdoret druri për ngrohje nga i cili formohet shtresë e trashë dhe e njëjta krijon temperaturë të lartë që shkakton zjarri. Gjatë kësaj kohe ka pasur shumë zjarre të këtilla, por në të njëjtat është intervenuar në kohë dhe nuk ka pasur rreziqe më të mëdha. Temperatura në oxhaqet e pa pastruara arrin derri 800 gradë dhe mund të imagjinoni se çfarë temperature është kjo. Në rastet kur shpërthen zjarri, duhet që të mbyllet kapaku i tyre dhe të mos hidhet ujë ngase vjen deri tek shpërthimi i oxhakut", thotë Aliti.

Sipas tij, qytetarët tashmë duhet të kenë të pastruar oxhaqet, sepse në këtë kohë shumica e zjarreve vijnë si pasojë e mospastrimit të tyre.

Kreu i zjarrfikësve në Tetovë më tej thotë se problem kohëve të fundit janë edhe ndërtesat shumëkatëshe. "Ajo që është më brengosëse janë objektet shumëkatëshe, apo objektet kolektive-ndërtesa që janë në qytetin e Tetovës. Apelojmë të ndërmarrin masa në drejtim të pastrimit të oxhaqeve për arsye se në këto raste hasim në shumë probleme kur intervenojmë pasi objektet janë të larta mbi dhjetë kate dhe qytetarët tanë përdorin drunjë, mirëpo oxhaqet gjithsesi apelohet që të pastrohen, pasi edhe me ligj qytetarët obligohen që oxhaqet e tyre ti pastrojnë dy herë në vit. Uroj që këtë dimër ta kalojmë pa paraqitje të zjarreve, meqë tashmë dihet se zjarret lënë pasoja nga më të ndryshmet, andaj duam që qytetarët tanë të jenë të sigurt dhe të mbrojtur", apelon Aliti.

Po ashtu, edhe Policia e Tetovës konfirmon se shpeshherë zjarret shkaktohen nga oxhaqet e dëmtuara apo të pa pastruara.

"Për shkak të kësaj, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë apelon deri tek qytetarët që në kohë të pastrojnë oxhaqet para fillimit të sezonit dimëror, por edhe gjatë gjithë kohës të kontrollohet gjendja e tyre, ngase mjafton një shkëndijë kurse pasojat janë të paparashikueshme", thotë Marjan Josifovski, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Nga ana tjetër pastruesit e oxhaqeve disa herë kanë kërkuar që ata të veprojnë në kuadër të Komunës së Tetovës, ndërsa pastrimi i oxhaqeve të jetë i obligueshëm, por deri më tash nuk ka përgjigje reciproke rreth kësaj ideje.

REAGON ECO GUEIRLLA

UJI I TETOVËS, PËRGJEGJËSI EDHE NGA ZAEVI

Tetovë, 9 tetor - Pas gjendjes së krijuar me aromën e pakëndshme të ujit të Tetovës, lëvizja qytetare Eco Guerilla ka dalë me një reagim ku kërkon përgjegjësi edhe nga kryeministri Zoran Zaev. "Gjatë ditës së djeshme, një numër i madh i qytetarëve të indinjuar dhe bizneseve private na kanë kontaktuar për të mësuar për problemin e ujit të pijshëm me erë kimikatesh në Tetovë. Duke mos pasur informacione të besueshme se çka në të vërtetë përmban uji, ne nuk mund të japim informacion për këtë problematikë me të cilën shpesh po përballemi si qytet. Në anën tjetër, kemi heshtje dhe papërgjegjësi nga kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, e cila në një situatë kaotike si kjo, nuk doli të prononcohet dhe të sqarojë problemin e ujit. Qytetarët janë të hutuar dhe në panik se si të sillen me ujin e pijshëm për ta dhe fëmijët e tyre. Kërkojmë përgjegjësi direkte edhe nga kryeministri Zoran Zaev për skandalet e njëpasnjëshme që po ndodhin në qytetin tonë, si pasojë e paaftësisë së Komunës dhe kryetares Arifi. Problemet me ujin e pijshëm, me bërllokun, papastërtinë e madhe në qytet, uzurpimin e hapësirave publike, jo transparencën financiare, trafiku urban, parkingjet, etj. Kryeministri personalisht ishte në krye të fushatës për të zgjedhur këtë kryetare që kemi. Në vende udhëheqëse emërohen njerëz të paaftë dhe jokompetent për detyrat që kanë. Urgjentisht kërkojmë që Qeveria t'ja marrë ingerencat e Komunës së Tetovës për paaftësinë për të menaxhuar qytetin me problemet e përditshme me te cilat po ballafaqohet. Nëse kjo gjendje e padurueshme vazhdon, reagimi qytetar do të jetë shumë i ashpër", thuhet në reagimin e lëvizjes Eco Guerilla. *(U.H)*

O s'ma nin bre!!!

Nga
Adelina MARKU

E pres veten, aq shumë gjatë kohë e pres , të pëlcasë një ditë e të them : ''O s'ma nin bre!!!! O nuk asht ka ma nin bre!!!"...E pse aq e vështirë është me thanë : ''nuk ma nin?! Thuje - krisja!"- më thonë !

Ndërsa arsyeja se përse nuk dua të shpërthej në këtë mënyrë është e natyrës religjioze më shumë , është tek përgjegjësia që njeriu ia mvesh vetes gjatë rritës së vet dhe tek dorëzimi ...që do ishte mallkimi më i keq , apo! Sepse të jetosh në një shtet si ky yni, që pak a shumë ka filluar të plotësojë të paktën një nga 4 kushtet e shtetit të dështuar, është njësoj sikur të improvizosh me qenien tënde aty! Dhe jo më larg se dje, isha duke menduar se sa kaptinë filozofike mund të duket dilema : ''Sa ne për shtetin apo sa shteti për ne ? ''...e përfundimi im është më rigoroz , ngase ne kemi bërë më shumë se sa shteti për ne! Ky është fakt, vështirë se mund të përdëftohet e kundërta.

Katër kushtet e shtetit të dështuar janë si vijojnë : humbja e kontrollit në teritor të shtetit, erozioni I autoriteteve legjitime për të bërë vendime kolektive , pamundësia për të ushtruar me shërbime publike (e këtu edhe dhënia e rrogave ...) si dhe e katërta, paaftësia për të krijuar interakcion me shtetet e tjera e për t'u bërë anëtar i plotfuqishëm i organizatave ndërkombëtare. Dorën në zemër, tre të parat ende i shoh si të largëta , sado erozioni për të krijuar konsensus mbarëshoqëror asnjëherë nuk e arriti standardin e vlerës politike e shoqërore këtu tek ne , prandaj dhe ka degjeneruar skajshmërisht ndërsa pritej të evoluonte! Ndërsa shërbimet publike, aty janë ende, por nuk e riprodhojnë veten , nuk e arsyetojnë veten prandaj janë të standardit nën-mbijetimor, ky standard në rrënie e sipër krijon edhe sensin e jashtëzakonshëm të pasigurisë në shtet. I vetmi kusht që është stabil , është sovraniteti teritorial, ndërsa paaftësia kronike e ndërvartësisë progresiste e për të materializuar fitimin ekonomik mes shtetit ku jetojmë me shtete fqinje e të tjerat , kronikisht po vuan nga virusi i mohimit, negimit madje dhe megalomanisë së tipit të Enver Hoxhës : ''edhe bar do hamë ...!"

Qytetari i këtij shteti po plaket ...ndërsa adrenalina bjen! Secili nga ne , po mundohet të strehojë fëmijët jashtë dhe ky mendim, ky shqetësim , flet për apati fillimisht por që mëtejdo shndrohet në paranojë shoqërore.

Ajo që shkoi mirë në shtet peshon shumë më pak se ajo që shkoi keq për kaq shumë vite këndej, dhe kjo jo-barazi është e dukshme e për më shumë , çahet dita ditës...Janë krijuar të tilla zezona në shoqëri , që as edhe një politikë progresiste nuk mund t'iu vardiset mbarë e për t'iua ndryshuar energjinë. Sepse, nëse çdo gjë mund të duket e bukur në letër e në TV, asnjë gjë nuk mund të duket e plotë - PA BESIM e PA NDJENJË PËRKATËSIE SHTETËRORE!

Dikur, kisha pat lexuar Antonio Gramshin...një marksist ky properëndimor (Ëestern Marxism) , e në atë kohë, nuk arrija dot të kapja dimensionin e filozofisë së tij politike për nevojën e ndryshimit në shoqëri përmes revolucionit pasiv ,, paj edhe në një si kjo e jona...Le t'a atribuoj periudhën e 2001 dhe Revolucionin e larmë , si revolucione sociale a , ...dhe jo si pasive , ndërsa këtë që po e shoh sot të ndodhë - po e gjej të kornizuar si me dorë nga vetë Gramshi...fatkeqësisht! Ndoshta..., matrica e një rregjimi të kaluar - ai projugosloven , ku hegjemoni kuturonte mëndjet e qytetarëve (votuesve) është ende në damarët e lidershipt këtu, prandaj dhe votuesit a! Nga prespektiva e sotme , e kuptoj më së miri filozofinë e Gramshit ngase ky madje i bënte një asociacion asaj kohe këtij lloj revolucioni me fashizmin Italian. Hmmm, edhe fashizmi për të ardhur, nevojitej reformë apo! Reformatim shoqërie ...ngadalë, ngadalë, revolucion pasiv a! Por nga prespektiva e sodit, leximi i teorisë së Gramshit barazohet jo më në kryengritjen (revolucionin social) por në rolin e ndikimin e shoqërive civile dhe institucioneve shtetërore njëkohësisht për të adresuar qytetarit reformën e re në shoqëri! Gramshi thirej në të ashtuquajturën nevojë

Në Maqedoni, u testuan edhe revolucionet e zhurmshme sociale e të armatosurat, por edhe ato pasivet në vazhdimësi... asnjëra nuk mer formë të mjaftueshme për të shndërruar këtë shoqëri në funksionale... Dhe , kur sot vras mëndjen thellë, në pesimizëm e pyes veten , si më tej, përgjigja është e vakët: u mbyt organika e kësaj shoqërie tanimë, prandaj hegjemonitë populiste djegin atë ...shkrumas!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 9 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

për të konstruuar NDRYSHIM ORGANIK në shoqëri. Sado kontradiktore të duket kjo! Këtë , ai e quante taktikë fillestare për të kaluar tek taktiyimi me edukimin e të rrinjve , ku prodhimi institucional mësimor do ishte i nacionalizuar deri në atë masë centriste - që ne leximin e sotëm libertarian do e përjashtoja si të dëmshëm sepse është përjashtues për Tjetrin . Taktika tjetër do vazhdonte në përdorimin e gjuhës, ku Gramshi do thirej në një si tip institucionalizimi të hegjemonisë kulturore në shoqëri (hegjemoni multikulturore quaje po deshe !) , dhe kontrollimin e rreptë të përdorimit të gjuhës së Tjetrit . Gramshi përjashtonte influencimin e fesë në shoqëri , duke e minimizu paraqitjen e saj deri në lokalizim , ndërsa poaq e utilizonte përdorimin e mediave në formë taktizuese - duke iu atribuar nevojës së saj për përdorim "propagandistik" në inspirimin e revolucionit pasiv!

Hmmm, nguca pak Gramshin për t'a bindur veten e tuj e nda me ju me gjasë se , gabimi i shoqërisë sonë qëndron pikërisht tek amplitudat joorganike të revolucioneve -pra, kryengritjeve sociale ! Pas tyre ...si me një rregjim të përçudnuar e nga Qeveritë e reja reformatore vendoset Revolucioni pasiv , i cili poaq dëshiron të kontrollojë lirinë kulturore, tuj adresu vlera hegjemone institucionale e në kontekstin e sotëm - përmes shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore. Sepse ...ja , si për fillim po ju pyes: a keni dëgjuar derimëtani shqoqërinë civile të adresojë nevojën për liberalizimin e përdorimit të gjuhëve të Tjetrit në shoqëri e për kaq vite të funkcionimit të tyre ? Unë , nuk kam dëgjuar një thirje të tillë sot e pesë dekadat e mia! Prandaj...hmmm, në Maqedoni, u testuan edhe revolucionet e zhurmshme sociale e të armatosurat, por edhe ato pasivet në vazhdimësi... asnjëra nuk mer formë të mjaftueshme për të shndërruar këtë shoqëri në funksionale... Dhe , kur sot vras mëndjen thellë, në pesimizëm e pyes veten , si më tej, përgjigja është e vakët: u mbyt organika e kësaj shoqërie tanimë, prandaj hegjemonitë populiste djegin atë ...shkrumas!

Nuk më pëlqen...nuk më pëlqen...Kam lodhje...prandaj, gjëmoj në mos-besim!

Kupën sot e shoh të shprazur!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

Tre anarki të heshtura

Nga
Festim POLLOZHANI

Në një momentum politik kur Maqedonia është ndalur në një "pit-stop" duke kërkuar orientimin e saj politik drejt lindjes ose perëndimit, shqiptarët e Maqedonisë po vazhdojnë të përballen me anarki sui generis, të cilat një kohë të gjatë po e mbajnë peng këtë strumbullar.

Ngjajnë si anarkitë e Nolit, në një kohë kur shqiptarët ishin në pozitë krejt tjetër, por sot anarki të ngjashme e kanë kapluar strumbullarin shqiptar matanë kufijve administrative dhe duket se askush nuk mërzitet për këtë edhe pse shqiptarët në Ballkan sot kanë dy shtete të pavarura.

Po e filloj nga anarkia e parë me gjasë më e rëndësishmja, më substancialja - anarkia politike. Në aparencë është krijuar një rreth politik nga i cili nuk ka dalje dhe e njëjta gjë vazhdon të përsëritet dhe ngjan si një qark i mbyllur.

Individë (figura) që krijojnë struktura, të njëjtët që në vitet e 90' e ulën partinë e vetme politike shqiptare në prehër të politikës për shtet një etnik maqedonas (përkufizim ky që ngjan folklorik, por rezultoi i vërtetë) nën ombrellën e një vëllazërim-bashkimi të rrejshëm, ose me tendencën se politikani shqiptar duhet të jetë me çdo kusht i pranueshëm nga politika maqedonase, po e luajnë të njëjtën lojë sot, nën maskën e analistëve, opinion dhënësve dhe nga pozita tjera kuazi intelektuale, kuazi vizionare. Të tillët përveç kësaj e kanë edhe aftësinë e ripërshtatjes, ose rehatimin e lehtë në çdo strukturë të re partiake që ngjan shumë me përshkrimin e politikanit kroat Stipe Mesiq në memoaret politike të tij, ku flet për servilizmin politik deri në atë masë (pa dashur ta banalizoj) sa edhe kur ish kryetari Tugjman duke luajtur tenis e nxirrte topin jashtë fushe, figura të caktuara brohorisnin "bravo kryetar".

A mund të jenë avangardë të një politike vizionare, progresive dhe për më tepër pro evropiane figurat veçmë të sprovuara politikisht dhe me sa kam lexuar, të dështuara?! Jo, por nuk ka kush ti shtyjë jashtë skenës politike - prandaj kapaciteti intelektual i të rinjve që duan të kontribuojnë politikisht mbetet i pashfrytëzuar dhe citoj Platonin me një thënie: "Ndëshkimi më i rëndë për të vendosur të angazhohesh në politikë, është të urdhërohesh nga dikush, që është inferiori juaj".

Është mëkat që kapaciteti intelektual dhe shoqëror i të rinjve të ngulfatet dhe së këndejmi ata kërkojnë një shteg jashtë vendlindjes në mënyrë masive dhe nuk ka asnjë mekanizëm që ta ndalë këtë fenomen.

Anarkia e dytë që e ka kapluar strumbullarin shqiptar në Maqedoni është anarkia fetare. Jemi në një pozitë ku pothuajse nuk mund të flasim për shqiptarët katolikë ose ortodoksë që vazhdojnë të frymojnë me gjithë tendencat shumë dimensionale për asimilimin e tyre në kohë më të vështira por që vazhdon edhe sot. Po them se elementi fetar është i rëndësishëm dhe askush nuk e mohon këtë, por në asnjë mënyrë nuk guxon të përdoret si instrument i përçarjes. Margjinalizimi i shqiptarëve të krishterë tenton të fshehë të vërteta tjera, si për shembull nëse tash si orientim themi: "jam në Shkup te Trgovski ", në një paralele tjetër do thonim: "jam te lagja e shqiptarëve katolikë" ose "jam këtu përballë shtëpisë së Serreqëve, Bojaxhive etj"; ose duke qenë nga Struga nuk mund të themi se një djalosh nga familja Mato në Strugë në vitin 1943 e ka ngritur flamurin shqiptar në dritaren e shtëpisë, ose që ka familje të cilat deri para dy - tre brezash kanë qenë e njëjta familje,kurse sot bëhen të huaj për shkak të kësaj ndasie. Realitete të prekshme por që nuk guxon ti përmendë askush ose të ndërmarrë iniciativë konkrete në këtë drejtim . Kthimi në identitet i kësaj pjese të asimiluar të kombit duhet të jetë detyrë primare e politikës dhe shoqërisë duke ua zgjatur dorën dhe jo duke i larguar me theksimin e ndasive fetare duke e anashkaluar përkatësinë kombëtare. Edhe unë jam mysliman për nga përkatësia fetare, por askush nuk mund të më thotë se nuk i kam vëllezër shqiptarët e krishterë dhe mos e harrojmë Veqilharxhin, i cili ka thënë se: "Nuk ka kështillë më të keqe nga ajo që e shtyn njeriun të mohojë kombin e vet". A nuk po e bëjmë ne këtë gjë në mënyrë indirekte dhe të heshtur?!

Individë (figura) që krijojnë struktura, të njëjtët që në vitet e 90' e ulën partinë e vetme politike shqiptare në prehër të politikës për shtet një etnik maqedonas (përkufizim ky që ngjan folklorik, por rezultoi i vërtetë) nën ombrellën e një vëllazërim-bashkimi të rrejshëm, ose me tendencën se politikani shqiptar duhet të jetë me çdo kusht i pranueshëm nga politika maqedonase, po e luajnë të njëjtën lojë sot, nën maskën e analistëve, opinion dhënësve dhe nga pozita tjera kuazi intelektuale, kuazi vizionare

Anarkia e tretë, por jo më pak e rëndësishmja është anarkia arsimore. Nuk dua ta bëj punën e institucioneve përkatëse por dikush duhet të thotë se një arsim pa vlera të mirëfillta mund të jetë regresiv. Lejimi i funksionimit të universiteteve pa asnjë kriter, në raste edhe duke e bërë thjesht këmbimin diplomë - para, absolutisht rrezikon të prodhojë analfabetë funksional. Lejimi i degradimit me rektorë (që duhet të jenë shtylla e universitetit) me tituj të dyshimtë akademikë krijon rektorë me komplekse akademike - fenomen që për hir të së vërtetës mund të jetë prezent edhe në botën perëndimore por atje me tu zbuluar, personi jep dorëheqje nga funksionet publike si akt moral. Ndikimi i politikës në përzgjedhjen e kuadrove akademike nuk duhet të jetë prezent sepse prodhon dy efekte negative: prodhimin e një klase studentore të papërgjegjshme dhe nga ana tjetër heshtjen e klasës akademike kundrejt devijimeve politike shoqërore dhe institucionale. Nëse universitetet si nivel më i lartë akademik i shoqërisë heshtin, atëherë kush mund të flasë për devijimet në fjalë?!

Strumbullari shqiptar në Maqedoni ka nevojë të lirohet nga këto tre anarki që janë shndërruar në fenomene, është një situatë e cila po shndërrohet në gjendje, një gjendje e cila po e dëmton në mënyrë të heshtur trungun shqiptar në Maqedoni. Kush duhet të shqetësohet për këtë gjë më shumë se shtetet amë?!

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Bëhuni gati, Gjermania ka hapur 370 mijë vende pune për të huajt

Gjermania ka mbërritur një nivel rekord punësimi të europiano-lindorëve. Në 50 për qind të vendeve të punës të krijuara në këtë vend punësohen të huaj, e shumica vijnë nga Polonia e Rumania.
Duke iu referuar shifrave nga Agjencia Federale e Punës, "Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung" ka shkruar se, në korrik të këtij viti, numri i të punësuarve në Gjermani u rrit me 700 mijë vetë krahasuar me një vit më parë. I njëjti burim ka sqaruar se, gjysma e tyre, apo rreth 370 mijë vetë janë të huaj.
Pjesën dërrmuese të këtyre të fundit e përbëjnë të punësuarit nga vendet lindore të BE-së. Sa iu takon shteteve jugore, niveli më i lartë i punësimit rezulton ai i qytetarëve nga Greqia, Italia, Portugalia e Spanja. Ka edhe një rritje të numrit të refugjatëve të punësuar, ndonëse kjo është më modeste.
Ministri Federal i Punës, Hubertus Heil i ka thënë kësaj gazete se, pa lirinë e lëvizjes, e cila u vjen përshtat shumë punëmarrësve në Evropë, në profesione të caktuara, tregu gjerman do të haste vështirësi të mëdha.
Ndërkohë, ministri i Brendshëm Horst Seehofer, ka sqaruar nga ana tjetër për "Welt am Sonntag" se ligji i emigracionit do të sqarojë me "kritere të pastra" sesi duhen trajtuar emigrantët, të cilët punojnë prej vitesh me statusin "i duruar" dhe që ndodhen para dëbimit.

Beogradi pësoi disa ditë bombardime dhe u pushtua shumë më herët se sa ishte planifikuar më 12 prill 1941, falë një grushti njerëzish me armë të vogla, të udhëhequr nga kapiteni i njësisë së forcave Waffen, Fritz Klingenberg, një 26-vjeçar i cili ka fituar reputacionin e një njeriu kokëfortë

KUR GJERMANËT MORËN BEOGRADIN ME VETËM SHTATË USHTARË

Kur forcat gjermane u nisën në Ballkan në pranverë të 1941-ës, ata nuk u përballën vetëm me rezistencë të armatosur, por edhe me terrenin e vështirë dhe motin e keq. Përparimi i forcave italiane në Greqi, ndikoi që britanikët të ndihmonin Athinën, duke kërcënuar krahun jugor gjerman. Italiani Benito Mussolini dërgoi 500.000 ushtarë në Ballkan dhe në gjashtë muajt e parë ai humbi 63.000. Lartësia mbidetare dhe moti me borë që zgjati deri në muajin maj, pamundësuan konvojet gjermane të arrinin deri te furnizimet dhe fitorja varej më shumë nga linja e furnizimit të sigurt sesa fuqia ushtarake, shkruan Historynet, transmeton kp.

Të gjitha vendet kyçe duhej pushtuar shpejt dhe objektivat kryesore ishin qytetet. Gjermanët prisnin kapitullimin e Greqisë, kështu që Athina dhe portet greke do të binin në duart e tyre. Në këtë mënyrë baza greke e Forcave Ajrore Gjermane Luftwaffe dhe Forca Detare Kriegsmarine do të forconin kontrollin në Mesdheun verilindor dhe të ndihmonin me furnizimin e trupave në Afrikë. Frika se Pavle Karagjorgjeviq mund të mbante anën e krahut fashist, nxiti ambasadorin jugosllav në Uashington që të dërgonte një peticion në Beograd, duke kërkuar nga princi serb që të mos i dorëzohej kreut nazist, Adolf Hitler.

Mbreti britanik George VI dhe kryeministri Winston Churchill i dërguan një mesazh Karagjorgjeviq dhe kryeministrit jugosllav Dragisha Cvetkoviq. Churchill parashikoi se nëse Jugosllavia "bëhet pjesëmarrëse në vrasjen e grekëve, shkatërrimi i saj do të jetë i sigurt dhe i parevokueshëm". Më 20 mars, Karagjorgjeviq zyrtarisht njoftoi se vendi i tij do të bashkohej me Paktin Trepalësh. Në një takim me ambasadorin e SHBA Arthur Bliss Lane, ai theksoi se nëse nuk bashkohet me Paktin, nuk do të jetë në gjendje të llogarisë në mbështetjen e kroatëve në pushtimin nga gjermanët.

Më 24 mars 1941, kryeministri Cvetkoviq dhe ministri i Jashtëm, Aleksandar Cincar-Markoviq udhëtuan në Vjenë në fshehtësi. Marrëveshja u nënshkrua më 25 mars dhe u kthyen në shtëpi. Në Beograd ata u përballën me grushtshtetin që nisi natën e 26 marsit. Zyrtarët ushtarakë jugosllavë pushtuan bazat ushtarake, aeroplanë dhe ndërtesa qeveritare, duke rrëzuar qeverinë e dobët jugosllave brenda natës. Cvetkoviq u arrestua. Princi Karagjorgjeviq u kap në Zagreb dhe u detyrua të largohej nga detyra. Qeveria e re njoftoi se do të mbetet besnike ndaj Paktit Trepalësh. Më 6 prill 1941, ministri i Jashtëm gjerman Joachim von Ribbentrop urdhëroi sulm mbi Jugosllavinë.

Beogradi pësoi disa ditë bombardime dhe u pushtua shumë më herët se sa ishte planifikuar më 12 prill 1941, falë një grushti njerëzish me armë të vogla, të udhëhequr nga kapiteni i njësisë së forcave Waffen, Fritz Klingenberg, një 26-vjeçar i cili ka fituar reputacionin e një njeriu kokëfortë. "Klingenberg është inteligjent, por kokëfortë, besnik, i shkëlqyer nën presion, por arrogant deri në masën e mos dëgjimit", përkujton një nga oficerët e tij të mëparshëm komandues.

Arritja në Beograd nuk ishte e lehtë dhe pas disa orë vëzhgimi që i bëri qytetit, një nga njerëzit e Klingberg gjeti një barkë të braktisur në lumin Danub. Klinberg kishte vetëm gjashtë ushtarë me vete, por vendosën të depërtojnë thellë në qendër të qytetit. Ata përparuan ngadalë duke u maskuar me rroba burgu, duke kaluar pikat e kontrollit pa shkaktuar asnjë dyshim.

Klingenberg urdhëroi udhëheqësin e grupit Hans Hossfelder të largojë flamurin jugosllav në qytet dhe ta zëvendësojë me atë gjerman, më 12 prill. Me urdhër të tij, ushtarët nisën të patrullojnë rrugëve, duke iu dërguar porosi qytetarëve se ata kanë marrë tashmë qytetin, ndërkohë që prefekti i Beogradit iu bind ultimatumit të Klingenberg për dorëzim pa kushte. Në këtë mënyrë, ai me një grup të vogël njerëzish mori qytetin, duke zënë rob 1.300 ushtarë të dorëzuar pa shkrepur asnjë plumb, dhe iu hapi rrugën forcave tjera gjermane të mbërrinin në qytet.

Për aktin e tij të guximshëm, Klingenberg u nderua me Kryqin e Hekurt dhe u bë një i preferuar në qarqet naziste. Kur filloi pushtimi i Bashkimit Sovjetik, Klingenberg edhe njëherë demonstroi aftësitë strategjike në betejat në Krakov, Minsk dhe Kurska, ndërsa u vra më 23 mars 1945.

Për aktin e tij të guximshëm, Klingenberg u nderua me Kryqin e Hekurt dhe u bë një i preferuar në qarqet naziste. Kur filloi pushtimi i Bashkimit Sovjetik, Klingenberg edhe njëherë demonstroi aftësitë strategjike në betejat në Krakov, Minsk dhe Kurska, ndërsa u vra me 23 mars 1945



SKANDALET SEKSUALE. Papa fajëson djallin, kërkon ndihmën e engjëjve

"Djalli është i gjallë e mirë, dhe punon jashtë orarit për të minuar Kishën Katolike Romake", tha Papa Françesku, shkruan Reuters. Në fakt, Papa është i bindur se Satanai duhet të fajësohet për skandalet e abuzimeve seksuale dhe përçarjet e thella në Kisha. Dhe i ka kërkuar besimtarëve katolikëve anembanë botës të thonë një lutje të veçantë çdo ditë në tetor, në përpjekje për ta mundur atë.

"Kisha duhet të shpëtohet nga sulmet e një keqdashësi, akuzuesi i madh, dhe në të njëjtën kohë duhet të bëhet gjithnjë e më e vetëdijshme për fajin, gabimet dhe abuzimet e bëra në të tashmen dhe të kaluarën", tha Para fraçesku në një mesazh më 29 shtator. Që kur u zgjodh në vitin 2013, Papa ka bërë të qartë se beson se djalli është real. Në një dokument në prill për shenjtërinë në botën moderne, Françesku përmendi djallin dhjetëra herë.

"Ne nuk duhet të mendojmë që djalli është një mit, një përfaqësim, një simbol apo një ide. Ky gabim do të na ulë rolin tonë, do të bënte me të pakujdesshëm", shkroi ai në dokument. Kisha është goditur kohët e fundit nga skandale të njëpasnjëshme të abuzimeve seksual, në Gjermania, Shtetet e Bashkuara e në Kili. Në të njëjtën kohë, një polarizim më i thellë mes konservatorëve dhe liberalëve në Kishë ka shpërthyer në mediat sociale. Papa përdori fjalën "akuzuesi i madh" për të përshkruar Satanin. Ai është kaq i bindur se Satani duhet të fajësohet për skandalet e abuzimit seksual dhe për ndarjet brenda Kishës, saqë ka marrë ndihmën e armës së madhe shpirtërore, Shën Michael Archangel. Michael përmendet disa herë në Bibël si udhëheqësi i engjëjve që larguan Luciferin, nga parajsa.

TURQI-SIRI. JETA PËRGJATË MURIT NDAN DY BOTË

M shumë se 3.5 milionë refugjatë sirianë jetojnë në Turqi. Ndërkohë të afërm të tyre ende përballen me luftën në anën tjetër të kufirit turko-sirian të izoluar prej tre vjetësh nga një mur 800 km. i gjatë dhe i vrojtuar mirë

Jeta e 3.5 milionë refugjatëve sirianë në Turqi has në vështirësi të shumta, por ata gëzojnë që janë të sigurt. Ndërkohë të afërm të tyre ende përballen me luftën në anën tjetër të kufirit turko-sirian të izoluar prej tre vjetësh nga një mur 800 km. i gjatë dhe i vrojtuar mirë.

Rreth 800 km është muri prej betoni, që ka ndërtuar Turqia para tre vjetësh përgjatë kufirit me Sirinë, për të ndaluar "terroristët dhe kontradandistët", sikurse thuhet. Refugjatë të rinj nuk lejohen më të hyjnë në vend. Ndaj shumë familje siriane jetojnë të ndarë, përgjatë murit. Ata nuk kanë më shpresë se së shpejti mund të bashkohen dhe se do të mund t'i shpëtojnë të afërmit e tyre prej luftës në Siri.

Më shumë se 3.5 milionë refugjatë jetojnë ndërkohë në Turqi. Në anën siriane të kufirit njerëzit vazhdojnë të jetojnë me frikë. Provinca veriore e Sirisë Idlib konsiderohet si fortifikata e fundit e rebelëve - më shumë se tre milionë njerëz jetojnë ndërkohë atje, gjysma janë të dëbuar nga vende të tjera të Sirisë.

NDARJA E FAMILJEVE

Shumë refugjatë kanë ende të afërmit e tyre në anën tjetër të kufriit, ku vazhdon të gjëmojë lufta. Njëri prej tyre është Abdulmajid, që e sheh të motrën Fatima vetëm në videot nga celulari. Të shumtën e herëve ajo nuk ka lajme të mira. Tek i thotë, se sërish kanë rënë predha në shtëpinë e tyre, por falë Zotit ata kanë shpëtuar nga më e keqja. Fatima është në një fshat pranë Idlibit - Abdulmajid është në qytezën Reyhanli, në Turqi. Para gjashtë vjetësh ai u arratis dhe shkoi në Turqi, ndërsa e motra mbeti në Idlib, rrëfen Abdulmajid Al Halabi: "Shtëpia e saj u shkatërrua gjatë një sulmi dhe ajo bashkë me fëmijët u arratis në fshatin e prindërve tanë. Por më vonë edhe atje nisën bombardimet. Fatima as që nuk e besonte se lufta do të zgjasë kaq shumë".

Me shumë refugjatë të tjerë Abdulmajid na tregon, se si jeton në Turqi: Në një kamp gjysmë-ilegal me çadra, në një mjedis të ngushtë bashkë me gruan Dohok dhe me pesë fëmijët. "Ne jetojmë këtu, sepse kjo është mundësia jonë e vetme. Por duhet ta shihni një herë se si është këtu në dimër. Toka është plot baltë jashtë dhe është shumë ftohtë. Është vërtetë një jetë e vështirë.

Sado të vështira që janë rrethanat, familja Abdulmajids është këtu të paktën në siguri. Para tre vjetësh Turqia i mbylli kufijtë me Sirinë dhe filloi të ndërtojë një mur: tre metra të lartë dhe të mbikëqyrur rreptësishtë. Muri është 800 km i gjatë - dhe do të zgjatet edhe më shumë. Pasojat e këtij vendimi janë të prekshme: Majtas ana turke e kufirit pa këmbë njeriu - djathtas ana siriane mbushur me kampe të dëbuarish aq sa të kap syri në horizont. Organizatat e ndihmës kujdesen për njerëzit atje. Ndihmësit e Gjysmë Hënës së Kuqe turke dërgojnë rregullisht furnizime për në Idlib.

NDIKIMI I ARDHJES SË REFUGJATËVE NË JETËN E TURQVE

Të paktën katër deri në pesë herë në javë e bëjnë ata turin e furnizimeve drejt anës tjetër të kufirit. Në qytetin kufitar turk Reyhanli njerëzit janë krenarë, që vendi i tyre prej vitesh jep kaq shumë ndihma. Asnjë vend tjetër në botë nuk ka pranuar kaq shumë refugjatë. Por ka edhe shumë që thonë tani mjaft më. Kriza monetare ka shtrenjtuar gjithçka, njerëzit kanë problemet e veta.

- "Ne kemi pranuar kaq shumë sirianë. Më shumë nuk bëhet më, ne nuk e duam këtë".

- "Edhe sikur të na duhej të arratiseshim ne do ta bënim këtë. Unë mendoj se ata duhet të vijnë".

- "Ata po na marrin vendet e punës. Dikur ne fitonim 80 Lira në ditë. Tani sirianët po i bëjnë punët tona për gjysmën e rrogës sonë". Abdulmajid dhe familja e tij natyrisht që e ndjejnë skepticizmin dhe refuzimin kundrejt tyre. Megjithatë ata janë mirënjohës. Presidentin turk këtu në çadrat e kampit e konsiderojnë si hero - aq më tepër pasi ai ia doli që të parandalojë tani për tani ofensivën ushtarake në Idlib. Presidenti turk Erdogan dhe ai i Rusisë Putin së fundi ranë dakord për një zonë të çmilitarizuar për Idlibin, një ofensivë në shkallë të gjerë siriano-ruse mundi kësisoj të parandalohet, e po ashtu edhe katastrofa e mundshme humanitare dhe një valë e re refugjatësh drejt Turqisë. Të gjithë xhihadistët duhet të tërhiqen dhe të dorëzojnë armët, por është e paqartë, nëse kjo vërtetë do të funksionojë. *(DW)*

TURQI, ARRESTOHEN 90 TERRORISTË TË DYSHUAR

Të paktën 90 pjesëtarë të dyshuar të organizatës terroriste PKK/KCK janë arrestuar në një operacion të madh policor i cili u zhvillua mbrëmë në Turqi. Ministria e Brendshme turke bëri të ditur se operacioni anti-terrorist është kryer në mënyrë të sinkronizuar në tetë provinca turke. Në rajonin e Diyarbakirit, policia thotë se ka arrestuar 80 persona të dyshuar për anëtarë të organizatës terroriste PKK. Dhjetë të dyshuarit tjerë janë arrestuar në Stambolli, Mersin, Van, Sirnak Sanliurfa, Batman dhe Mardin. Gjatë operacionit u konfiskuan sasi të mëdha të dokumenteve dhe materialeve digjitale, të cilat do të përdoren gjatë procesuimit të të dyshuarve.

NATO MBËSHTET DIALOGUN PRISHTINË-BEOGRAD

"NATO mbështet plotësisht procesin e normalizimit të raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është platforma e vetme për të gjetur zgjidhje që respekton të drejtat e gjitha komuniteteve. Dialogu është çelës i stabilitetit për rajonin", tha Stoltenberg

NATO mbështet plotësisht normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes procesit të dialogut, ka deklaruar sot në Beograd, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Veriatlantike, Jens Stoltenberg. Këto komente, ai i bëri pas takimit që zhvilloi me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Me këtë rast, Stoltenberg tha se dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është platforma e vetme për të gjetur zgjidhje që respekton të drejtat e gjitha palëve.

"Misioni ynë i KFOR-it mban një ambient të qetë dhe sigurt në Kosovë. Kjo nënkupton ofrimin e sigurisë për gjitha komunitetet, përfshirë serbët. NATO mbështet plotësisht procesin e normalizimit të raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është platforma e vetme për të gjetur zgjidhje që respekton të drejtat e gjitha komuniteteve. Dialogu është çelës i stabilitetit për rajonin", tha Stoltenberg. Ndërkaq, presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq tha se do të bëjë më të mirën për të vazhduar dialogun me Prishtinën dhe për të kultivuar marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet e rajonit.

"Ne do të bëjmë më të mirën për të vazhduar dialogun me Prishtinën. Ne do të bëjmë më të mirën për të vendosur raporte të mira me udhëheqjen e re të Bosnjë Hercegovinës, dhe nuk ka asnjë dyshim se duhet të kemi raporte më të mira me Kroacinë. Këto janë disa çështje në të cilat ne mund të kontribuojmë. Ne do të bëjmë më të mirën të mos shkaktojmë kokëçarja për fuqitë e mëdha, por së pari dhe me kryesore të mos shkaktojnë asnjë lloj kokëçarje për popullin tonë", theksoi Vuçiq. Vuçiq dhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, morën pjesë në hapjen e ushtrimeve të përbashkëta për emergjenca civile në Mlladenovac, 50 kilometra në afërsi të Beogradit.

Ushtrimi me emrin "Serbia 2018" organizohet bashkërisht nga NATO, Qendra Evropiane për koordinimin e aktiviteteve në ofrimin e përgjigjeve ndaj emergjencave dhe Ministria e Brendshme e Serbisë. Stoltenberg ka thënë se ushtrimi "Serbia 2018" nuk është ushtarak, por civil, si një mundësi për testimin e teknologjisë së re. "Ushtrimi është në shërbim të NATO-s, Serbisë dhe rajonit. Ajo që mësojmë këtu na ndihmon të jemi më të përgatitur", u shpreh Stoltenberg.

Në ushtrimin civil marrin pjesë 2000 pjesëmarrës nga 38 vende. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me Serbinë, megjithëse theksoi faktin se e kupton që NATO është çështje kundërthënëse në Serbi. Në anën tjetër, presidenti serb Vuçiq potencoi se Serbia "duhet të bashkëpunojë me NATO-n pavarësish së kaluarës".

"Shumë kush ka pyetur 'çfarë ju duhet NATO?'. Serbia është neutrale në aspektin ushtarak, por ka dhe do të ketë bashkëpunim të mirë me NATO-n. Do të ketë raporte të mira, sikurse me Rusinë dhe vendet tjera", potencoi presidenti serb, Vuçiq. *(REL)*

Rama refuzon ofertën serbe për blerjen e Telekomit

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se nuk është në preferencën e Qeverisë Shqiptare investimi në Telekom Albania nga ana e Kompanisë serbe të Telekomit. "Qëndrimi i Qeverisë shqiptare është shumë i thjeshtë dhe i qartë: bizneset serbe janë të mirëpritura në Republikën e Shqipërisë, por në këtë sektor strategjik nuk është preferenca jonë", ka thënë Rama në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë, shkruan REL. Telekomi i Serbisë kishte shfaqur interesimin për blerjen e Telekom Albania, të cilën e ka nxjerrë në shitje Deutche Telekom. Kryeministri Rama tha se Qeveria Shqiptare nuk është pjesë e transaksionit që do të kryejë një kompani private si "Deutche Telekom", e cila, sipas tij, ka një strategji që të tërhiqet nga tregjet e vogla. Lidhur me këtë çështje ka folur edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka thënë se do të bisedojë për këtë çështje me kryeministrin shqiptar Rama gjatë ditës së sotme.

KORRIGJIMI I KUFIJVE NË RAPORTIN E PE-së PËR SERBINË

Komiteti i Politikës së Jashtme i Parlamentit Evropian sot do të duhej të miratonte tekstin e raportit mbi Serbinë i cili përfshin një amendament për korrigjimin e mundshëm të kufijve mes Kosovës e Serbisë.

"Çdo marrëveshje mund të jetë e pranueshme vetëm nëse është dakord reciprokisht dhe në përputhje me stabilitetin e përgjithshëm të rajonit dhe të së drejtës ndërkombëtare", thuhet në tekstin e amendamentit të rënë dakord, raporton agjencia serbe e lajmeve "Tanjug".

Në total prej 239 amendamente në raportin e këtij viti për Serbinë të raportuesit të Parlamentit Evropian David McAllister janë zvogëluar në 27 amendamente kompromisi që do të duhej të futeshin në tekstin përfundimtar të raportit për Serbinë.



Për to do të votohet sot në takimin e Komitetit të Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian në Bruksel, transmeton Koha.net. Vëmendjen e veçantë të deputetit e ka amendamenti i kompromisit me numrin 25, lidhur me debatin për korrigjimin e mundshëm të kufijve mes Kosovës e Serbisë, përfshirë edhe "shkëmbimin e territoreve".

Në fillim të tekstit, që do të duhej të përfshihej në versionin përfundimtar të raportit të Parlamentit Evropian për Serbinë, por edhe për Kosovën, theksohet "natyra multietnike e Kosovës dhe e Serbisë" si fakt që "shtetet etnikisht homogjene nuk do të duhej të ishin objektiv në rajon". "Mbështetet dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja si mundësi për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes Serbisë dhe Kosovës. Konsiderohet se çdo marrëveshje mund të jetë e pranueshme nëse të dy palët pajtohen reciprokisht, merret parasysh stabiliteti i përgjithshëm rajonal dhe e drejta ndërkombëtare", theksohet në tekstin e amendamentit të kompromisit i cili përfshin 10 përfaqësues të PE-së. Pas miratimit në Komitetin për Politikë të Jashtme të raportit për Serbinë, deri në fund të muajit nëntor do të duhej të miratohej nga të gjithë deputetët e Parlamentit Evropian në Bruksel.

Punonjësit që përpiqen të frenojnë instinktet më të këqija të presidentit Trump, pranojnë atë që ndiejnë shumë nga ne. Ata, ashtu si ne, nuk kanë nevojë që të shohin dështime të tjera për të arritur në përfundimin se në Zyrën Ovale është një person që nuk ka as karakterin, as intelektin dhe as moralin e përshtatshëm për atë detyrë

PRESIDENTI ME REKORDIN MË TË MADH TË SKANDALEVE

Presidenti Donald Trump duket ka vendosur që vetëm në pak vite si president i SHBA-së, të përsërisë të gjitha skandalet që ka pasur Uashingtoni në 50 vitet e fundit, që nga Uotergejt, seancat dëgjimore të Clarence Thomas me Anita Hill, dhe deri te dështimi me uraganin Katrina.

Rasti në fjalë: pas një vetëpërmbajtjeje të pazakontë, kur Christine Blasey Ford tha se ishte ngacmuar seksualisht nga Brett Kavanaugh, (gjë që ai e mohon), kur Kavanaugh ishte adoleshent 17-vjeçar, Trump dha maksimumin e përpjekjeve për t'i dalë zot debatit. Ai shkroi në Twitter: "S'kam asnjë dyshim që nëse sulmi ndaj doktoreshës Ford do të kishte qenë aq i ashpër sa ç'thotë ajo, do të ishte ngritur menjëherë një padi nga ajo apo nga të afërmit. Unë i kërkoj t'i bëjë publike ato padi, që të mësojmë datën dhe vendin se ku janë bërë".

Krahasimet me krizën e gjykatësit Clarence Thomas, nga administrata e George H. W. Bush, janë të pashmangshme. Edhe pse Bush nuk u soll si Trump. Trump nuk kishte si ta dinte për akuzat e Blasey Ford kundër Kavanaugh, kur e emëroi si kandidat për anëtar të Gjykatës së Lartë. Por mënyra se si presidenti e menaxhoi çështjen, e bën që të dalë shumë më keq. Ai e ka fyer, duke e quajtur "ajo gruaja" në vend që t'i kërkonte FBI-së të bënte hetime, siç bëri Bush me Thomas. Dhe ka thënë se hetimet e thella "nuk janë punë për FBI-në". Kjo nuk është e vërtetë, shkruan CNN. Sigurisht, çdo skandal është unik, ndaj nuk mund të bëhen krahasime të sakta me presidentët e mëparshëm. Por jehona që bën është e pamundur të shpërfillet.

Përgjigjja e Trumpit ndaj situatës së Kavanaugh mund të mos jetë aq e keqe sa reagimi që bëri ndaj studimit që arrinte në përfundimin se në Porto Riko kishin vdekur 3000 veta për shkak të uraganit Maria. Presidenti tha se studimi ishte i rremë dhe që ishte zhvilluar si sulm politik. Por Porto Rikoja i ka pranuar shifrat. Uragani Maria është krahasuar me përgjigjen e ngadaltë të presidentit Bush në Nju Orleans, pas uraganit Katrina. Ankesat e Trump konfirmuan se dështimi me uraganin ishte provë e paaftësisë së tij.

Sigurisht, janë edhe hetimet për Rusinë, kur gjykimi i Paul Manafort dhe Michael Flynn kujtuan skandalin e Uotergejt, që solli rrëzimin e presidentit Nikson. Të emëruarit e Trump janë përpirë nga batakë edhe më të cekët. Mes tyre janë ish administratori i Agjencisë së Mjedisit, Scott Pruit, që dha dorëheqjen për skandale etike; ish Sekretari i Shëndetësisë dhe Burimeve Njerëzore, Tom Price, i cili dha dorëheqjen pasi kishte përdorur avionë privatë më para taksapaguesish; dhe Rob Porter, një sekretar i Shtëpisë së Bardhë, që dha dorëheqjen pasi dolën akuza për dhunë në familje. Porter i ka mohuar akuzat. Vetëm një zyrtar i administratës është hequr nga detyra, ish këshilltari për sigurinë kombëtare, Flynn, për shkak të hetimeve për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e vitit 2016. Trump ka nisur vrullin për t'ia kaluar presidentëve të dekadave të tëra. Duhet të kthehesh 40 vite pas në kohë, te Niksoni e Uotergejti, që të gjesh kaq shumë prova për skandale të lidhura me fushatën.

Këshilltari i fushatës së presidentit Trump për çështjet me jashtë, George Papadopoulos, ka pranuar se ka gënjyer agjentët e FBI-së për skandalin e Rusisë. Përveç Manafort, drejtuesit të fushatës, edhe këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, mori ulje dënimi nga Rick Gates pasi pranoi fajin. Ai kishe shërbyer në fushatën e presidentit Trump si dhe gjatë tranzicionit. Michael Cohen, i cili mburrej se ishte "ndërmjetësi" i presidentit, pranoi fajin se kishte paguaj Stormy Daniels që të heshtte. Daniels është një aktore pornografike që thotë se ka kryer marrëdhënie jashtë-martesore me Trump. Trump i ka mohuar akuzat. Daniels e ka paditur tashmë presidentin Trump ndërkohë që avokati i saj, Michael Avenatti, po kërkon që presidenti të paraqitet për të dëshmuar nën betim. Avenatti ka bërë të njëjtën kërkesë edhe për një kliente tjetër, Summer Zervos, e cila është një nga gratë e shumta që kanë deklaruar se janë ngacmuar seksualisht nga presidenti Trump. Presidenti i ka mohuar akuzat e grave, edhe të Zervosit. Padia për shpifje e ka vënë presidentin Trump në pozitë të tillë që duhet t'u përgjigjet pyetjeve të shkruara. Rreziku që i kanoset Trumpit me çështjet e Daniels dhe Zervos duket i ngjashëm me padinë civile të Paula Jones, që shënoi kthesën e madhe për skandalin që përfshiu Klintonët në vitet 1990. Gënjeshtrat e çuan Klintonin drejt gjyqit për shkarkim. (Nën betim, gjatë një deklarate, Klinton tha se nuk kishte kryer marrëdhënie seksuale me Monika Levinskin.) Ai shpëtoi dhe nuk u hoq nga detyra, pas një gjyqi në senatin amerikan.

Shumica e problemeve të Trump, përfshi debatet për Kavanaugh, kanë precedentë historikë të viteve të fundit, por sasia e krizave që ka kjo administratë është i paprecedentë. Rekordi i Trumpit bie më shumë në sy edhe sepse vjen pas Barak Obamës, i cili pati vetëm një anëtar kabineti që përfundoi me dorëheqje, ish-drejtorin e CIA-s, David Petraeus, i cili e la detyrën pasi hetimet e FBI-së vërtetuan se për tetë vite kishte pasur lidhje me biografen. Madje, u quajt Obama-Pa-Drama. Kjo bën që Trump të duket një makineri kaosi.

Burime të brendshme nga Shtëpia e Bardhë thonë se anëtarët e stafit kanë qenë aq të skandalizuar nga Trump, sa autori anonim, që shkroi artikullin më të fundit në New York Times, tha se "shumë persona të emëruar nga Trump janë betuar të ruajnë institucionet demokratike me çdo kusht, duke frenuar vazhdimisht impulset e gabuara të Trumpit, derisa të largohet nga zyra". Në fakt, personi që thotë se di se si të punësojë njerëzit më të mirë, ka qenë president i një ekipi me trazira të vazhdueshme.

Punonjësit që përpiqen të frenojnë instinktet më të këqija të presidentit Trump, pranojnë atë që ndiejnë shumë nga ne. Ata, ashtu si ne, nuk kanë nevojë që të shohin dështime të tjera për të arritur në përfundimin se në Zyrën Ovale është një person që nuk ka as karakterin, as intelektin dhe as moralin e përshtatshëm për atë detyrë.

ALBRIGHT: TRUMP ËSHTË DHURATË E LLOJIT TË VET PËR PUTININ



Ish-Sekretarja amerikane e Shtetit, Medeleine Albright ka kritikuar deklaratat dhe politikat e presidentit amerikan Donald Trump në lidhje me Aleancën e Atlantikut Verior (NATO) dhe Bashkimit Evropian (BE). Albright për televizionin CNN tha se konsideron që Trump ndihet i ngjashëm me Presidentin rus Vladimir Putin. Në paraqitjen e saj të parë pas një periudhe të gjatë, Albright paralajmëroi se Rusia angazhohet shumë për të minuar demokracinë amerikane dhe për të larguar Washingtonin nga aleatët e saj. "Unë konsideroj se Trump për shumëçka është një dhuratë e llojit të vet për Putinin kur bëhet fjalë për qasjen e tij ndaj NATO-s dhe Evropës", tha Albright. Ish Sekretarja në mandatin e ish presidentit amerikan Clinton, Albright tha se mekanizmi i vendimmarrjes në SHBA aktualisht nuk funksionon. Presidenti aktual i SHBA-së, Trump është në shënjestër të kritikave në rritje në SHBA për marrëdhënie të moderuara me Putinin dhe Rusinë dhe kritik ndaj NATO-s dhe Evropës si aleatë tradicionalë amerikanë.

DEMOKRACIA NË RREZIK NË VENDET E INDUSTRIALIZUARA

Përkeqësim i standardeve demokratike dhe të shtetit ligjor në shumë vende të industrializuara. Një studim i Fondacionit Bertelsmann krahason 41 vende të industrializuara të OECD-së dhe Bashkimit Europian dhe arrin në përfundimin se ka "një tendencë në rënie të cilësisë së demokracisë". Gjermania në këtë renditje zë vendin e pestë. Kryesuese është Suedia, e ndjekur nga Finlanda, Norvegjia, Danimarka. Vendin e gjashtë e zë Zvicra.

Në bazë të studimit 26 vende kanë shenja të qarta të përkeqësimit të strukturave demokratike dhe ligjore. Veçanërisht këto zhvillime negative vihen re në Hungari, Poloni, Meksikë dhe Turqi. Por edhe një vend si SHBA, ku vlerat e demokracisë dhe lirisë janë "pjesë e pathyeshme e botëkuptimit të vendit" jep shenja përkeqësimi. Një president, që i cilëson mediat si "armike" dhe që nuk e njeh funksionin kontrollues të tyre "turpëron dhe është një rrezik për demokracinë dhe lirinë."

Me shqetësim vihet re, se megjithë rënien e cilësisë së demokracisë dhe qeverisjes, nuk bie automatikisht besimi i elektoratit në lidershipin politik. Kështu në Poloni, Hungari dhe Turqi vihet re një rritje e besimit në qeverisje. "Ky zhvillim bën të qartë, se në disa vende vlerat bazë demokratike nuk janë të rrënjosura plotësisht", bën të ditur Daniel Schraad-Tischler, një nga bashkautorët e studimit.

Por edhe në Gjermani dhe vendet skandinave është rritur polarizimi partiako-politik duke vështirësuar reformat. Në Gjermani ka një polarizim të theksuar mes "së majtës" dhe "të djathtës", veçanërisht me forcimin e partisë populiste, AfD. Ajo që vihet re në disa vende është një "fushatë zgjedhore e pandërprerë", thotë studiuesi Schraad-Tischler. Qeveritë nuk ia dalin dot të komunikojnë planet e tyre si duhet dhe të arrijnë ujditë e nevojshme. Ky problem vihet re edhe në Gjermani.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 202/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për evidencë amë, Sektori për menaxhim me burime njerëzore — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Arsim
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për evidentim të të punësuarve, Njësia për evidencë amë, Sektori për menaxhim me burime njerëzore — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat e organizimit dhe udhëheqje, arsim, shkencat ekonomike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 20.987,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 19, nenit 20 dhe nenit 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme 07-9992/3 të 05.06.2014, të sjellë nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës së RM, Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursionet të SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për grumbullimin e ofertave për ekskursione të nxënësve

SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip, rr. Vasil Gllavinov nr. 4, tel. 032/391-459 sstojmenski@yahoo.com

Në bazë të Programit vjetor për ekskursionet shkollore të SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip të miratuar nga Këshilli i prindërve dhe Byroja për zhvillim të arsimit, organizohen ekskursione të llojeve në vijim:

1. Ekskursione në lidhje me temat dhe përmbajtjet e programeve mësimore (me kohëzgjatje prej një dite);
- Vizitë të Muzeut të artit bashkëkohor në Shkup. Udhëtim me autobus Shtip-Shkup-Shtip, mjek gjatë kohës së udhëtimit, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë.

2. Ekskursion profesional – hulumtues
- Ohër - Shtip - Prilep - Krushevë - Ohër - Shn.Naum - Manastir - Shtip në periudhë pre **02.05-03.05.2019** (me kohëzgjatje prej dy ditëve, në bazë 1 pansion të plotë (mëngjes, drekë, darkë në hotel me 3*), guid të licencuar turistik, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit

3. Ekskursion përfundimtar
Në Kranjska Gora - Slloveni, Milano-Itali dhe Beograd-Serbi me kohëzgjatje prej 6 ditë dhe 3 bujtje në bazë gjysmë pansion në hotel me 3* , 1-GJP në hotel me me 3* në Kranjska Gora dhe 2-GJP në hotel me me 3* në Milano periudha prej **15.04 – 20.04.2019**, transport me autobusë të kualitetit të lartë turistik sipas programit, taksa hotelerie, bileta për vizitat e cekura, vizitë e Bled, Bohinj, Pllanica, Sava Dolinska, Shikim të Milano me guid, vizitë të **Galleria Vittorio Emanuele,** Kështjella Sforcesko, rruga këmbësorike Dante, Sheshi Duomo dhe Katedralja Duomo, Skala milaneze, shtëpiae qytetit Milano vizitë në Llugano, Komo, lundrim me anije, të liqenit Llago Di Komo, shikim të Bled, Pllanica, Ljubljanë, Millano, Llugano, Komo me guidë lokal, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek, shoqërues të licencuar. Të gjitha shërbimet e kërkuara për ekskursionin përfundimtar duhet të përfshihen në çmim.

4. Ekskursion sportiv-rekreativ – dimëror
Në Krushevë – Maqedoni, me kohëzgjatje prej 7 ditë në bazë 6 pansione të plota (mëngjes, drekë, darkë) akomodim në hotel me 3*, udhëtim me autobus Shtip-Krushevë-Shtip, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit, guid të licencuar turistik.

5. Ekskursion sportiv-rekreativ – veror
Në Ohër – Maqedoni, me kohëzgjatje prej 10 ditë në bazë 9 pansione të plota (mëngjes, drekë, darkë) akomodim në hotel me 3*, udhëtim me autobus Shtip-Ohër-Shtip, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit, guid të licencuar.

Kushtet minimale të cilat duhet të plotësojë ofertuesi janë:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike (dëshmi – DRD formular)
- Të ketë të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione shkollore dhe aktivitete të tjera të lira në 3 vitet e fundit (dëshmi – vërtetim nga shkollat për ekskursione të realizuara dhe aktivitet tjera të lira)
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat i transportojnë grupet e fëmijëve (dëshmi-licencë)

Furnizimi NUK është i ndashëm (llogaritet çmimi i përgjithshëm i ofertuesit).

Kriter për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursionit dhe çmimit më të ulët.
- çmim të përgjithshëm të shërbimit (akomodim, transport dhe ushqim) – për secilin ekskursion
- kushtet për akomodim, meny për ushqim, transport, plus taksa turistike, bileta për ekskursionin përfundimtar;
- në çmim futet edhe sigurimi rrugor dhe shëndetësor i nxënësve pa franshizë, guidat lokal, transferimet në autobusë dhe biletat;
- mënyra e pagesës dhe numri i kësteve;
- guidë, numër të mësimdhënësve dhe mjek
- kushtet e volitshme të nxënësve të cilët vijnë nga familjet e prekura sociale
- vlerë të garancisë bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes në shumë prej 15% (e dorëzon ofertuesi i zgjedhur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes).

Ofertat të dorëzohen në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës duke përfshirë edhe ditën e publikimit në shtypin ditor, deri tek Komisioni për grumbullim të ofertave për ekskursione, në arkivin e shkollës ose në adresën e SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip rr. Vasil Gllavinov nr. 4 Shtip

SHMK Gjimnazi Sllavço Stojmenski Shtip
Komisioni për grumbullimin e ekskursioneve

L A J M Ë R I M
Për organizimin e prezentimit publik dhe anketës publike

për Projektin Arkitektoniko-urbanistik për Pompën e benzinës me objekte përcjellëse në PK.nr.: 03855, 3856 dhe 3867 KK Vaksnincë me destinim E2-suprastruktura komunale, Komuna e Likovës, me sipërfaqe prej 4571.70 M^2 sipas dokumentacionit teknik nr.05-02/2018 të punuar në korrik 2018 nga ana e ÇIP Group SHDKNJP - Shkup.

Kufijtë e përfshirjes janë: përfshirje planore

Përfshirja është sipërfaqe prej 4571,70 M^2.

Anketa publike dhe prezantimi publik për propozim **Projekti Arkitektoniko-urbanistik për Pompën e benzinës me objekte përcjellëse në PK.nr.: 03855, 3856 dhe 3867 KK Vaksnincë me destinim E2-suprastruktura komunale, Komuna e Likovës.**

Anketa Publike do të zgjatë 7 ditë pune nga dita e shpalljes të Lajmërimit, respektivisht prej 12.10-20.10.2018, çdo ditë pune nga ora 9,00 deri 15,00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezantimi publik me prezantimin profesional të planit do të mbahet më dt. 18.07.2018 në ora 10,00 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi: Dije Arifi

Komuna e Likovës
Kryetar: m-r Erkan Arifi

Në bazë të nenit 130 Nga Ligji për arsim fillor dhe në bazë të nenit 17 nga rregullorja për mënyrën e realizmit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, më propozim të Këshillit të prindërve , SHFK "Rajko Zhinzifov" Shkup, shpall

SHPALLJE
Për grumbullimin e ofertave për:
realizimin e ekskursioneve

I Ekskursione
- piknikë njëditore për nxënësit (vjeshtore dhe pranverore)
- ekskursion njëditorë me nxënësit e klasës së tretë;
- mësim pesëditorë në natyrë për nxënësit e klasës së pestë;
- ekskursion dyditorë me nxënësit e klasës së gjashtë ;
- ekskursion treditorë me nxënësit e klasës së nëntë.

Oferta mund të ndahet. Të drejtë të dorëzojë ofertë ka çdo person juridik dhe fizik i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë për të cilën dorëzojnë ofertë në pajtim me kriteret e cekura në kërkesën për dorëzim të ofertave. Oferta duhet ti plotësojnë kushtet e shkruara në dokumentacionin tenderues.

Thirren të gjithë ofertuesit e interesuar të dorëzojnë oferta në pajtim me dokumentacionin i cili mund të merret në hapësirat çdo ditë pune prej orës 9 deri në ora 14. Afati për dorëzimin e ofertave është 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Për informata shtesë, drejtohuni në SHFK "Rajko Zhinzifov" - lagj. Draçevë, apo në tel.:02 791 883.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të vetë shpalljes apo më së voni deri më datën 17.10.2018 deri në ora 12:00

SHFK "Rajko Zhinzifov", Kisella Vodë, Shkup

HENNESSEY SYNON TË ARRIJË VOZITJE DERI 500 KM NË ORË

Prodhuesi amerikan i veturave supersportive pohon se modeli i tij i ardhshëm Venom F5 ka fuqi të mjaftueshme për të thyer kufirin psikologjik kur bëhet fjala për shpejtësinë. Hennessey me vite ka bërë kampanja mediale për modelin e ardhshëm sportiv, i cili sipas drejtuesve të kompanisë, do të arrijë në teori shpejtësinë deri në 500 kilometra në orë.

Edhe pse versioni prodhues i modelit Venom F5 ende nuk është kryer, kah fundi i gushti, në Monterej të Kalifornisë u prezantua agregati monstruoz i këtij automobile. Është një motor 7.6-litërsh binjak turbo V8 i projektuar për të ofruar mbi 1.622 kuaj fuqi, e cila duhet të jetë e mjaftueshme për të përshpejtuar Venom F5 0-300 km/h në më pak se 10 sekonda dhe të arrijë shpejtësinë maksimale 482 km/h.

John Hennessy, drejtor i kompanisë, tha se motori aktual që po teston është rreth 1.540 kuaj fuqi për të qenë në gjendje të japë energji të mjaftueshme për të arritur limitin prej 482 km/h. Dëshiroj të shoh që Venom F5 të arrijë 500 kilometra në orë", tha ai. Gjithashtu, për të arritur një shpejtësi prej 500 km/h, është e nevojshme një shteg adekuat me një drejtim të gjatë dhe të mjaftueshëm për të përshpejtuar dhe për t'u ndalur në mënyrë të sigurt. Një nga opsionet spekulative është se kompania do t'u kërkojë autoriteteve të mbyllin përkohësisht disa nga pjesët e drejtpërdrejta dhe të drejta të autostradës në Nevada ose në Teksas për qëllime testimi. Nëse prodhuesi amerikan do të ketë sukses në qëllimin e tij, do ta dihet vitin e ardhshëm, kur planifikohet testimi i parë i Venom F5.

Ringjallet Opeli

Prodhuesi gjerman ka arritur muajin e kaluar pjesën më të madhe të tregut në Gjermani që nga dhjetori 2010. Gjatë muajit shtator, Opel kishte një pjesë të tregut prej 10.2 për qind në makinat e pasagjerëve, që ishte shtatori më i mirë që nga viti 2006. Nga Raselheim thonë se kanë përfituar nga përgatitja në kohë dhe konstante për kalimin në një sistem të ri WLTP për testimin e gazrave dhe konsumit, i cili filloi të zbatohet nga 1 shtatori. Opel aktualisht ofron 127 modele të makinave për udhëtarë, të cilat përmbushin standardet e reja strikte Euro 6d-Temp. Shitja e Opel ka shënuar rritje dhe në vendet tjera evropiane, ashtu që prodhuesi gjerman ka arritur pothuajse gjashtë për qind të tregut në Spanjë dhe 4,3% të Francës, që është rezultati më i mirë i kompanisë që nga maji 2015. Në Opel asnjëherë deri më tash nuk kanë përmendur ndikimin e kalimit nën pronësinë e grupit francez PSA në rritjen e këtyre rezultateve.

Apple nis një program riparimi falas për iPhone 8

Apple njoftoi nisjen e një programi falas riparimi për iPhone 8, duke zbuluar se një "përqindje shumë e vogël" e njësive kanë nevojë të zëvendësojnë bordet logjike për shkak të defektit të prodhimit. Apple thotë se bordet me defekt mund të kenë shkaktuar rinisje të rastësishme dhe ngrirje të ekranit që pengojnë iPhone 8 që të aktivizohet siç duhet.

Dëmtimi nuk ndikon në iPhone X ose iPhone 8 Plus dhe Apple thotë se njësitë e prekura përfshijnë vetëm ato të shitura midis Shtatorit 2017 dhe Marsit 2018 në Australi, Kinë, Hong Kong, Indi, Japoni, Macau, Zelandën e Re dhe SHBA.

Ju mund të jepni numrin serial të iPhone-it tuaj në faqen e riparimit të Apple për të parë nëse ju keni një njësi të rregullt ose jo. Programi mbulon njësitë e iPhone 8 të shitura deri në tre vjet pas shitjes së parë me pakicë të pajisjes në Shtator 2017.

Personat e prekur kanë tri opsione: kalojnë përmes një specialisti të palës së tretë të autorizuar nga Apple; duke kontaktuar Mbështetjen e Apple për të bërë një riparim me postë; ose të shkoni në një dyqan Apple për të hequr pajisjen. Apple rekomandon mbështetjen e iPhone 8 me iCloud ose iTunes para se të bëhet riparimi dhe kompania gjithashtu rekomandon ndreqjen e ndonjë problemi harduer, si një ekran i thyer ose i plasaritur, para se të zëvendësohet bordi i logjikës.

Shkencëtarët e NASA-s: Toka po dridhet gjithnjë e më shumë

Hulumtimet e reja kanë treguar se Toka është duke u dridhur gjithnjë e më shumë kur sillet rreth boshtit të saj dhe shkencëtarët mendojnë se njerëzit janë të paktën pjesërisht fajtorë, raporton mediat e huaja.

Dridhja e aksit të rotacionit të Tokës në krahasim me koren e planetit është rritur me më shumë se 10 metra vetëm gjatë shekullit të kaluar. Ekspertët besojnë se shpërndarja e akullit polar, i përshpejtuar nga djegia e lëndëve djegëse fosile, luan një rol të rëndësishëm në nxjerrjen e Tokës nga ekuilibri. Shkencëtarët e NASA-s në Pasadena, Kalifornia, kanë identifikuar tre faktorë kryesorë që ndikojnë në rotacionin e planetit. Më parë mendohej se një lëvizje e lehtë ishte përgjegjëse vetëm për një proces të njohur si "drift akullnajor".

Megjithatë, ky proces është tepër i ngadalshëm për të qenë vetëm përgjegjës. Studimi i ri identifikoi dy faktorë të tjerë të këtyre ndryshimeve, të cilat luajnë të njëjtin rol në ndikimin e rotacionit të Tokës. E para nga këto është e ashtuquajtura "veshja e konvojit". Ky proces rregullon lëvizjen e pllakave tektonike në sipërfaqen e planetit, dhe NASA tani beson se kjo gjithashtu ndikon në "kërcimin" e saj. Një tjetër shkak është shkrirja e akullit, sidomos në Grenlandë, që përbën 33 për qind të efekteve të dridhjes. Ky proces është përshpejtuar nga ngrohja artificiale njerëzore e mjedisit.

NASA vlerësoi se gjatë shekullit të 20-të, në oqean u shpërnda një sasi masive prej 7.500 gigatonë akull të Grenlandës. Ky zhvendosje e gravitetit nga Grenlanda në pjesë të tjera të globit ka shkaktuar



që Toka të ketë rotacion shumë më ndryshe në krahasim me rrethana normale.

Interneti do të ndahet "në dy botë" brenda vitit 2028

Interneti do të ndahet në dy botë të ndryshme brenda dekadës së ardhshme dhe Kina do të udhëheqë njërën prej tyre, sipas shefit ekzekutiv të Google, Eric Schmidt. 63-vjeçari multi-miliarder thotë se censura dhe kontrolli i qeverisë kineze mbi aksesin online të qytetarëve të saj do të thotë se nuk është në përputhje me demokracinë e internetit në perëndim. Kjo do të thotë se do të ketë dy versione të dallueshme të rrjetit botëror nga viti 2028, një i drejtuar nga Kina dhe tjetri nga SHBA. Procesi tashmë po ndodh, me të ashtuquajturën Zjarri i Madh i Kinës që bllokon aksesin për qytetarët kinezë në disa nga faqet më të njohura të internetit, duke përfshirë Facebook dhe YouTube.

Schmidt i bëri komentet duke folur në një konferencë private të teknologjisë në San Francisko të organizuar nga Village Global VC të mërkurën. Sipas Daily Mail, ai tha se interneti ka të ngjarë të ketë dy zëra të qartë dhe të ndarë nga njëri-tjetri, në vend të fragmentimit masiv në mbarë botën. "Mendoj se skenari më i mundshëm nuk është një shkëputje, por më tepër një ndarje e internetit e drejtuar nga kinezët dhe një internet jo kinez i drejtuar nga Amerika", tha Schmidt.

"Nëse shihni Kinën, shkalla e kompanive që po ndërtohen, shërbimet dhe pasuria që po krijohet është fenomenale". Schmidt shtoi se ai pret të shohë që mallrat dhe shërbimet të cilat ofrohen përmes internetit rriten në mënyrë eksponenciale në Kinë. "Unë mendoj se ju do të shihni një udhëheqje fantastike në produktet dhe shërbimet nga Kina", tha ai. Ish-shefi ekzekutiv i Google, i cili ka punuar në kompani për 17 vjet nga viti 2001 deri në vitin 2017, komenton rregullisht mbi të ardhmen e teknologjisë dhe parashikimet e tij për mënyrën se si do të formësojë botën.

NJË "VALENTINË" SI ERMONELA JAHO NË PARIS, NEW YORK TIMES VLERËSON SOPRANON

"Opera National de Paris" feston datëlindjen e 350 me sopranon shqiptare. "New York Times" shkruan me superlativa për shfaqjen që do të jepet deri në 24 tetor. Ky vit shënon edhe "rilindjen" e Meyerbeer, me të cilin skena franceze "ripërkufizon" operën

Zëri i Ermonela Jahos kësaj here ka pushtuar "Opera National de Paris". Ndaj performancës së saj në rolin e Valentinës në "Les Huguenots", është shprehur me nota superlative edhe New York Times, duke i dedikuar një artikull rikthimit të kësaj opere në kuadër të datëlindjes së 350 kësaj skene gjigante parisiene. Në këtë shkrim i kushtohet vëmendje të veçantë rikthimit të kompozitorit Giacomo Meyerbeer, duke u ndalur tek ndikimi që kanë pasur veprat e tij edhe tek opera të tjera me famë. "Pas 350 vjetësh, opera franceze përkufizon përsëri operën", thuhet në këtë shkrim, ku këngëtarja shqiptare veçohet për interpretimin e saj të zjarrtë që ndez konfliktin e veprës.

Opera Kombëtare e Parisit ka nisur celebrimin e datëlindjes së 350-të. Opera si një gjini e artit mund të jetë disa dekada më e vjetër se kaq, por as një formë tjetër moderne e artit nuk ka mundur ta kapërcejë historinë e saj deri më tani. Shpesh nëpër të gjithë botën i referohen thjesht si Opera, sikur ky të jetë definicioni real i zhanrit. Datëlindja e madhe e saj nuk fillon me nostalgji, por me dy përpjekje që e shikojnë të shkuarën e artë të kulturës franceze, "patrimoine" (trashëgiminë) e pasur të këtij vendi parë në një dritë bashkëkohore madje edhe futuriste. Një pasuri e tillë e lavdishme si "Les Huguenots" i Meyerbeer-it, që u vu në skenë të premten do të vazhdojë të shfaqet deri në 24 tetor. Kjo vepër nuk ishte performuar nga Opera qysh në vitin 1936, edhe pse ka qenë me shumë mundësi muzika dramatike më popullore e shekullit të XIV. E luajtur në të gjithë botën pasi debutoi në këtë Operë në vitin 1938, ishte titulli i parë që u luajt nga kjo kompani 1000 herë. "Bérénice" një vepër e re nga kompozitori suedez Michaek Jarrel që pati premierën e saj këtë të shtunë do të vazhdojë deri në 17 tetor. Kjo vepër është e bazuar në tragjedinë e Rasinit, të shkruar një vit pasi Opera u themelua në vitin 1669. (Lugji i XIV-të e quajti atëherë "Académie d'Opéra", por ajo do të emërtohej më vonë si Akademia Mbretërore e Muzikës, titull që do të trashëgohej nga dy teatro më të vegjël të firmës, ndërsa më vonë në fund të shekullit e XIV, do të quhej "Palais Garnier"). Vepra e Rasinit është injoruar në mënyrë masive midis shekullit e shtatëmbëdhjetë dhe atij të njëzetë; "Les Huguenots", ashtu si veprat e mëdha të njëpasnjëshme të Meyerbeer-it, nisën po ashtu të zhdukeshin pak a shumë nga repertori. Opera po jep një mesazh të rëndësishëm me këtë shfaqje të një profili të lartë, ndoshta një për operën në përgjithësi: Arti madhështor, format madhështore të artit, ndoshta mund të kenë ulje dhe ngritje përsa i përket popullaritetit, por cilësia është cilësi, siç është bërë e njohur në 1670, 1836 apo në vitin 2018. Të shikosh sot "Les Huguenots", do të thotë të kuptosh eklipsin e gjatë të Meyrbeer-it, madje ta mohosh duke e çrrënjosur përzemërsisht për rilindjen e tij aktuale. Ai luan ndonjëherë një lojë në agonizëm dhe të duruar, duke krijuar me përpikëri tensionin që shpërthen vetëm në fund të një mbrëmje të mbushur me emocion. (Ky produksion parisienë bën shkurtime të konsiderueshme dhe përsëri vazhdon të ketë rreth katër orë muzikë)./Shekulli

Hapet panairi më i madh i librit në botë

Është hapur në Frankfurt panairi më i madh tregtar në botë për industrinë botuese me 7 000 ekspozues nga 105 shtete të ndryshme, bëri të ditur shtypi vendas.

Organizatorët thonë se ngjarja vazhdon të rritet me 3,0% më shumë ekspozues në 2018 sesa vitin e kaluar. Në vitin 2017 më shumë se 250 000 njerëz vizituan panairin e librit.

Autorja nigeriane, Chimamanda Ngozi Adichie është ftuar të flasë në ceremoninë e hapjes dhe në mbrëmje do të jetë shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Frederica Mogherini, e cila do të mbajë një fjalim.

Vendi i ftuar i këtij viti është Gjeorgjia, e cila është paraqitur me pavijonin e saj. Kryeministri gjeorgjian, Mamuka Bakhtadze pritet të jetë i pranishëm në ceremoninë së hënës.

Zbulohet mbishkrimi "Jeruzalem" në gurin mijëvjeçar

Një shkrim i rrallë me shkronja hebraike i emrit të Jeruzalemit, i gdhendur në një gur cilindrik, u zbulua vitin e kaluar nga arkeologët izraelitë në hyrjen perëndimore të qytetit, theksuan autoritetet.

"Është shumë e rrallë të gjesh nga ajo epokë shkrimin e plotë të emrit të Jeruzalemit", vuri në dukje arkeologu Ilan Baruk.

"Për më tepër, është shumë emocionuese të dallosh qartë shkronjat që mund të shihen sot nga çdo fëmijë izraelit", shtoi drejtori i Muzeut të Izraelit, Ido Bruno.

Pothuajse një metër i lartë dhe me sa duket i kohës së mbretit Herodi, guri ishte hequr nga ndërtesa origjinale dhe pastaj ishte ripërdorur për ndërtimin e një ndërtese romake.

Teksti është në aramaisht dhe përmban fjalët "Hanania, bir i Dodlos të Jeruzalemit".

Sipas arkeologëve është e supozueshme se Hanania ishte një zejtar vendas dhe se 'Dodlos' ishte një referencë e homazhit të figurës së Daedalusit.

Kur Schliemann takonte arvanitasit në Itakën e Odiseut

«Kur afrohesha në kasollet e fshatarëve për të blerë rrush apo për të pirë ujë, gjithnjë n'a suleshin qentë, por duke i gjuajtur me gurë apo duke bërë sikur po merrnim ndonjë gurë për ti goditur, unë i mbaja ata larg nesh.

Atë ditë në shtëpinë e fshatarit, në oborr u sulmova me furi nga katër qenër të mëdhenj që nuk trembeshin nga gurët e mi. Por ai që më udhëhiqte në atë udhëtim kishte mbetur larg meje dhe në këtë situatë të vështirë m'u kujtua historia e Odiseut që kisha lexuar, i cili, kur i ishin turrur qentë, ishte ulur qetësisht dhe kishte qëndruar pa lëvizur.Dhe kështu unë ndoqa shëmbullin e Uliksit duke mos lëvizur, edhe pse qentë ishin gati të më shqyenin, duke ardhur rrotull meje. Ata do më kishin kafshuar po të mos isha përulur, duke e zbutur kështu egërsinë e tyre...»

Këtë histori, Schliemann e tregon në librin e tij « Kërkimet arkeologjike në Itakë, Peloponez e Trojë », shkruan Luan Rama në gazetën SHQIPMë tej ai vazhdon: «Pasi thirra, u shfaq një burrë shtatëdhjet vjeçar me tipare të mira dhe sy të mëdhenj inteligjentë, me një hundëshqiponje, me flokët e gjata e të bardha si dëbora që kontrastonte me fytyrën e tij të nxirë nga forca e diellit.Siç ndodh këtu, ai po vinte këmbëzabathur dhe me një fustanellë pambuku, e lidhur sipër brezit dhe qe zgjatej poshtë në njëmijë palë deri tek gjunjtë. Ky kostum i shqiptarëve që e kanë adoptuar grekët që nga koha e revolucionit, ekziston në Shqipëri që nga koha e antikitetit të hershëm dhe shpesh e gjen në statujat e vjetra dhe veçanërisht të Pirros, mbretit të Epirit që ndodhet në muzeun e Napolit...»

DREJTORI SPORTIV I SHKUPIT FLET PËR GJENDJEN MOMENTALE NË SKUADËR

BUNJAKU: RAMADANI ËSHTË FAJTORI KRYESOR PËR KRIZËN E SHKUPIT

"Dua të them se gjatë gjithë kohës që tradhtar më i madh i FC Shkupit në këtë situatë është Zekirija Ramadani së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Ai u largua në njëmoment shumë të padrejtë, pasi la klubin në moment shumë të keq po më e keqja është se ai la klubin pa lojtar, ka deklaruar Bunjaku

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 9 tetor - Skuadra e Shkupit nga nëntë xhirot e zhvilluara deri më tani në Ligën e Parë të Maqedonisë ka tubuar vetëm 6 pikë duke u radhitur të fundit në tabelën e klasifikimit. Pas nëntë javëve ekipi nga Çairi ka shënuar vetëm një fitore dhe ka barazuar në tre përballje në pesë takimet tjera ka pësuar disfatë. Ky start për Shkupin është më i keqi prej se kur janërikthyer në Ligën e Parë. Gjatë vikendit përfundoi rrethi i parë, ndërsa drejtori sportiv i skuadrës së Shkupit, Omer Bunjaku ka fajësuar ish trajnerin Zekirja Ramadani për krizën që e ka kapluar ekipin. "Dua të them se gjatë gjithë kohës që tradhtar më i madh i FC Shkupit në këtë situatë është ZekirijaRamadani së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Ai u largua në njëmoment shumë të padrejtë, pasi la klubin në moment shumë të keq,por më e keqja është se ai klubin e la edhe pa lojtarë. Por, pikërisht fajtori kryesor në merkato është Zekirija Ramadani, për transferët, për largimin e lojtarëve si Edis Maliqit, Alen Jasharovskin, gabimi më i madh që i ka ndodhur Shkupit këto vitet e fundit është OmarImeri edhe për këtë është fajtor Ramadani. Largimi i fëmijëve të rinj si Fatih Ismaili, Altin Sefo, të cilët ishin gati të luajnë si lojtar në U21, të gjithë këto i largoi dhe tani na ka mbetur në klub vetëm një Suhejl Muharemi. Un si drejtor sportiv së bashku me tim menaxherin e klubin Ertan Demiri dhe sponsorët nga Turqia i kemi ofruar lojtarë të rinj Ramadanit, por ai nuk pranonte asnjë lojtarë. E gjithë kjo forcë tek ai vinte nda bashkëpunëtori i tij Shefshet Demiri dhe falë këtyre dyve ekipi sot gjendet në fund të tabelës që kjo neve nuk na ka ndodhur këto vitet e fundit", deklaroi drejtori sportiv i skuadrës së FC Shkupi, Omer Bunjaku në emisionin "Sportmania" Bunjaku premton se gjendja e klubit "bardheblu" do të përmirësohet, ndërsa nga janari do të jetë edhe më ndryshe, duke premtuar edhe merkato me futbollistë tjerë. Bunjaku po ashtu foli edhe për mundësinë e rikthimin të trajnerit Ardian Nuhiu në ekipi, por edhe pas tentativa të shumta që bënë ishte klubi i Dritës që nuk pranoi largimin e trajnerit shkupjan. "Të gjithë kishim dëshirë që ta kemi Ardian Nuhiun në klub, së bashku me pronarët nga Turqia. Por ai tani më ka kontratë me Dritën dhe ne duhet që tërespektojmë atë kontratë edhe pse ne u munduam që të gjejmë gjuhë të përbashkët me ekipin kosovarë por kjo nuk u arrit dhe tani neve na mbetët ti urojmë fat Nuhiut me klubin e tij Drita që të kenë sa më shumë suksese. Por ne shpresojmë se më ardhjen e trajnerit nga Turqia Umut Karan do të arrijmë të dalim nga kjo krizë dhe të arrijmë sa më lartë në tabelë", theksoi Omer Bunjaku. Skuadra e Shkupit tani do të ketë kohë dy javë për tu përgatitur sa më mirë për fazën e dytë të Ligës së Parë të Maqedonisë. Takimin e parë të fazës së dytë ekipi nga Çairi do ta luajë në terren vendas përballë Sileksit me 21 tetor.

Hasani: Kemi ekip të mirë, shkojmë në fitore

Shkup 9 tetor – Futbollisti tetovar që po luan në kampionatin arab te ekipi i Al Raed, pas pauzës prej disa muajve është rikthyer në përfaqësuesen e Maqedonisë për dy takimet e radhës ndaj Lihtenshajnit dhe Armenisë në kuadër të kualifikimeve për Ligën e Kombeve. Hasani nuk e ka fshehur gëzimin e tij që është bashkuar përsëri me reprezentacionin e Maqedonisë. "Te kthehem, ju e dinë se gjithmonë jam këtu për të ndihmuar reprezentacionin. Maqedonia tani ka një skuadër shumë të mirë, me lojtarë cilësor. Gëzohem që është kështu, na presin dy takime së pari ndaj Lihtenshtajnit dhe më pas do të jemi mysafire e Armenisë. Pres që në këto dy përballje të shënojmë fitore. Takimi ndaj Armenisë e kam shikuar nga tribuna dhe përgëzoj bashkëlojtarët për lojën e zhvilluar. Shpresoj se do të vazhdojmë edhe më tej të luajmë në këtë mënyrë", deklaroi Ferhan Hasani. Buba tregoi edhe për ecurinë në kampionatin arab. "Në fillim të kampionatit kishim disa probleme, por tani është shumë mirë dhe shpresojmë të vazhdojmë me këtë ritëm", tha Buba. Nga ana tjetër portieri i reprezentacionit të Maqedonisë, Stole Dimitrievski është optimistë për dy ndeshjet e radhës ndaj Lihtenshtajnit dhe Armenisë. "Jam i lumtur që jam bashkuar me grupin. Po përgatitemi për takimin e parë ndaj Lihtenshtajni. Mendojë që do të luajmë ashtu si duhet dhe ashtu si presim të gjithë. Dua që të vazhdojë ecuria pa pranuar gol dhe me fitore të jemi më afër synimit tonë të mbajmë kreun e tabelës", deklaroi portieri i Maqedonisë, Stole Dimitievski. Maqedonia me 13 tetor në Shkup do të përballet me Lihtenshtajni me fillim prej 20:45, ndërsa tre ditë më vonë do te jetë mysafire e Armenisë. *(F.N)*

Kosova nuk ndalet, edhe dy "përforcime" të shkëlqyera nga Zvicra

Më herët ishte kombëtarja e Shqipërisë, por Tashmë është Kosova ajo që po mbledh bijtë e saj anembanë Europës, por mbi të gjitha në Zvicër, aty ku shqiptarët nga Kosova janë pa fund. Përfaqësuesja e drejtuar nga Bernard Challandes po shton radhët nga muaji në muaj dhe mosha e re e skuadrës jep garanci për një të ardhme të ndritur, ndërsa për ndeshjet e radhës është bashkuar me Kosovën edhe Lirim Kastrati, anësori i majtë ofensiv i cili po shkëlqen te Lokomotiva e Zagrebit. Ndërkaq, në nëntor priten edhe dy përforcime madhore, sepse mbrojtësi Mirlind Kryeziu dhe Shkëlqim Demhasaj do të debutojnë me Kosovën. Mirlind Kryeziu është 21 vjeç dhe ka qenë pjesë e Zvicrës U17, ndërsa prej sezonit 2016/17 është pjesë e FC Zurich, ku ka luajtur 7 ndeshje kampionati këtë sezon. Befasues është lajmi se pjesë e Kosovës do të jetë edhe Shkëlqim Demhasaj, sepse sulmuesi i Luzern është duke shkëlqyer në kampionat dhe është pjesë e Zvicrës U21 prej vitit të shkuar. Ka qenë vetë trajneri Bernard Challandes ai që ka konfirmuar gjithçka, në konferencën e sotme për shtyp: " Jemi duke kompletuar dokumentacionin për Demhasajn dhe Kryeziun". Challandes ka folur edhe për Florent Hadërgjonaj, për të cilin tha: "Ai duhet të jetë i vendosur që të luajë për Kosovën dhe ta konsiderojë të domosdoshme që të luajë për shtetin e vet dhe ta mendojë së rezervë. Disa herë kemi kontaktuar me te dhe asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje të saktë. Prandaj, ai dhe të tjerët që mendojnë të vijnë të luajnë për Kosovën duhet ta thonë qartë dhe me vendosmëri".

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM-së. nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 и 120/18), dhe pëlqimet të marra nga Ministria e financave të RM me nr. 18-8330/2 të datës 30.07.2018 dhe nr. 18-11008/2 të datës 08.10.2018, Shoqëria aksionare, Agjencia Informative e Maqedonisë Shkup, në pronësi të shtetit shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 6 (gjashtë) personave për kohë të pacaktuar

Shoqëria aksionare "Agjencia Informative e Maqedonisë"-Shkup, në pronësi shtetërore, me seli në rr. Bojmia K-2, 1000, Shkup, publikon shpallje për punësim të 6 (gjashtë) personave për kohë të pacaktuar, për vendet e punës në vijim:

1. Videoxhirues – një (1) realizues
2. Videomontues – një (1) realizues
3. Fonoincizues – një (1) realizues
4. Korrespodent më i vjetër nga RM (nga Kavadari) – një (1) realizues
5. Korrespodent nga RM (nga Kumanova) – një (1) realizues
6. Mirëmbajtës të higjienës - një (1) realizues

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të konfirmuara me ligj duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim:

1. Videoxhirues – një (1) realizues
- Të ketë të mbaruar arsimin e mesëm shkalla IV/1,
- Të ketë minimum tre (3) vjet përvojë pune në profesion.

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar me turne prej të hënës deri të premten, dhe kujdestari gjatë fundjavave.
Orari i punës në turnin e parë është prej orës 08 deri në orën 15, ndërsa në turnin e dytë prej orës 12 deri në orën 19.
Neto paga bazë është: 19.220 denarë

2. Videomontues – një (1) realizues
- Të ketë të mbaruar arsimin e mesëm shkalla IV/1,
- Të ketë minimum tre (3) vjet përvojë pune në profesion.

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar me turne prej të hënës deri të premten, dhe kujdestari gjatë fundjavave.
Orari i punës në turnin e parë është prej orës 08 deri në orën 15, ndërsa në turnin e dytë prej orës 12 deri në orën 19.
Neto paga bazë është: 19.220 denarë

3. Fonoincizues – një (1) realizues
- Të ketë të mbaruar arsimin e mesëm shkalla IV/1, pa përvojë pune

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar me turne prej të hënës deri të premten, dhe kujdestari gjatë fundjavave.
Orari i punës në turnin e parë është prej orës 08 deri në orën 15, ndërsa në turnin e dytë prej orës 12 deri në orën 19.
Neto paga bazë është: 17.140 denarë

4. Korrespodent më i vjetër nga RM (nga Kavadari) – një (1) realizues
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkallën VII/1
- Të ketë përvojë pune të paktën një (1) vjet

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar prej të hënës deri të premten prej ora 8.30 deri në ora 16.30. Për shkak të natyrës së punës fillimi dhe mbarimi i orarit të punës mund të organizohet edhe ndryshe, por në kuadër të 40 (dyzet) orëve të punës në javë.
Neto paga bazë është: 20.259 denarë

5. Korrespodent nga RM (nga Kumanova) – një (1) realizues
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkallën VII/1 , pa përvojë pune

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar prej të hënës deri të premten prej ora 8.30 deri në ora 16.30. Për shkak të natyrës së punës fillimi dhe mbarimi i orarit të punës mund të organizohet edhe ndryshe, por në kuadër të 40 (dyzet) orëve të punës në javë.
Neto paga bazë është: 17.140 denarë

6. Mirëmbajtës të higjienës - një (1) realizues
- Të kenë të mbaruar arsimin fillor, pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë dhe është i organizuar me turne prej të hënës deri të premten, dhe kujdestari gjatë fundjavave.
Orari i punës në turnin e parë është prej orës 08 deri në orën 15, ndërsa në turnin e dytë prej orës 12 deri në orën 19.
Neto paga bazë është: 15.060 denarë

Afati i paraqitjes së kandidatëve është tre (3) ditë pune, llogaritur një ditë pas ditës së publikimit të shpalljes.
Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 45 ditëve pas skadimit të afatit për paraqitje.
Kandidatët për vendet e lartpërmendura të punës krahas Aplikacionit me biografi të shkurtër (CV), duhet t'i dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Diplomë ose certifikatë për arsimin e mbaruar (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
- Dëshmi për përvojën e punës, për pozitat nën pikat 1, 2 dhe 4 me theksim të përvojën e punës dhe kohëzgjatje të asaj përvoje, të dhënë nga kompania/institucioni/organi, me çka dëshmohet se personi (kandidati) me shkallë konkrete të përgatitjes profesionale ka arritur përvojë të punës, aftësi dhe të ngjashme (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i parregulluar dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme, kandidatët t'i parashtrojnë në zarf të mbyllur (me shenjë shpallje për punësim) në adresën në vijim:
SHA "MIA" – Shkup,
Rr. Bojmija nr. K-2,
Fahu postal 4
1000 Shkup
Personi për kontakt: Daniella Dimitrieva tel. 2-461-600 lok. 237
SHA "MIA" – Shkup

Në bazë të nenit **22 dhe 23** të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 35 të Statutit të NP "KOMUNALEC" – KËRÇOVË, drejtori i NP publikon

SHPALLJE

NP "KOMUNALEC" – Kërçovë ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar edhe atë:

1 - 3 punëtorë për parqe dhe sipërfaqe tregtare publike
2 - një punëtor të KU
3 - një punëtor elektro-inxhinier i diplomuar me VII/1
4 - një punëtor të drejtimit të ndërtimtarisë me 180 SETK
5 - një punëtor inxhinier të diplomuar të biologjisë – biokimist
6 - një punëtor me PMP – shkalla IV
7 - tre punëtorë vozitës të kategorisë C
8 - një punëtor me PMP – shkalla III

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

Për pikën 1 dhe 2
- **arsim fillor, pa përvojë pune**

Për pikën 3:
- **punë me kompjuter, së paku dy vjet përvojë pune në profesion**

Për pikën 4:
- **punë me kompjuter, së paku një vit përvojë pune në profesion**

Për pikën 5:
- **punë me kompjuter, pa përvojë pune**

Për pikën 6:
- **Arsim të mesëm, punë me kompjuter pa përvojë pune**

Për pikën 7:
- **Arsim fillor, leje të vozitjes të kategorisë C dhe përvojë pune prej 1 vjet**

Për pikën 8:
- **Arsim të mesëm, 1 vjet përvojë pune**

Për pikën 1 dh 2 fillimi dhe mbarimi i orarit të punës do të jetë prej ora 6 – 14 dhe pagesa fillestare në shumë prej 12.900 denarë, për pikën 2 në shumë prej 14.800, ndërsa për pikën 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 fillimi dhe mbarimi i orarit të punës do të jetë prej ora 7 – 15, pagesa fillestare për pikën 3 do të jetë në shumë prej 20.600 denarë, pika 4 në shumë prej 20.600 denarë, pikën 5 në shumë prej 18.720 denarë, pikën 6 në shumë prej 16.200 denarë, pikën 7 në shumë shumë prej 16.280 denarë dhe për pikën 8 në shumë prej 16.200 denarë

Shpallja zgjatë **3 (tre) ditë pune** nga dita e publikimit në shtypin ditor. Afati për zgjedhje të kandidatëve do të jetë në pajtim me nenin 23 pika 2 të LMP.
Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në NP "KOMUNALEC" Kërçovë, Rruga transitore nr. 34.
Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

DREJTOR
ZENDEL JONUZI

ЦЕНТР@ЛЕН РЕГИСТАР НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Numër 04-1803/5
Shkup, 09.10.2018

Plotësim i SHPALLJES PUBLIKE

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë bën plotësimin e Shpalljes publike numër 04-1803/ 4 të publikuar më 09.10.2018.

- Në alinetë 1, 3, 4 dhe 13 shtohen fjalët "së paku 3 vjet përvojë pune në profesion"
- Në alinetë 2, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14 dhe 15 shtohen fjalët "me ose pa përvojë pune në profesion"

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë
Shkup

Në bazë të nenit 128 dhe nenit 130 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/8) dhe nenit 8 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënie me qira të sallës së fizkulturës, klasave ose hapësirës tjetër administrative-afariste, drejtori i SHF "Panajot Ginovski" Butel, Shkup publikon:

SHPALLJE
Për grumbullim të ofertave

1. QIRADHËNËS: SHF "Panajot Ginovski", komuna e Butelit – Shkup,me seli në rr. "Ferid Bajram" tel 2621-416.
2. OFERTUES: Të drejtë për parashtrimin e kërkesës për qira të pronave të patundshme ka çdo subjekt i interesuar i vendit dhe i huaj juridik që është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën për qira.

3. LËNDA E QIRASË
1. Klasa,
2. Hapësirë shkollore – aula

Qiradhënësi jep hapësirat me qira të theksuara në pikën 3 përmes grumbullimit të ofertave me shkrim.
Dokumentacioni ku në mënyrë të detajuar janë theksuar patundshmëritë që janë lëndë e qirasë, si dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë ofertuesit, mund t'i marrin çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 14.00 në hapësirën e sekretarit.
Ofertuesi duhet që ofertat ti dorëzojë në dokumentacionin e nënshkruar dhe vulosur në zarf të mbyllur me shenjë "Për shpallje për qira të terminëve dhe dhënie me qira të hapësirës shkollore".
Dorëzimi i ofertave mund të bëhet personalisht ose përmes postës në adresën: SHF Panajot Ginovski rr. Ferid Bajram nr. 30, komuna e Butelit.
Oferta që nuk do të përmbajë edhe dokumentet e nevojshme ose do të arrijnë më vonë do të konsiderohen si të pakompletuara dhe si të tilla nuk do të merren parasysh.
Shpallja zgjatë 3 ditë në të cilin afat duhet të dorëzohet oferta.
Hapja e ofertave do të mbahet më datë 15.10.2018 në ora 12.00 në lokalet e shkollës. Të gjitha ofertat që kanë arritur më vonë nuk do të shqyrtohen.

SHF "Panajot Ginovski"

Në bazë të nenit 130 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/08), Drejtori i Shkollës fillore komunale "Partenija Zografski", Kisella Vodë publikon:

SHPALLJE

Për sigurimin e nxënësve prej pasojave të rasteve të fatkeqësive – aksidenteve për periudhën prej 20.10.2018 deri më 20.10.2019

Në ofertat e tyre subjektet e interesuara juridike duhet të parashtrojnë dokumentet e nevojshme në vijim:
1. Oferta teknike financiare për përafërsisht 500 nxënës prej klasës 1-9.
2. Dëshmi për veprimtari të regjistruar

Subjektet e interesuara juridike mund të marrin dokumentacionin tenderues nga SHFK "Partenija Zografski", Kisella Vodë – Shkup, rr. Dositej Obradoviq nr. 18 – Shkup, tel. 2770-719.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
Të gjitha ofertat që vijnë më vonë nuk do të shqyrtohen.

SHFK "Partenija Zografski", Kisella Vodë – Shkup

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018), Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të shkencave bujqësore dhe ushqimit-Shkup në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS
PËR ZGJEDHJE TË TITULLIT BASHKËPUNUES

1). 1 (një) asistent në sferën shkencore – **Kualiteti, siguria dhe teknologjia e mishit dhe përpunimeve të mishit** – 41403 – të tjera Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave
2). 1 (një) asistent në sferën shkencore – **Bimë të errëta** – 40303 –Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave
3). 1 (një) asistent në sferën shkencore – **Gjenetika dhe përzgjedhja e prodhimtarisë bimore** – 40308 – Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave

Kushtet: Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të cekura në nenin 170 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe Ligjit për marrëdhënie pune.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje, biografi të shkurtë, dokumente me të cilën dëshmohet përmbushja e kushteve.

Dokumentet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Vendi i punës së bashkëpunëtorit është përcaktuar në pajtim me aktet e fakultetit dhe orarit të orëve në semestër.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë dorëzohen deri në Fakultetin e shkencave bujqësore dhe ushqimit – Shkup, bul. "16-ta Makedonska Brigada" nr. 3 Shkup.

Afati për paraqitje është 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË BUJQËSISË DHE USHQIMIT - SHKUP
UNIVERSITETIT "SHËN KIRILI DHE METODI" NË SHKUP

Në bazë të nenit 22, paragrafi (1), pika (1) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 75/2015), nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 156/2010, 18/2011, 51/2011, 100/2012, 24/2013, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 67/2017), nenit 2 alineja 2, nenit 3 paragrafi 1 dhe 2, nenit 21 paragrafi 3 dhe nenit 22 alineja 2 paragrafi 3 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/2014) ndërsa në bazë të Pëlqimit për financim të ri për vitin shkollor 2018/2019, të marrë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë – Sektori për arsim fillor dhe të mesëm numër 12-10292/30 të datës 20.9.2018, U.D Drejtori i Shkollës fillore komunale "Aleksandar Makedonski" – komuna e Aerodromit, Shkup, Violeta Gjorgjievska, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të caktuar të punës – financim i ri deri më 31.08.2019

PUBLIKOHET, shpallje publike për punësim të mësimdhënësve për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2019, për vendet e punës në vijim (financim i ri):

1. **Mësimdhënës të shkencave natyrore, me 4 orë mësimore, gjegjësisht 8 orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me Studime të mbaruara të biologjisë, të shpërndarë në 2 (dy) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore në shumë prej 4.240,00 denarë + shtesa për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit stazh të punës, me orar javor të punës prej ora 07:30 deri në ora 13:30 dhe prej ora 13:00 deri ë ora 18:30;**
2. **Mësimdhënës të mësimit klasor, me 20 orë mësimore, gjegjësisht 40 orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me Studime të mbaruara të pedagogjisë në Fakultetin filozofik ose Studime për mësim klasor në Fakultetin pedagogjik, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore në shumë prej 21.200,00 denarë + shtesa për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit stazh të punës, me orar javor të punës prej ora 07:30 deri në ora 15:30**
3. **Mësimdhënës të mësimit klasor, me 20 orë mësimore, gjegjësisht 40 orë pune në javë, 1 (një) realizues për mësimin në gjuhën maqedonase, me Studime të mbaruara të pedagogjisë në Fakultetin filozofik ose Studime për mësim klasor në Fakultetin pedagogjik, të shpërndarë në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore në shumë prej 21.200,00 denarë + shtesa për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit stazh të punës, me orar javor të punës prej ora 07:30 deri në ora 15:30**

Me fletëparaqitjet në lidhje me shpalljen publike kandidatët duhet të parashtrojnë:

- **Diplomë ose Certifikatë për arsim të mbaruar përkatës (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);**
- **Certifikatë për derikualifikim pedagogjik-psikologjik dhe metodik (për mësimdhënësit që nuk kanë mbaruar grupin mësimor të studimeve);**
- **Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).**

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke konsideruar nga dita e përfundimit të së njëjtës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme duhet të parashtrohen përmes postës ose me postë të shpejtë ose në arkivin e Shkollës fillore komunale "Aleksandar Makedonski" – Komuna e Aerodromit, Shkup, rruga "1612", numër 4, komuna e Aerodromit, Shkup.

Shkolla fillore komunale "Aleksandar Makedonski"
– Komuna e Aerodromit, Shkup
UD DREJTORI,
Violeta Gjorgjievska

"TRE MUSKETIERËT" PUSHTOJNË ANGLINË

Premier League sillet rreth Manchester City, Chelsea dhe Liverpool me dorën e dukshme të trajnerëve Guardiola, Sarri dhe Klopp, që po ofrojnë më të mirën e mundshme në Angli

60 pikë të ndara në mënyrë të barabartë pas tetë javësh, kryesimi i renditjes i ndarë mes tre ekipeve, asnjë humbje dhe tre stile të ndryshime, por i njëjti efikasitet. Premier League sillet rreth Manchester City, Chelsea dhe Liverpool me dorën e dukshme të trajnerëve Guardiola, Sarri dhe Klopp, që po ofrojnë më të mirën e mundshme në Angli. Por kujdes nga Arsenal dhe Tottenham. Tre golat e shënuar nga Chelsea në Southampton dhe barazimi i "të kuqve" me "qytetarët" kanë ndërtuar një fron për tre vetë, që i sheh nga lart të gjitha ekipet e tjera në Angli. Kjo është diçka që po zbavit edhe vetë këta trajnerë. Kjo sepse nëse Sarri fshihet ("Dy ekipet e tjera janë më para se ne"), por që ka hyrë në zemrën e tifozëve të rinj, Guardiola është i kënaqur për barazimin e çmuar, kundër një "mace të zezë" dhe vetë Klopp e di që ka shpëtuar mrekullisht nga penalltia e humbur prej Mahrez. Italiani po zbulon shijen e qarkullimit të topit më shumë se në vitet te Napoli, katalanasit po kërkon më shumë cinizëm nga një formacion që ka sigurinë e titullit të fituar në sezonin e kaluar, ndërsa gjermani e di si të karrikojë një ekip që bazohet te loja fizike dhe kundërsulmet. Jo domosdoshmërisht ka një të bukur dhe një të shëmtuar, ose më saktë njëri mirë dhe tjetri keq. Pas tetë javësh e thotë edhe renditje. Sezoni duhet ende të futet në fazën më të rëndësishme, por këta të tre po i japin lustrën termin "Premier League, kampionati më i bukur në Botë". E gjithë kjo nëse Emery dhe Pochettino nuk vendosin të trokasin më fort. Spanjolli po largon Arsenal nga vitet e errëta, ndërsa argjentinasi duket se është përqendruar më shumë te Champions League dhe ka bërë një merkato të shterpë. Po Manchester United? Mbetet një rast më vete, si pasojë e probleme të brendshme mes futbollistëve dhe trajneri Mourinho. Prestigji i klubit është i madh, por besueshmëria që mund të luftojë për titull është e vogël. Gjithsesi mbeten edhe 7 muaj me ndeshje.

Gati revolucioni në mbrojtjen e Interit, ja emrat e piketuar

Mbrojtja e Interit mund t'i nënshtrohet një revolucioni të madh në sezonin e ardhshëm. Nga të katër emrat, që sot janë pjesë e skuadrës zikaltër për këtë repart, vetëm i ardhuri i fundit, De Vrij, është i sigurtë për konfirmimin. Për Skriniar, me të cilin kanë ngecur bisedimet për rinovimin e kontratës, pasi Interit do t'i duhet të përballet me një marrëveshje super (nga 60 deri në 80 milionë euro), kanë shfaqur interesim klubet e mëdhaja të huaja, si Barcelona dhe Manchester United. Pastaj janë "ekspertët" Miranda dhe Ranocchia, që të dyve u mbaron kontrata në qershor 2019. E ardhmja e brazilianit dhe ish-lojtarit të Genoa-s mbetet ende e gjitha për t'u deshifruar. Kjo është arsyeja pse drejtori sportiv, Ausilio, po shikon rreth e rrotull për më shumë alternativa, që mund t'i afrojë pa asnjë kosto. Klubi zikaltër shpreson të nënshkruajë me Vincent Kompany verën e ardhshme, raporton "Interlive.it". Mbrojtësit belg do t'i ofrohet kontratë, e cila mund të jetë e fundit në nivelet e larta për 32-vjeçarin, me mendimin se ditët e tij te Manchester City do të përfundojnë në verë. Interi ka interes edhe për dyshen e Tottenham, Toby Alderweireld dhe Jan Vertonghen, por ata do të ishin shumë më të vështirë për t'u arritur.

Reali prin me më se shumti nominime për Topin e Artë

Fitorja në Ligën e Kampionëve për herë të tretë sezonin që lam pas dhe pasi që lojtarët e tyre ia dolën të jenë finalistë të kupës në Rusi e ku skuadrat spanjolle u përfaqësuan shumë mirë. Barcelona, në anën tjetër ka vetëm tre kandidatë, Lionel Messi, Luis Suarez dhe Ivan Rakitic. Një numër shumë më i vogël sesa sezonet e mëparshme. Pavarësisht se ata fituan La Ligan dhe Copa del Rey, katalunasit nuk patën një paraqitje të mirë në Europë dhe papritur u eliminuan në çerekfinale kundër Romës. Në anën tjetër, Atletico Madrid ka tre nga lojtarët e tyre të nominuar. Antoine Griezmann është njëri prej favoritëve për ta marrë çmimin për shkak të triumfit në Europa Ligë, Super Kupë të UEFA'së, dhe, mbi të gjitha, Botërorin në Rusi ku ai ishte njëri prej lojtarëve më të mirë. Dy lojtarët e tjerë të Atleticos janë edhe Diego Godin dhe Jan Oblak. 14 lojtarë janë nga La Liga në listën e ngushtë më 30 lojtarë, që është pothuajse gjysma e listës. Pas Spanjës është Premier Liga që ka më se shumti përfaqësues në këtë listë. Prin Liverpool me: Alisson Becker, Sadio Mane, Roberto Firmino dhe Mohamed Salah. Pas Liverpool është Tottenham që ka në listë, portierin Hugo Lloris dhe sulmuesin Harry Kane. Po aq sa Spurs ka edhe Chelsea me Eden Hazard dhe N'Golo Kante, ndërkaq Manchester United dhe City përfaqësohen me Paul Pogba përkatësisht Kevin de Bryne. Pas këtyre dy ligave vjen ajo e Francës me treshen e PSG, Cavani, Neymar, Mbappe që janë nominuar që të gjithë dhe krejt në fund Serie A që përfaqësohet në këtë listë me Cristiano Ronaldon dhe Mario Mandzukic, që të dy lojtarë të Juventusit.

Mbappe favorit për çmimin "futbollisti më i mirë U-21"

"Ylli" i Paris Saint-Germain, Kylian Mbappe, është favoriti kryesor mes dhjetë kandidatëve për të fituar "Topin e Artë U21", që sivjet do të jepet për herë të parë dhe që quhet "Trophee Kopa". Ata që do të votojnë për të zgjedhur lojtarin e ri më të mirë të planetit do të jenë 33 fitues të "Topit të Artë" në të kaluarën, përfshi edhe Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi, që mes tyre kanë ndarë dhjetë edicionet e fundit të trofeut madhor individual. Çmimi, që do të jepet më 3 dhjetor, mban emrin e Raymond Kopa, francezi i parë që ka fituar "Topin e Artë", në vitin 1958. Dhjetë kandidatët e "France Football" janë: Gianluigi Donnarumma (Milan), Patrick Cutrone (Milan), Justin Kluivert (Roma), Kylian Mbappé (PSG), Houssem Aouar (Lione), Christian Pulisic (Borussia Dortmund), Rodrygo (Santos), Trent Alexander-Arnold (Liverpool), Amadou Haidara (Salisburgo), Ritsu Doan (Groningen).

BALE LARGOI ZIDANIN NGA REALI

Ai që largoi Zizou nga Real Madrid ishte Gareth Bale. Madje, për saktësim ishte dygolëshi i shënuar nga uellsiani në finalen e Champions League të zhvilluar në Kiev. Nga ai moment, e ardhmja e francezit në pankinën e Real Madrid ishte në rrezik

As Perez dhe as Cristiano Ronaldo. Ai që largoi Zizou nga Real Madrid ishteGareth Bale. Madje, për saktësim ishte dygolëshi i shënuar nga uellsiani në finalen e Champions League të zhvilluar në Kiev. Nga ai moment, e ardhmja e francezit në pankinën e Real Madrid ishte në rrezik. Stuhia e CR7 më pas shërbeu vetëm për të përshpejtuar një proces të nisur pikërisht gjatë mbrëmjes më të rëndësishme të vitit. Bale bën dhe Bale zhbën, sepse roveshata galaktike dhe ajo gjuajtje jo e pandalshme nga jashtë zone i kanë dhuruar Realit trofeun e Champions League dhe kanë bindur trajnerin që të largohet nga Bernabeu. Është pikërisht ky përfundimi në të cilin ka dalë "ElPais", që ka rindërtuar ngjarjen e ndodhur në shtëpinë e Real Madrid në ditët pasuese të finales së Champions të fituar kundër Liverpool. Gjithçka nis kur uellsiani, duke komunikuar me mediat pas dygolëshit, lë të kuptojë se marrëdhëniet me Zizou nuk janë të shkëlqyera. "Duhej të luaja të gjitha javët dhe kjo nuk ndodhi. Do të komunikoj me menaxherin tim për të vlerësuar se çfarë të bëj. Më vjen keq që nuk jam titullar, besoj se e meritoj", pat deklaruar Bale. Në moment Zidane kërkon menjëherë largimin e Bale. Florentino Perez i premton trajnerit blerjen e Neymar, pavarësisht referencave shumë pak të besueshme për brazilianin që vijnë nga Franca. Si alternativa, Zizou propozon Hazard dhe Salah, por me kusht largimin e uellsianit. Sipas pretendimeve të "ElPais", presidenti Perez nuk ishte shumë i bindur për zgjedhjen e shitjes së Bale. E sheh uellsianin si një blerjen e tij, shpërblimi i të cilës sapo ishte shfaqur me dygolëshin ndaj Liverpool. Më pas Florentino, mësoi se Ronaldo do të largohej nga Madrid dhe ëndërron dyshen Bale-Neymar. Presidenti telefonon numrin 11 dhe e bind të qëndrojë, duke i premtuar se do të komunikojë me trajnerin për t'i dhënë një mundësi. Por, sipas medias spanjolle, këtu u prish lodra. Zizou tërbohet për ndryshimin e strategjisë së klubit dhe në vend që të bie në dakordësi me drejtuesit për lëvizjet e sezonit të ardhshëm, paraqet dorëheqjen e tij më datë 30 maj. Tani Real i Bale, është i pari mes 13 viteve të fundit që humbet katër ndeshjet e fundit zyrtare. Me siguri Perez po mendon nëse ja vlejti.

Pogba te Juventus

Pas një morie aludimesh mbi ribashkimin e francezit Paul Pogba me Juventus, Drejtori Sportiv i bardhezinjve, Fabio Paratici ka treguar se cilat janë shanset që kampioni i botës të rikthehet në Torino. Mesfushori i ManchesterUnited ka qenë në qendër të spekulimeve, duke e lidhur atë me një largim nga "Old Trafford". Dhe Juventus do të ishte një prej favoriteve për të blerë mesfushorin francez, që nxori më të mirën e tij përpara transferimit rekord botëror të realizuar në vitin 2016. "Ne e duam Paul Pogba. Kemi një marrëdhënie fantastike me atë. Por nuk kemi menduar kurrë për rikthimin e tij te Juventus dhe as nuk do ta mendojmë atë", deklaroi drejtori sportiv i "Zonjës së Vjetër", Paratici. Bardhezinjtë po përjetojnë aktualisht një start spektakolar të sezonit, duke regjistruar plot 10 fitore në 10 ndeshje në Seria A dhe Champions League. Ndërkohë, marrëdhënia e Pogba me trajnerin Mourinho te Manchester United është gjithmonë e më e acaruar, ndonëse francezi ka edhe dy vite të mbetura kontratë me "Djajtë e Kuq".

Nis ankandi për Ramsey, sa shumë skuadra e duan

Ka shumë emra që po lakohen për kalim te AC Milan në sesionet e ardhshme të merkatos, me kuqezinjtë që kryesisht duan të kenë futbollistë të tjerë në mesfushë, atje ku Bakayoko i ardhur nga Chelsea doli "bllof" dhe alternativa për treshen Biglia-Bonaventura-Kessie mungojnë. Përveç Adrien Rabiot te Paris SG, i preferuari i Leonardo, kuqezinjtë po ndjekin edhe mesfushorin e Arsenal, Aaron Ramsey, i cili në qershor do të jetë i lirë nga çdo lidhje kontaktuale me "topçinjtë" dhe ka vendosur të mos rinvojë. Për uellsianin, ka një konkurrencë të fortë, sepse sipas asaj që bën të ditur shtypi anglez, krahas Milan, në listën e gjatë të ekipeve të duan Ramsey janë: Inter, Juventus, Tottenham, Liverpool, Bayern Munich dhe Atletico Madrid. Ankandi ka nisur.

Nga shiu në breshër, Real dhe Barcelona humbasin qendërsulmuesit

Real Madrid kalon nga shiu në breshër, i përfshirë nga një krizë loje dhe rezultatesh. Nga infermieria vijnë lajme të këqija për Karim Benzema. Sumuesi i "Los Blancos" ka pësuar një tërheqje në kofshën e djathtë dhe do të qëndrojë për 45 ditë larg fushave të lojës. Një problem shumë i madh për trajnerin Julien Lopetegui, që kishte probleme pikërisht në gjetjen e golit. Ndoshta tani do të ndjejnë edhe më shumë mungesën e Cristiano Ronaldo. Ndërkohë, "gjigantja" tjetër në Spanjë, Barcelona nuk do të ketë Luis Suarez për dy ndeshjet e Champions League kundër Inter, më 24 tetor dhe 5 nëntor, si dhe për ndeshjen "El Clasico" ndaj Real Madrid më 28 tetor. Sulmuesi uruguaian ka probleme në gjurin e djathtë dhe puna për riaftësimin e tij, për të shmangur operacionin, kërkon pushim absolut nga ndeshjet. Lajmi është konfirmuar nga stafi katalanas.

Futbollistët në kafene dhunojnë funksionarin e Putin, rrezikojnë hakmarrje të tmerrshme

Alexandr Kokorin dhe Pavel Mamaev, dyshja e artë e futbollit rus. Në kuptimin shumë sarkastik, sepse dy futbollistët janë të famshëm jo vetëm për lojën e tyre, por mbi të gjitha për bëmat e shumta. Në atë nivel sa që trajneri i përfaqësueses së Rusisë, Cherchesov vendosi të mos i grumbullojë për Kupën e Botës të zhvilluar në Rusi. Dyshja u kap në 2016 teksa festonte me shampanjë në shumën e 250 mijë euro, menjëherë pas eliminimit nga evropiani i zhvilluar në Francë. Por, kësaj here çifti i shokëve futbollistë e ka ekzagjeruar përtej limiteve, sepse në Rusi nuk është ide e mirë të bësh armik qeverinë e Putin. Referuar raportimeve të mediave ruse, Kokorin dhe Mamaev janë në telashe të mëdha. Dyshja është futur në një kateteri të Arbat, lagje kryesore e Moskës, në gjendje të ekzaltuar dhe ka nisur të bezdisë të pranishmit. Mes tyre ishte edhe Denís Pak, një funksionar i Ministrisë së Tregtisë, që ka tentuar të ndihmojë stafin e punonjësve për të mbajtur nën kontroll dy të tmerrshmit. Rezultati? Një sherr i madh, që në përfundim i kushtoi funksionarit të shtetit një dhëmb. Sipas informacioneve që raportohen nga Rusia, tashmë policia pas denoncimit ka hapur një çështje penale, për të cilën kanë nisur hetimet mbi sherrin në kafene. Ky lajm nuk është absolutisht jo më i miri për dy futbollistët e famshëm. Kokorin vetëm një vit më parë u bë protagonist i një skene të rëndë, teksa u paraqit në dasmën e një miku të tij me shumë pistoleta. Si do të përfundojë kësaj here historia? Kokorin ka fatin që luan te Zenit, skuadra e preferuar e Putin, por mungesa e respektit kaq e madhe ndaj një anëtari të qeverisë ruse rrezikon shumë dy futbollistët.

DASHI 21. mars - 20. prill

Gjeni kohë për të riparë disa çështje të familjes, të cilat i keni lënë pezull. Parashikohet një ditë interesante, për të sheshuar të gjitha tensionet, të cilat gjatë javëve të fundit ju kanë nervozuar..

DEMI 21. prill - 21. maj

Në këtë moment duhet të mundoheni të rigjeni harmoninë dhe qetësinë në të gjitha projektet tuaja, sidomos nëse gjatë muajve të fundit jeni përfshirë në situata të papëlqyeshme me familjen ose partnerin/en. Horoskopi i kësaj të marte favorizon projektet e reja.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Duhet të tregoheni më të zgjuar lidhur me strategjitë në vendin e punës, pasi së fundmi mund të merrni stimuj të mëdhenj, për të kaluar sfidat me të cilat jeni përballur së fundmi. Këshillohet që të mos e lini pas dore jetën në çift.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Tregohuni më të matur me fjalët, pasi mund të lëndoni pa dashur një person i cili ju ka qëndruar gjithmonë pranë. Përgjithësisht janë ditë që ju shohin mjaft të tensionuar, por kjo gjë nuk duhet t'iu shtyjë drejt debateve për çdo gjë. Është mjaft i favorshëm një kompromis, i cili do të shmangë shumë konflikte.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse ndjeheni të detyruar të merreni me një çështje që nuk ju përfshin direkt, rrezikoni të reagoni në mënyrë shumë agresive. Mundohuni të mos e humbni kontrollin. Këshillohet që të ruani kontrollin në çështjet e dashurisë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Gjatë kësaj të marte parashikohen mundësi shumë të mira për tu afruar me një person, me të cilin keni debatuar prej kohësh. Shpesh prireni që të jeni shumë kokëfortë, aq sa do të shfaqeni agresiv vetëm për të mbrojtur bindjet tuaja. Këshillohet që të dëgjoni më shumë mendimet e të tjerëve.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Më në fund do të riktheheni në lojë duke marrë një rol të ri i cili do ju lejojë që të vlerësoni më shumë krijimtarinë tuaj. Ka disa zgjedhje që duhet ti merrni me kujdes, ndaj mos u nxitoni.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Ju pëlqejnë sfidat dhe të vënit në provë për ju është një mënyrë shumë e mirë për të zbuluar shumë anë të vetes tuaj, sidomos në dashuri. Megjithatë parashikohen disa konfirmime të rëndësishme të cilat do ju lejojnë që të merrni më shumë kohë për të menduar për veten. Puna do të jetë mjaft e lodhshme, por e mbushur me kënaqësi të mëdha.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të rigjeni qetësinë dhe paqen, në të gjithë raportet ndërpersonale, sidomos nëse në familje keni pasur disa çështje që kërkojnë zgjidhje. Në punë, parashikohen rezultate shumë të mira.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Në këtë moment duhet të mundoheni të jeni më aktiv në vendin e punës, pasi intuita juaj do ju lejojë që të arrini një objektiv të rëndësishëm, me një sforco minimale. Disa vendime të rëndësishme, mund t'iu marrin shumë kohë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Në këtë moment duhet të mundoheni të jeni më të kujdesshëm me shpenzimet, sidomos nëse jeni gati për tu përfshirë në investime të rëndësishme për karrierën tuaj, shkruan noa.al. Horoskopi i kësaj të marte ju fton që të mos lini pas dore partnerin/en tuaj.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të tregoheni mjaft të aftë në arritjen e një marrëveshje, e cila do të jetë shumë e frytshme për arritjen e qëllimeve tuaja. Megjithatë nga pikëpamja sentimentale duhet të mundoheni të jeni më të rezervuar. Duke qenë të pranishëm, do të arrini të forconi lidhjen me personin që dashuroni.

shumë i lehtë

	8				2			3
2				1	6	5		
1		7	8					
			5	3				
		2	4		8	1		
				2	1			
			1			9		
		9		4	7			5
7					3	2	8	

Katër vjet pa më të dashurin tonë, pa lulen e rinisë...

LUAN TAIRI

1995-2014

Atë ditë Ti, ike në përjetësi, e prapa na le një lum me lot. Mbushen plot katër vjet qëkur buzëqeshja jote kaloi në përjetësi, e ne na mbeti freskia e buzëqeshjes tende dhe zjarri i lotit që rëndon mbi qepallë. Në siparin e kohës renditen ditët, ecin ato pandalshëm e dhembja për TY sa vjen e shtohet më shumë. Buzëqeshja jote rri e freskët në kujtimet tona, si mosha jote pa i mbushur 19 pranvera, kur ike atij çast të hidhur. Mbete i përjetshëm me buzëqeshjen e lules së rinisë, me mallin e pashuar që sa po vjen e po rritet! Jemi krenarë që të patëm dhe TI gjithnjë do të qëndrosh në pavdekësinë Tënde e në zemrat tona!

Përmallshëm të kujtojnë: babai Murati, nëna Anishja dhe vëllai Bajrami nga fshati Mahmutaj në Kërçovë.

Mensur Mamuti

QYTET I LASHTË GREK, NJË NGA 7 MREKULLITË E BOTËS
VOKALI I "ELITËS 5", ZIBERI
RAJON INDUSTRIAL NË GJERMANI
AGIM POSHKA
ISH PRESIDENTI SHQIPTAR, BUJAR
POLITIKANI YNË, PRISHTINA, VEPRËN E TË CILIT E PËRKTHEU PERSONI NË FOTO
AUTORI YNË, FATOS
'MBRETI' I SHEKSPIRIT
SHUMA / VEPRA E BUZUKUT
NËSE (ANG.)
MELIHATE AJETI / ÇANTË XHEPI PËR MBAJTJEN E TË HOLLAVE
KALIUMI / NOFKA E VEPRIMTARIT NË FOTO
ISH BOKSIERI AMERIKAN, NORTON / ATDHETARI YNË NË FOTO
B
AUTORI YNË, JOSIP
INTERNATIONAL MOBILE SATELLITE ORGANIZATION
RESPEKTI / USHTRIM ME SHKRIM
H
POSTI I AKTIVISTIT NË FOTO NË KONGRESIN E DYTË TË MANASTIRIT
LËNG I PANGJYRË QË PËRDORET SI TRETËS PËR MANIKYRE
SHKRONJA FQINJE
PSEUDONIMI I AKTIVISTIT NË FOTO (SHQ.)
ROK GRUP ITALIAN I VITEVE 80'
KËNGËTARJA AUSTRALIANE, KEJT FURLER
QOSHET / RAPISTI AMERIKAN, LIL
KOHA
FOSFORI / PRESIDENTI RUS, VLLADIMIR
FUQIZIMI, KALITJA / RADIO TELEVIZIONI
AUT. AMER., BAK / VEPËR E H. PRISHTINËS, PËRKTHYER NGA PERSONI NË FOTO
YMER ELSHANI / AUTORI SHQIPTAR, GJINI
NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE
K
SHKRONJË GREKE / LIGJ, KANUN (VJET.)
TANTLI
GJUAJTËS I PITONAVE / KAMPION
POLITIKANIA SHQIPTARE, ZHUPA
KRYEQYTETI I VIETNAMIT / TEMPERATURA
FILLOR
AKTORJA AMERIKANE, FAROU

ZGJIDHJET: HASAN, ARAPI, LIR, SH, IF, MA, K, KEN, BABUSHI, RELA, NDERI, HARTIM, SIA, SKAJET, P, FORCIMI, PERL, YE, OM, KUJTIMET, RO, TA, PITONAR, INA, HANOJI, NISTOR, MIA.

FACEBOOK KËRKON T'JU FUSË NJË KAMERA NË SHTËPI

Facebook po lançon altoparlantin e tij inteligjent me një ekran dhe një aparat fotografik. Portal dhe Portal + janë ndërtuar posaçërisht për video-telefonata. Pajisja është në thelb një folës i zgjuar me një prekje që përfshin disa karakteristika unike. Midis tyre është një sistem zbulimi i përdoruesit, i cili do të zmadhojë fytyrën e një personi ose do ta ndjekë atë kur të lëvizë nëpër dhomë. Ideja që qëndron prapa pajisjes është të bësh biseda video sikur të jesh në një dhomë me bashkëbiseduesin. Por, a do t'i besojnë përdoruesit e Facebook-ut një pajisjeje të tillë në shtëpinë e tyre? Kjo është një lëvizje e guximshme për një kompani të rrethuar nga çështjet e privatësisë që rrjedhin nga skandali i të dhënave të Cambridge Analytica dhe një "hack" masiv që mund të ketë kompromentuar 50 milionë përdorues.

Pse është gabim t'i lani shpesh duart

Të gjithë kemi mësuar se duart duhen larë para se të ulemi në tryezë, pas ushqimit, kur shkojmë në tualet, kur kthehemi në shtëpi, kur prekim ndonjë kafshë dhe shumë herë të tjera. Një studim i fundit tregon se njerëzit duhet të shmangin larjen e shpeshtë të duarve për të mbajtur larg sëmundjet. Ka paralajmërime se nëse lajmë duart shumë shpesh, mund të ulë rezistencën tonë ndaj baktereve. Bakteret e shëndetshme qëndrojnë në lëkurën tonë. Kur lind një bakter, të tjerë hyjnë në lëkurë dhe nuk largohen. Gjithashtu larja dëmton lëkurën dhe e bën një njeri më të prekshëm ndaj sëmundjeve pasi largohen vajrat e shëndetshëm që prodhohen vetvetiu. Paralajmërimet tregojnë të bëjmë kujdes me higjienën e tepruar. Po ashtu diçka që lidhet me obsesionin ndaj higjienës, është edhe krijimi i lëkurës së thatë, skuqjes apo irritimit të lëkurës.

Mbyllet fabrika e supermakinave, shkak ulja e shitjeve

Fabrika e Jaguar Land Rover (JLR) po planifikon një mbyllje për dy javë në fund të tetorit. Fabrika më e madhe e Britanisë fajësoi dobësimin e kërkesës globale, veçanërisht në Kinë, dhe është përballur me rënien e shitjeve të naftës në muajt e fundit. JLR njoftoi se punonjësit në West Midlands do të paguheshin edhe gjatë mbylljes dhe asnjë punëtor nuk do të pushohet. Zyrtari kombëtar i Kombeve të Bashkuara, Des Quinn, tha se ulja e kërkesës po dëmton industrinë e makinave në Mbretërinë e Bashkuar dhe zinxhirin e furnizimit.

Putini mbetet i pari, por i humbet besueshmëria

Një sondazh i ri, i publikuar të hënën, tregoi se numri i rusëve që e konsiderojnë presidentin Vladimir Putin si politikanin më të besueshëm të Rusisë, ka rënë ndjeshëm gjatë vitit të kaluar. Sondazhi i kryer në periudhën 20-26 shtator nga qendra e pavarur Levada, ka kërkuar nga të anketuarit të listojnë pesë ose gjashtë politikanë që iu besojnë më së shumti. Putini ka dalë i pari me 39%, i pasuar nga ultranacionalisti Vladimir Zhirinovski dhe ministri i Mbrojtjes, Sergey Shoigu - të dy me nga 15% mbështetje. Ministri i Jashtëm rus, Sergey Lavrov, ka dalë i katërti me 10%. Sondazhi zbuloi se besimi në Putinin ka rënë për 9% që nga qershori dhe për 20% që nga nëntori i vitit të kaluar. Putin, i cili ka qenë herë president, herë kryeministër i Rusisë që nga viti 2000,

i ka fituar zgjedhjet presidenciale në mars, me mbi 76% të votave. Vlerësimi më i ulët për Putinin, në një sondazh të qendrës Levada, ka qenë në gusht të vitit 2013, kur 30% e të anketuarve kanë thënë se ai është politikan i besueshëm. Popullariteti i tij është rritur në mbi 80% në vitin 2014, pasi Rusia ka aneksuar Krimenë nga Ukraina.

KALENDARI HISTORIK 10 TETOR

1631 - Ushtria saksone okupon Pragën.

1695 - Mbreti Willem III ikë nga Holanda Jugore dhe kthehet në Angli

1839 - Trupat angleze okupojnë Bejrutin.

1913 - Anija britanike për udhëtarë Volturno kaplohet nga zjarri në Oqeanin Atlantik ku vdesin 136 persona.

1935 - Lidhja e Kombeve dënon sulmin e Italisë ndaj Abisinisë (Etiopisë).

1957 - Aksidenti në reaktorin nuklear britanik në Windsdale.

1963 - Franca heq dorë nga kontrolli i bazës detare Bizerte në Tunizi.

1970 - Shpallet pavarësia e Fixhit.

A E DINI SE...

MOS PINI UJË NË KËMBË

Me siguri prindërit që në fëmijëri jua kanë tërhequr vërejtjen që të mos pini ujë duke qëndruar në këmbë. A keni pyetur ndonjëherë përse? Prindërit kanë pasur të drejtë - pirja e ujit në këmbë është krejtësisht e gabuar. Kur pini ujë, ideale është të jeni ulur. Në të vërtetë në këtë mënyrë në të gjitha organet do të qëndrojë mjaft gjatë. Në të kundërtën, nëse pini ujë derisa jeni në këmbë, ai shpejt do të kalojë nëpërmjet zorrës së trashë, andaj trupi nuk do të ketë kohë t'i absorbojë nutritienët. Kjo mund të shkaktojë shumë probleme: ngërçe, artrit, dëmtim të veshkave. Përveç kësaj, ujin duhet pirë ngadalë, gllënjkë pas gllënjke.

BARSOLETA

SPECIFIKA

Paske filluar ta rrallosh duhanin kështu? - i thotë njëri shokut të tij.
- E kam lënë fare.
- Po me alkoolin si ja çon?
- Edhe atë e kam rralluar mjaft.
- Është për tu çuditur. Me të tjerët ndodh ndryshe. Kur lënë njërën, zakonisht shtojnë tjetrën.
- Ndoshta, por ato nuk janë martuar me gruan time.

THËNIA E DITËS



Biri im, një gjë të kesh parasysh gjithmonë, i drejti zhytet, por nuk mbytet! **(Mark Twain)**